

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8JH.09


Sh 22

DALAN  
SHAPLLO

**VËSHTRIME  
TEORIKO-LETRARE**

85H.0P  
5622

**DALAN  
SHAPLLO**



**VËSHTRIME  
TEORIKO-LETRARE**

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»



LIBRI  
SHKRUARJE

TEORIKO-VEPARE  
VEPARE

Tirazhi 4000 kopje

Format 78x109/32

Stash: 2204-72

---

KOMBINATI POLIGRAFIK – Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1978

## MARKSI DHE ENGELSI MBI ARTIN DHE SHOQËRINË

Në luftën e sotme midis mendimit estetik marksist-leninist dhe mendimit estetik borgjezo-revizionist pikëpamjet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit për artin lozin një rol të madh, ato ndihmojnë për një mprehje të mëtejshme ideologjike dhe për t'u thelluar në analizën historike dhe bashkëkohore të veprave dhe dukurive letrare artistike. Së bashku me këto mësimë, duke u mbështetur në to dhe duke i zbatuar në kushtet tona konkrete, mësimet e Partisë sonë dhe të shokut Enver janë një armë e fuqishme në luftën për të forcuar edhe më shumë pozitën revolucionare të artit të realizmit socialist. Kësisoj ne kemi dhënë dhe do të japim edhe më tepër kontributin tonë në artin dhe estetikën revolucionare botërore, në kundërshtim me të gjitha rrymat dekadente, me teoritë e tyre, me artin revizionist, me demagogjinë teorike apo me shtrembërimet e hapura që u bëjnë ata parimeve të artit socialist.

Në fjalën e tij të 20 Dhjetorit 1974, shoku Enver, duke folur për klasikët e marksizëm-leninizmit, Marks, Engels, Lenin, Stalin dhe kontributin e tyre të madh për letërsinë dhe artin tha: «Unë i këshilloj shokët shkrimtarë e artistë, veçanërisht kritikët letrarë dhe kritikët e arteve, që, krahas studimit të teorisë marksiste-leniniste, të lexojnë me shumë kujdes, në veçanti ato raste jo të pakta, ku kla-



sikët tanë bëjnë kritika për shkrimtarë dhe artistë. Ato janë analiza të thella dhe model për ne se si duhet ta gjykojmë një veper letraro-artistike».

Veprat e klasikëve duhet të studiohen nga ne me këtë sy, në lidhje të ngushtë me problemet e sotme. Mendimi ynë është mbështetur në to, por ne nuk kemi ende studime të thelluara që të jenë fryt i një pune të madhe dhe me kompetencë, duke u nisur nga njohja e filozofisë, estetikës, autorëve dhe veprave që përmenden apo analizojnë klasikët dhe nga vlera bashkëkohore e mendimeve të tyre.

Në këtë artikull do të dëshiroja të trajtoja (në një formë të lirë informimi apo përshtypjesh) disa nga problemet që ngrenë Marksit dhe Engelsin mbi letërsinë e artin dhe mbi autorë të veçantë.

Është e njohur përpjekja e teoricienëve revizionistë për të injoruar ose minimizuar rolin e madh që kanë lojtur dhe lozin pikëpamjet e Marksit dhe të Engelsit, si edhe të Leninit dhe Stalinit mbi letërsinë dhe artin. Ata janë munduar të tregojnë se Marksit dhe Engelsit nuk arritën të krijojnë një sistem të tyre mbi artin, se nuk janë marrë me këto probleme dhe prandaj nuk kemi pse të mbështetemi tek ata. Kjo u duhet për të përlegjur artin e tyre të degjeneruar antirevolucionar, për të përlegjur teoritë idealiste, formalizmin dhe subjektivizmin. Marksit dhe Engelsin, ndonëse nuk kanë shkruar traktate apo nuk kanë bërë vepra të veçanta për artin (disa herë e kanë shprehur keqardhjen e tyre që nuk u dilte kohë për këtë) megjithatë kanë dhënë një kontribut shumë të madh, kanë zbërthyer disa pika kyçe dhe autorë të mëdhenj, dhe këto vlejné si orientim për shumë probleme themelore të letërsisë dhe të arteve. Me rëndësi të madhe për artin është vetë teoria marksiste-leniniste. Duke u mbështetur në materializmin dhe në lëvizjen proletare, klasikët na kanë dhënë në dorë kyçin për të kuptuar e parë zhvillimin e artit në lidhje të ngushtë me shoqërinë, me luftën e klasave dhe me të ardhmen komuniste. Një nga mësimet e tyre kryesore lidhet me kushtëzimin social-historik të artit, të

zhvillimit të tij, të zbulimit të kontradiktave në krijimtarinë e shkrimtarëve dhe të artistëve, të pasqyrimit gjithnjë në to të një thelbi klasor me gjithë veshjen e ndërlikuar hera-herës dhe nuancat e stërholluara që mund të marrë një vepër.

Mendimi estetik dhe kritik paramarksist nuk mundte dot të shpjegonte deri në fund dhe me një qartësi dialektike kushtëzimin social-historik të artit, rrugën e zhvillimit, raportet e drejtpërdrejta e të tërthorta, formacionin ekonomik të një shoqërie si edhe lidhjet e ngushta dhe varësinë e artit nga jeta shpirtërore e shoqërisë, nga ideologjia. Marksist thoshte se idetë sunduese janë ato të klasës në fuqi dhe kjo e vërtetë e madhe hedh dritë për të shpjeguar rrugën e artit në histori, rrymat sunduese letraro-artistike, atë çka është kryesore sot për botën kapitaliste apo revizioniste, si dhe për vendin tonë, ku klasa punëtore është në fuqi dhe zotëron e duhet të forcohet më shumë akoma arti me botëkuptimin e klasës, me ideologjinë e Partisë së saj, që shpreh interesat e gjithë masave punonjëse.

Nuk do të ndalem tek ato mendime të Marksit dhe Engelsit, që janë cituar tek ne dhe interpretuar disa herë nëpër artikuj të ndryshëm dhe studime, si mbi pikëpamjet e tyre për tendencën në art, mbi vlerësimin e Balzakut, mbi luftën kundër konceptimit vulgar materialist e të tjera aspekte shumë të rëndësishme.

Për problemin e kushtëzimit social-historik të veprave të artit dhe të autorëve, do të ishte e dobishme t'u drejtoheshim disa shembujve të përdorur prej tyre. Kështu, në një letër të Pol Ernstit aty nga viti 1890, Engelsi bën fjalë për letërsinë norvegjeze dhe për zhvillimin e saj të dukshëm, në krahasim me letërsinë gjermane, brenda njëzet vjetëve të fundit. Ai flet në mënyrë të veçantë për Ibsenin, dhe shikon krijimtarinë e tij lidhur me veçoritë shoqërore dhe historike që përcaktuan zhvillimin e saj. Bujkrobëria në Norvegji nuk është njohur, thoshte Engelsi, dhe prandaj borgjezi i vogël norvegjez është bir fshatari të lirë







që lidhet me «fëmijërinë e njerëzimit», e cila lë kujtime të forta në ndërgjegje dhe prandaj njerëzve u pëlqen të kthehen tek ajo shpeshherë. Ai konceptim i jetës, ajo fantazi, janë tipike për atë kohë dhe nuk mund të lindin në kushte të tjera shoqërore. Duke folur për fillimet e artit, të ndjenjave estetike, Marks i thoshte (në konspektin e librit të Lui Morganit «Shoqëria e lashtë»): «Imagjinata, kjo dhunti e madhe, që ka ndihmuar aq shumë zhvillimin e njerëzimit, tani filloi të krijonte letërsinë e pashkruar të miteve, legjendave e gojëdhënave, duke ushtruar një ndikim shumë të fuqishëm mbi njerëzimin». Këtej del se ç'ëndësi i jepnin klasikët imagjinatës për artin, por natyrisht një imagjinatë që buronte nga realiteti, nga një botëkuptim i caktuar. Legjendat, gojëdhënat dhe mitet me elementët fantastikë, përrallorë, me formë hiperbolike shprehnin një realitet të transfiguruar, dhe më shumë, botën e ëndrrave dhe dëshirave të njerëzve, duke futur në caqet e subjektit imagjinar shpeshherë ide të fuqishme të epërsisë morale të popullit, të mundjes së të keqes nga e mira, të përtëritjes së jetës, të fatkeqësisë e të lumturisë që shpesh perceptoheshin jashtë vullnetit të njeriut.

Është shkruar tek ne për mitet, për rolin e tyre në histori dhe për degjenerimin e sotëm dekadent të artit që ngrihet mbi kultin e miteve, të irrealit dhe të konvencionalizmit antirealist. Ndaj këtij problemi ne mbajmë një qëndrim dialektik, duke e shpjeguar dukurinë lidhur me epokën kur ka lindur, me domosdoshmërinë e ekzistencës së tij në një periudhë dhe me zhdukjen e tij në periudhat e mëvonshme historike.

Marks i, në hyrjen e veprës «Rreth kritikës së ekonomisë politike» bën fjalë edhe për çështjen e mitologjisë: «Çdo mitologji, thotë ai, mposht, nënshtron dhe krijon forcat e natyrës në imagjinatë dhe me ndihmën e imagjinatës, prandaj, ajo shfaqet së bashku me vendosjen e sundimit të natyrës mbi këto forca të natyrës. Kështu ndodhë edhe me artin që pasqyron botën objektive atë që rritet nga një konceptim materialist i historisë, qoftë edhe në një konceptim materialist i historisë qoftë edhe në shikallë të ndryshme të përvetësimit të këtij koncepti, në

për rryma dhe autorë të veçantë. Por, siç është pohuar disa herë në kritikën tonë, zhdukja e konceptimit mitologjik dhe ngushtimi i sferës së sistemit të figurave dhe mjeteve shprehëse artistike, që u përfatuan në lashtësi, nuk do të thotë heqje dorë absolute nga çdo formë, nga çdo mjet artistik që mbeti ndër shekuj dhe u përdor vetëm si element i formës për të dhënë një mendim, një dëshirë të zmadhuar, një pasion që s'mund të jepet me elementet veridike të pasqyrimin. Por, natyrisht, pasqyrimi (bëhet shumë më realist dhe këto forma evoluojnë, shprehja metaforike nuk mund të bëhet më qëllim në vetvete dhe lloje të ndryshme të saj marrin një kuptim të veçantë në periudha të ndryshme historike: disa bëhen më të efektshme, disa e humbasin vlerën e tyre.

Duke vazhduar mendimin mbi kushtet historiko-shoqërore, që përcaktojnë lindjen e botëkuptimit dhe të fantazisë, Marksi thoshte: «Mitologjia egjiptiane kurrë nuk do të shërbente si bazë apo si djep për artin grek».

Është, ndofta, me interes të kujtohet edhe mendimi i shfaqur prej Engelsit, në veprat e tij të hershme mbi rolin e peizazhit, të natyrës së një vendi për imagjinatën dhe artin. Është e kuptueshme se këto nuk janë arsyt kryesore: formacioni shoqëror, gjendja politiko-ekonomike si dhe zhvillimi i ideve janë faktorët kryesorë, por lozin edhe ato rolin e tyre në veçoritë e përfytyrimit, të ngjyrave dhe të atmosferës së një arti. Larmia e peizazhit grek, thoshte Engelsi, hyn në kufijtë e një harmonie të përgjithshme. Qielli i kaltër, lumenjtë, fushat kanë përfutur një mitologji dhe fantazi tipike greke. Hapësirat natyrore sjellin edhe një gjerësi lirike në art. Duke udhëtuar në rrugët e Anglisë, thoshte Engelsi, mes asaj natyre të butë me kodra, nën një diell të zbetë, mendon për ambientet e zymta dhe tragjike të veprës së Shekspirin. Vetëm vepra si «Ëndërr e një nate vere» apo «Romeo dhe Zhuljeta» dallohen për ndikimin e jugut. Ky mendim i Engelsit mbi rolin e natyrës, të peizazhit, i njohur edhe nga studiues e estetë të tjerë, mund të na ndihmojë për të kuptuar atë fantazi të pasur të legjendave dhe gojëdhëna-



ve tona shqiptare me kreshnikët pranë maleve dhe shkëmbenjve dhe me shtojzovallet pranë burimeve dhe gjelbërimit aq të begatshëm dhe të këndshëm të tokës sonë. Sot, përmes një konceptimi realist, natyra lë gjurmët e saj në poezinë dhe në artin tonë që shquhet për ngjyrimet e veçanta dhe për atmosferën shqiptare.

Për vartësinë e krijimtarisë dhe autorëve nga kushtet dhe zhvillimi i jetës vlejné të përmenden edhe shembuj të tjerë që sjellin Marksia dhe Engelsi. Ata thoshnin se lindja e një talenti, si p.sh. Leonardo da Vinçi, shpjegohet me zhvillimin e Firencës, Rafaeli me atë të Romës dhe Ticiani me zhvillimin e Venedikut. Kështu mund të shpjegoheshin shumë talente, përmes kushteve historike kur kanë lindur, rrethanave të veçanta që i kanë nxjerrë në shesh. Ky qëndrim materialist nuk ka të bëjë me determinizmin; ai parakupton rolin e individit në shoqëri, por nuk pajtohet me mendimin idealist dhe me «mrekullitë» që gjoja nuk paske si t'i shpjegosh.

Për evoluimin në trajtimin e temave të ndryshme që ka rrahur letërsia, si p.sh. tema e familjes dhe e dashurisë, në lidhje të ngushtë me vetë jetën, me rrugën e kësaj dukurie, ka folur Engelsi në veprën e vet «Origjina e familjes...». Ai ka treguar, p.sh., se lirika kalorsiake mbështetet mbi shkeljen e dashurisë bashkëshortore dhe i këndon kësaj si diçka kalimtare dhe romantike. Prandaj, kuptohet (që shpjegohet me kohën) është morali i klasave të privilejuara dhe një letërsi e tillë është tepër e lehtë dhe lë pak gjurmë në zhvillimin historik të lirikës.

Po kështu Engelsi flet për rënien e familjes aristokrate, për tradhtinë bashkëshortore, që përdorej si mjet për të ruajtur «pavarësinë», (kjo pasqyrohet në veprat e Balzakut që përshkruante marrëdhëniet borgjeze të periudhës së grumbullimit të kapitalit dhe të rënies së aristokracisë).

Shumë i rëndësishëm dhe me vlerë aktuale është mendimi i klasikëve për artin në periudhën kalimtare midis dy epokave dhe në shoqërinë kapitaliste. Ata e trajtuan gjerësisht problemin e kalimit nga pozitë patriarkale e

sentimentale në pozita të reja kur gjithçka kridhej në akullin e ftohtë të parasë. Ata nuk kishin asnjë iluzion dhe nostalgji ndaj së kaluarës historike dhe ngrinin lart drejtimin realist në art, theksonin vendin shumë të rëndësishëm që zinte romani në shekullin XVIII dhe XIX si domosdoshmëri për të pasqyruar marrëdhëniet komplekse të njerëzve dhe klasave në shoqërinë kapitaliste. Klasikët kanë zbuluar të parët, me një forcë gjeniale të mendimit, që shtrihej në të gjitha sferat e diturisë, veçorinë e artistëve të Renesansës, që nxori gjigantë, sepse shoqëria kishte nevojë për ta. Ata kanë përcaktuar vendin e rëndësishëm që zinte Dantja si një dukuri letrare që lindi midis dy epokave të kalimit nga mesjeta në kohën e re, me gjithë tragjizmin, kontradiktat shpirtërore të njeriut që kërkonte lirinë dhe emancipimin e tij moral. Klasikët kanë çmuar, në mënyrë të veçantë, Servantesin, Shekspirin, Balzakun, Valter Skotin, Fildingun, Shelin, Bernsin, Hajnen; ndër mendimtarët dhe estetët — Dideronë, Lesingun, Çernishevskin etj. Ata çmonin shumë lart poezinë popullore, pëlqenin shumë satirën therëse të disa këngëve që mbeteshin të paharruara. Marksi dhe Engelsi kanë treguar një kujdes të madh për disa poetë e letrarë që ishin bashkuar me partinë në Gjermani; këmbenin letra me ta, nuk pajtoheshin me qëndrimet e dobëta dhe të lëkundshme dhe entuziazmoheshin nga qëndrimet konsekuente në vijën politike dhe në art. Ata ngrinin lart Hajnen duke e quajtur poetin më të shquar të asaj kohe në Gjermani, dhe shprehnin, në letrat që këmbenin midis tyre, hidhërimin për vdekjen e parakohshme dhe plot mundime të autorit të poemës «Përralla dimërore» si edhe zemërimin ndaj atyre të cilët pas vdekjes së tij, kërkonin ta injoronin ose të zvogëlonin së tepërmi rolin e këtij poeti në letërsinë gjermane.

Klasikët çmonin vlerat e mëdha të letërsisë realiste të shekullit XIX të kohës së tyre (si edhe të autorëve të mëparshëm) nënvizonin prirjen realiste, forcën demaskuese të këtij arti, elementët popullorë, demokratikë dhe revolucionarë, por njëkohësisht tregonin se si e katandiste bor-



gjezia artistin në një punëtor me mëditje, si e detyronte shpesh të prostituonte me talentin e tij dhe si shuante shumë talente që do të mund të lulëzonin në një shoqëri si ajo e së ardhmes komuniste. Duke qenë të ndërgjegjshëm për zhvillimin e artit realist dhe përparimtar, për forcën e madhe realiste të shumë veprave dhe autorëve të shekullit XIX, ata njëkohësisht shfaqnin mendimin përgjithësues dhe thelbësor se «prodhimi kapitalist është armik i disa degëve të njohura të prodhimit shpirtëror, p.sh., artit dhe poezisë». Ne njohim mendimin leninist të dy kulturave brenda kombit borgjes, po kemi të qartë, gjithashtu, se ideologjia sunduese është ajo që shpreh interesat e klasës sunduese, prandaj e kuptojmë fare mirë pse lindin njëra pas tjetrës në shoqërinë kapitaliste rrymat dekadente dhe formaliste, qofshin këto haptazi reaksionare dhe konformiste, qofshin edhe kontestuese në dukje, por në thelb pajtuse dhe përkrahëse të borgjezisë. Vetëm në socializëm dhe në komunizëm, thoshnin Marksi dhe Engelsi, kur të zhduket prona private me gjithë pasojat e saj në ndërgjegje, do të krijohen kushtet për lulëzimin e vërtetë të talenteve.

Duke luftuar për një art që t'i shërbente revolucionit, Marksi dhe Engelsi kanë demaskuar, si në politikë ashtu edhe në letërsi, të ashtuquajturit «socialistë të vërtetë». Kjo tendencë lindi dhe pati një farë jete në Gjermani nga 1840 e këtej si një opozitë mikroborgjeze, e cila në fillim shprehte pakënaqësitë e saj ndaj borgjezisë, por, e trembur nga revolucioni, duke mos kuptuar luftën e klasave dhe misionin e proletariatit, ra në dekadencë. Poetët që e quanin veten «socialistë të vërtetë» krijojnë vargje të fryra, plot tirada të bujshme kundër mungesës së «humanizmit» dhe, në të vërtetë, bënin thirrje për vëllazërim midis të shfrytëzuarve dhe shfrytëzuesve. Kështu, p.sh. Marksi dhe Engelsi treguan fytyrën e vërtetë të një poeti, Gotfrid Kinkel, i cili krijoi rreth vetes një aureolë por në fakt më vonë ai hoqi dorë nga revolucioni. Klasikët, kur flasin për poezitë e këtyre lloj poetëve, si edhe në shumë raste të tjera, hyjnë në analiza konkrete, citojnë poezi, fi-



gura, ironizojnë me të, apo tregojnë boshllëkun e tiradave dhe të deklaratave të sipërfaqshme.

Këto mendime të Marksit dhe të Engelsit, për poetë të lëkundshëm dhe të huaj për revolucionin, po që përdorin fraza të majta, ruajnë vlerë të madhe aktuale edhe sot në luftën kundër revizionistëve dhe gjithë rrymave konformiste, në thelb, antirevolucionare.

Kanë interes të veçantë shumë mendime të Marksit dhe të Engelsit për autorë të ndryshëm. Përveç atyre që janë gjerësisht të njohura, si për Balzakun, Shekspirin, Shilerin, Hajnen etj., ka edhe shumë vrojtime të holla, vlerësime dhe interpretime materialiste të krijimtarisë së autorëve të ndryshëm, të cilët meritojnë të studiohen më vete apo të përdoren si një ndihmë e madhe orientuese për të kuptuar më thellë krijimtarinë e autorëve. Kështu, p.sh., disa herë ata e kanë përmendur, V. Hygonë. Marksi në veprën e vet «18 brymeri i Lui Bonapartit» gjente diçka të përbashkët në qëndrimin e Hygoit ndaj Lui Bonapartit, të cilin ky poet dhe shkrimtar i madh e ka urreyer dhe demaskuar katërcipërisht. Por duke qenë larg konceptimit materialist të rolit të individit në histori, Hygoi e shikonte Lui Bonapartin, këtë «Napoleon të vogël» nga disa aspekte të dorës së dytë dhe e mbivlerësonte rolin e tij. «Lufta klasore, thotë Marksi duke përmendur Lui Bonapartin, — krijoi në Francë rrethana dhe marrëdhënie që i lejuan një personazhi mediokër dhe qesharak të luajë rolin e heroit». Hygoi, duke ia veshur të gjitha fajet mbretit, pa dashur zmadhoi figurën e armikut të tij të urreyer. Konceptimi romantik i historisë dhe i individëve e bënte këtë autor të madh të kalonte në idealizëm dhe të mos zbulonte dot gjer në fund kontradiktat sociale.

Marksi ia ka nënshtruar një kritike të thellë romanin e Ezhen Sy «Të fshehtat e Parisit». Të dy klasikët, Marksi dhe Engelsi, kanë pranuar disa vlera të romanit, sidomos në vizatimin e njerëzve të thjeshtë, përfaqësues nga shtresat e ulëta të shoqërisë. Por ata kanë theksuar edhe dobësitë e tij të mëdha, të cilat qëndrojnë në vështirimin

klasor mikroborgjez, që predikon pajtimin e një princi me lumpenproletarët. Duke mposhtur ndjenjat, sipas romanit, ata duhet të pajtohen me asketizmin kristian. Marksii e kritikonte këtë vepër, ku personazhet ktheheshin në shprehje alegorike të «detyrës» dhe «moralit». Ai nuk pajtohej kurrsesi me metodat spekulative, sipas të cilave «njerëzit realë shndërrohen në pikëpamje abstrakte».

Për vlerën njohëse të shumë veprave kanë folur në mënyrë të veçantë klasikët. Engelsi thoshte se për të njohur Skotlandën, historinë e klanit të saj, duhet drejtuar te veprat e Valter Skotit.

Veprat që ata kanë pëlqyer kanë pasur dhe kanë vlera të vërteta ideologjike dhe estetike; ato hedhin dritë në histori dhe nisen nga ide të mëdha. Kështu, p.sh., përveç rasteve shumë të njohura si për romanin «Fshatarët» etj., ata kanë folur edhe për novelat e Balzakut. «Të këshilloj, i shkruante Marksii Engelsit, të lexosh «Kryeveprën e panjohur» dhe «Malmotin e pajtuar». Këto janë dy kryevepra të vogla plot me një ironi të këndshme». Tregimi i Balzakut «Kryevepra e panjohur», si një etyd psikologjik, ngre një problem të madh, duke ironizuar një piktor, dikur mjeshtër të madh, që u mbyll në studion e tij dhe ra në një formalizëm të plotë, duke humbur nga syri të tërën në morinë e detajeve dhe penelatave të stërholluara. Fama dhe paraja e shkëputën këtë piktor nga shoqëria. Kritiku marksist Lafargu kujtonte, gjithashtu, se sa i pëlqente Marksit ky tregim, ku përshkruhej një piktor që humbiste vizionin e së tërës nga hollësitë e panumërta. Edhe Marksii, shkruante Lafargu kapte të tërën dhe detajet, por gjenialiteti i tij e bënte që të mos humbiste kurrë konceptimin e së përgjithshmes, përmes së veçantës. Një analogji me metodën e vet të krijimit ka gjetur Marksii në kritikën dhe ironinë e Balzakut, këtij shkrimtari mjeshtër për të kaluar nga e «veçanta» tek «idetë» dhe nga «idetë» tek «e veçanta», pa humbur vizionin e përgjithshëm mbi shoqërinë.

Mësimet e Marksit dhe të Engelsit për letërsinë dhe artin kanë një vlerë të madhe për të kuptuar historinë e



artit, domethënien shoqërore të tij, forcën dhe dobësitë e autorëve të mëdhenj, gjithmonë në kushtëzim me shoqërinë dhe përmes veçorive të vetë artit. Mësimet e tyre kanë një vlerë të madhe aktuale në luftën që bëjmë ne, të udhëhequr nga Partia dhe shoku Enver, për zhvillimin e artit tonë të realizmit socialist dhe të mendimit estetik dhe kritik.

1976

## **MËSIMET KONSEKUENTE REVOLUCIONARE TË PARTISË DHE TË SHOKUT ENVER HOXHA MBI LETËRSINË DHE ARTIN**

*Mbi përmbledhjen: ENVER HOXHA —  
Mbi letërsinë dhe artin*

Përmbledhja e fjalimeve, raporteve, bisedave, përsëritjeve të shokut Enver Hoxha, e ekstrakteve të nxjerra prej tyre, kushtuar problemeve të letërsisë e arteve, si edhe kulturës sonë të re është një botim shumë i nevojshëm dhe një ndihmë e madhe për punonjësit e këtyre fushave si edhe për gjithë lexuesit. Duke i pasur këto të përmbledhura në një vëllim, lexuesi ndjek më mirë e më qartë mendimin e Partisë, të shokut Enver mbi problemet e artit që në vitet e para të krijimit të Partisë e gjer në Kongresin VII në fazat e ndryshme të zhvillimit të jetës politike e shoqërore si edhe të rrugës që kanë bërë letërsia dhe artet në vendin tonë. Kështu që ky libër shumë i rëndësishëm do të qëndrojë gjithmonë pranë tavolinës së punës së njerëzve të kulturës e artit dhe do të vlejë për orientimin e tyre ideologjik, për të kuptuar më mirë problemet e sotme të letërsisë e arteve, luftën që ka bërë Partia jonë për të ruajtur pastërtinë ideologjike të tyre dhe për të përcaktuar më mirë pozicionin ideoestetik në kushtet e reja të zhvillimit, që do të krijohen.

Përmbledhja e këtyre materialeve dhe dokumenteve



të Partisë, të lindura në situatat që ka kaluar vendi ynë, në kushtet kur koha ka nxjerrë probleme konkrete që burojnë nga zhvillimi i artit dhe nga lufta ideoestetike në plan kombëtar e ndërkombëtar ndihmon për ta qartësuar e forcuar edhe më tepër mendimin mbi kontributin që kanë dhënë e po japin Partia dhe shoku Enver për të mbrojtur parimet marksiste-leniniste në fushën e kulturës, të letërsisë e të artit, në frontin e luftës midis marksizëm-leninizmit, në njërën anë, dhe ideologjisë borgjese e revizioniste, në anën tjetër, në këtë sferë të rëndësishme të ideologjisë. Përvoja e mendimit tonë ideoestetik, e shprehur nga udhëheqësi i Partisë dhe i popullit, shoku Enver Hoxha, përbën një pasuri të madhe një bazë ideologjike që vlen për orientim, për formimin marksist-leninist të njerëzve të kulturës e artit dhe gërsheton në vetvete «principet e mëdha» të lindura nga revolucioni, të mbështetura në teorinë marksiste-leniniste si edhe veçoritë e lindura në kushtet e zhvillimit të kulturës sonë. Bashkimi i parimeve të përgjithshme marksiste me përvojën tonë konkrete në kushtet e sotme të luftës klasore bie me vete edhe vlerën e veçantë të këtyre materialeve që kanë rëndësi të madhe për vendin tonë po edhe për zhvillimin e letërsisë dhe arteve revolucionare në botë, të cilat kanë lindur me kohë dhe sot, me gjithë pengesat dhe luftën që u bëjnë borgjezia dhe revizionizmi, do të vijë doemos duke ecur më përpara e duke shoqëruar gjallërimin e lëvizjes marksiste-leniniste dhe përparimtare. Partia jonë, e cila ka mbrojtur e mbron me vendosmëri marksizëm-leninizmin, duke i qëndruar kurdoherë besnike këtij dhe duke luftuar çdo largim e tradhëti ndaj tij, e tregon këtë edhe në frontin e kulturës e të artit. Ajo udhëheq shkrimtarët e artistët në punën e tyre fisnike për të kryer misionin e madh të krijesit militant e të partishëm, të «ndihmësit të saj» për edukimin e njerëzve, për të mbajtur gjithmonë lart e të panjolllosur flamurin e realizmit socialist.

Në këtë libër ne gjejmë orientimet e udhëzimet, mendimet dhe interpretimet marksiste-leniniste të shokut Enver mbi probleme konkrete e të përgjithshme të



artit, në të cilat dalin parimet kryesore të ideologjisë proletare mbi këto sfera, parimet e estetikës marksiste-leniniste, në aspekte të veçanta, të shpjeguara e të pasuruara më tej sipas përvojës së vendit tonë. Pastërtia e vijës së Partisë dhe besnikëria e patundur ndaj teorisë marksiste-leniniste kanë bërë të mundur ruajtjen e parimeve të kulturës dhe artit proletar, të mbrojtura nga Marksi, Engelsi, Lenini e Stalini, si edhe zbatimin e tyre në kushtet e luftës së sotme politike dhe ideologjike. Sipas problemeve që kanë lindur, është rrahur herë njëri aspekt, herë një tjetër, por në tërësi, siç e tregon në mënyrë të veçantë kjo përmbledhje, si edhe dokumente të tjera të Partisë, janë rrahur gjithë problemet themelore të estetikës marksiste, parimet e saj më të rëndësishme, që kanë dalë nga përvoja artistike dhe nga konceptimi filozofik revolucionar i zhvillimit të artit në përgjithësi dhe, veçanërisht, i artit tonë të realizmit socialist. Kështu që kemi të bëjmë me një trajtim ideologjik të plotë dhe të shumanshëm të fenomeneve të letërsisë e artit, bile edhe të disa gjinive të veçanta, të cilat, në faza të ndryshme kanë spikatur për mprehtësinë problemore të tyre.

Duke lexuar e studiuar këtë përmbledhje (ku ka edhe materiale të botuara për herë të parë, si diskutimin e shokut Enver në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor, janar 1973, etj.) ne shohim se si kanë rrjedhur ngjarjet historikisht dhe se si Partia e shoku Enver kanë ndjekur, afirmuar letërsinë dhe artin e ri, kanë ngritur probleme të luftës kundër devijimeve të djathta dhe të «majta», të reflektuara edhe në këtë sferë, kanë sqaruar mjaft probleme të ndërlikuara teorike dhe të gjitha këto kanë ndihmuar, përkrahur e frymëzuar forcat tona krijuese. Kështu ne e ndjekim fjalën e Partisë dhe të shokut Enver që nga vitet e parë në Luftën Nacionalçlirimtare, kur u bëhej thirrje shokëve të Partisë, kuadrove të saj, që të plotësonin kërkesat për gazeta e revista, për libra, të cilat do të krijoheshin prej atyre vetë dhe nuk kishte se nga të pritëshin. Fjala e ngrohtë e Partisë, frymëzimi që buronte prej saj dhe mësimet e shokut Enver, në kushtet e luftës kundër

armiqve pushtues e tradhtarë ishte një nxitje dhe përkrahje morale për letrarët e rinj që filluan të shkruajnë vargjet, këngët, skicat, reportazhet, poemat e para, të cilat gjetën një përkrahje të gjerë në popull. Në këtë luftë u duk edhe «rëndësia transformuese e teatrit», për të cilën flet shoku Enver në letrën dërguar Teatrit Popullor me rastin e 20-vjetorit.

Zhvillimi i mëtejshëm i krijimtarisë artistike në kushtet e pasqirimit, në fazën e kristalizimit të realizmit socialist, të lindur që në këtë luftë, ka ngritur edhe një varg problemesh që kanë kërkuar zgjidhje. Kështu, është folur për këto probleme në të gjitha kongreset e saj, në plenumë, në mbledhjet e Byrosë Politike e të Sekretariatit, në takime e biseda me shkrimtarët, artistët e intelektualët. Shoku Enver ka demaskuar qëndrimin oportunist e liberal të S. Malëshovës, që u shpreh haptazi edhe në Konferencën III të Lidhjes së Shkrimtarëve, më 1949; ka folur për burimin e temave kryesore nga jeta dhe heroizmi i popullit, për trajtimin e temës aktuale dhe të Luftës; ka trajtuar probleme në plenumë të KQ të Partisë mbi orientimet kryesore ideologjike të artit, duke theksuar gjithmonë nevojën e forcimit të «drejtimit të realizmit socialist», ka ngritur probleme të partishmërisë, të edukimit marksist-leninist dhe të studimit të vazhdueshëm të së sotmes e të historisë, të traditës e të novatorizmit, të karakterit kombëtar e popullor si në takimin me shkrimtarët e artistët më 1961, në fjalën e mbylljes së Plenumit XV më 1965 gjer në Plenumin IV më 1973, në fjalën e mbajtur në Sekretariat në dhjetor 1974 dhe në Raportin e Kongresit VII ku jepen orientimet kryesore për punën e forcave krijuese artistike në kushtet e tanishme.

## 2

Nga materialet e paraqitura në këtë përmbledhje, si edhe nga gjithë dokumentet e Partisë dhe veprat e shokut Enver, dalin problemet themelore të orientimit politik,



ideologjik e estetik të kulturës, letërsisë e arteve. Është e kuptueshme se në orientimin dhe formimin ideologjik të shkrimtarëve dhe artistëve lozin rol përcaktues të gjitha materialet e Partisë, të karakterit politik, ideologjik e ekonomik, ato mbi analizën e luftës klasore, mbi ndërtimin e socializmit etj. Këtu bëhet fjalë për një ndihmë më të drejtpërdrejtë e më të posaçme mbi probleme të letërsisë e arteve.

Çfarë idesh themelore na bien në sy duke lexuar këtë përmbledhje, ç'përshtypje na bëjnë këto dhe ç'detyra mund të nxjerrim lidhur me të sotmen? Natyrisht, qëllimi i këtij artikulli është të japë një vështrim të përgjithshëm mbi këto materiale, të cilat për herë të parë botohen në një vëllim më vete. Ashtu sikundër kanë qenë edhe deri tani, mësimet e Partisë dhe të shokut Enver do të jenë gjithmonë e më shumë në qendër të studimeve tona, të kritikës e duhet të bëhen edhe punime të imta e të thelluara për ta parë mendimin estetik të partishëm në plan historik e problemor, për të nxjerrë më mirë në shesh momentet më të mprehta e të reja që janë theksuar si edhe për të kapur e analizuar në raste të caktuara, probleme të veçanta në lidhje të ngushtë me krijimtarinë, me fenomenet e saj të kaluar dhe të sotme.

Po të bënim një karakterizim e të mundoheshim të arrinim në një përgjithësim, do të thoshim se tipar dallues i qëndrimeve dhe interpretimeve që botohen në këtë përmbledhje është mbështetja në teorinë marksiste-leniniste, metoda dialektike në vlerësimin dhe analizën e fenomeneve letrare-artistike të së sotmes dhe së kaluarës. Në lidhje të ngushtë me këtë metodë është edhe shpjegimi i fenomeneve artistike sipas ligjeve të zhvillimit të shoqërisë, duke i vendosur konkretisht në histori; interpretimi pra i aspekteve të ndërlikuara ideoestetike sipas materializmit historik. Për domosdoshmërinë e njohjes dhe të studimit të shkencës marksiste-leniniste si shkencë bazë, sipas të cilës duhet të analizohen fenomenet, shoku Enver flet në takimin me përfaqësuesit e inteligjencës së kreqytetit më 1962. Duke folur për historianët (këto mësimë vlejné fare mirë

edhe për shkrimtarët, artistët e studiuesit), ai thotë: «Si mundet specialistët tanë të shoqërisë socialiste, ose, më konkretisht, për shembull, historianët tanë t'i interpretojnë drejt faktet dhe dokumentet, të nxjerrin prej tyre konkluzione të drejta, pa njohur thellë ligjet e përgjithshme të zhvillimit të shoqërisë, formacionet shoqërore, zhvillimin ekonomik të vendit në një kohë të caktuar, kryqëzimin e interesave të klasave të ndryshme etj., që i kanë mësuar në një farë mase qysh në shkollë?» (f. 153-154).

Vështrimi dialektik i procesit të zhvillimit të artit tonë ndihet thellë në materialet e këtij vëllimi, e përshkon atë. I tillë është vlerësimi që u bën shoku Enver hapave të para të krijimtarisë me frymë popullore e të partishme, duke i ngritur mbi veprat formaliste të artit për art dhe mbi atë me tendencë të gabuar. Kështu, Partia dhe shoku Enver kanë vlerësuar romanet e para, novelat, këngët, operat, dhe operetat e para, pikturën dhe skulpturën. Kanë ndjekur me një kujdes atëror krijimtarinë e letrarëve e artistëve të rinj, si të atyre që vinin nga Lufta dhe bashkë me pushkën sillnin edhe penën e mprehur atje, ashtu edhe të të rinjve të sotëm që vijnë e shtohen dhe kanë të ardhmen përpara. Nga grumbullimet sasiore do të vijë edhe cilësia; rezultatet e mëdha nuk arrihen menjëherë, po duan punë; përmbajtja është e lidhur me formën dhe në këtë unitet vendin kryesor e zë përmbajtja, tendenca, ndonëse forma nuk mund të nënvleftësohet, — këto dhe të tjera porosi ka dhënë e jep herë pas here shoku Enver duke folur për problemet e letërsisë dhe arteve.

Toni dashamirës, frymëzues, përkrahës i së resë dhe denoncues i së keqes, kritika ndaj dobësive dhe mungesave karakterizon bashkëbisedimin e madh të Partisë dhe të shokut Enver me shkrimtarët, artistët dhe gjithë punonjësit e kulturës. Gëzimi për lindjen e një arti të ri, që rritet vazhdimisht dhe edukon masat punonjëse me idealet e komunizmit, është një gëzim real dhe i ligjshëm i një Partie dhe i një populli të çliruar, që lindën dhe edukuan talentet e reja, që shohin si zbatohen në këtë fushë parimet marksiste-leniniste dhe si i kundërvihet arti ynë socialist



pseudoartit dekadent dhe revizionist. Në fjalën e mbylljes së Plenumit IV të KQ të PPSH, në qershor 1973 duke folur për deviacionin e djathtë të F. Paçramit e T. Lubonjës, duke demaskuar katërcipërisht veprimtarinë dhe pikëpamjet e tyre, ndërsa u dorejtohej atyre, shoku Enver tha, me një ndjenjë krenarie, që i frymëzon e u jep krahë shkrimtarëve dhe artistëve: «Ju nuk mund të identifikoheni me njësitet e mëdha e të çelikta të shkrimtarëve, poetëve, kompozitorëve, këngëtarëve e artistëve popullorë të talentuar, të vjetër e të rinj nga mosha...» (. 468). Në këtë dhe shumë raste të tjera, si në fjalën e 20 Dhjetorit 1974, në Kongresin VII, shoku Enver ka afirmuar krijimtarinë tonë pozitive, ka folur për perspektivat e saj të qarta nën udhëheqjen e Partisë, duke u mbështetur gjithmonë te populli, te puna dhe jeta e tij, te trualli kombëtar.

Po për komunistët është e huaj euforia, entuziazmi i sipërfaqshëm. Partia gjithmonë, me një sy objektiv dhe me urtësi, ka vënë në dukje edhe dobësitë, shfaqjet e huaja, ndikimet liberale e konservatore dhe ka udhëhequr për të çelur perspektiva të reja. Në këtë mënyrë, duke siguruar një udhëheqje të drejtë ideologjike, ajo ka zbatuar kërkesën kryesore të partishmërisë komuniste, e cila lidhet me interpretimin revolucionar e të partishëm, me tendencën klasore proletare të pasqyrimit të jetës.

Pra, zbatimi i teorisë marksiste-leniniste, orientimi i krijuesve drejt studimit të thellë të saj dhe të jetës, partishmëria komuniste në kriteret e vlerësimit dhe të analizës së fenomeneve të artit është tipari më themelor që përshkon qëndrimet dhe mendimin e Partisë dhe të shokut Enver për letërsinë dhe artet.

Një karakteristikë tjetër e lidhur dhe e përcaktuar nga konceptimi marksist-leninist, në këto materiale, është të shikuarit e procesit letrar-artistik, e rrugës së zhvillimit të tij, në prizmin e luftës së klasave në plan ndërkombëtar e kombëtar. Kjo luftë është zhvilluar kundër deviatorëve, si kundër liberalizmit ashtu edhe kundër sektarizmit, duke pasur parasysh si Sejfulla Malëshovën, ashtu edhe Koçi Xoxen, që prej këtyre e gjer te Fadil Paçrami e Todi Lubo-



nia, të cilët u munduan t'u hapin udhën rrymave moderniste-dekadente e revizioniste në art me synime antiparti dhe antikombëtare. Kjo ka qenë një luftë e ashpër midis marksizëm-leninizmit dhe oportunizmit të çdo ngjyre, midis realizmit socialist dhe shtrebbërimeve moderniste e revizioniste, që ka sjellë në fitoren dhe konsolidimin e mëtejshëm të pozitave të realizmit socialist. Lufta e klasave në letërsi dhe arte nuk është parë vetëm në aspektin politik, të luftës kundër deviatorëve, agjentëve dhe armiqve, të cilët luftonin letërsinë dhe artin tonë me qëllime të caktuara. Shfaqjet e huaja në vepra të veçanta kanë qenë rezultat i presionit borgjez-revizionist dhe sidomos në Plenumin IV këtyre iu dha një goditje e ashpër. Shoku Enver, në fjalimet dhe raportet e tij erdhi duke e zbuluar gjithmonë e më thellë procesin e luftës së klasave në letërsi dhe arte që nga fjala në Presidiumin e Kuvendit Popullor, në janar 1973, në mbledhjen para komunistëve të aparatit të KQ dhe në raportin e fjalën e mbylljes së Plenumit IV, në qershor 1973. Ky problem u trajtua gjerësisht në Raportin e Kongresit VII, për të gjitha sferat e jetës e po ashtu edhe për kulturën e artin.

Një mësim i rëndësishëm i shokut Enver është zhvillimi dhe vëllimi i luftës në të dy krahët, si kundër liberalizmit ashtu dhe kundër konservatorizmit. Të kërkoje se cili ishte rreziku kryesor dhe të predikojë se duhej luftuar, në radhë të parë, konservatorizmi, duke lënë mënjanë liberalizmin, sic bënte F. Pacrami, kjo ishte në kundërshtim me vijën e Partisë dhe, në të vërtetë, i hapte rrugën borgjezisë dhe revizionizmit. Shikimi dialektik i këtij problemi ka një rëndësi të madhe aktuale. Duke folur për problemin e luftës klasore, shoku Enver ka theksuar se rreziku kryesor ka qenë dhe mbetet oportunizmi i djathtë, revizionizmi.

Tipari i analizës dhe vlerësimit klasor të letërsisë dhe arteve dhe të rrugëve të zhvillimit të tyre është shumë i çartë dhe i dallueshëm në këto materiale të cilat janë mësim të mëdha për të gjykuar të kaluarën e të sotmen e për të hedhur dritë edhe në të ardhmen. Kështu, arti ynë është parë si një ndihmës i Partisë për edukimin e njerëzve

tanë, për formimin e botëkuptimit të tyre marksist-leninist, kundër botëkuptimit borgjez e mikroborgjez, kundër helmeve të botës së vjetër (fjala e 20 Dhjetorit 1974). Duke folur për tendencën e qartë që duhet të ketë vepra artistike, shoku Enver thotë: «Prandaj duhet të kemi kurdoherë parasysh se mbajtja qëndrim në letërsi dhe në art është pjesë e luftës politike që bën Partia jonë marksiste-leniniste, në unitet të plotë mendimi dhe veprimi me popullin e vet. (f. 217)

Shoku Enver u bën thirrje shkrimtarëve dhe artistëve që të lozin një rol të ndieshëm për formimin e ndërgjegjes së njeriut, i cili do ta fitojë në procesin e jetës dhe të luftës së klasave. «Universaliteti» i kësaj ndërgjegjeje, siç pretendon borgjezia, nuk mund të dalë jashtë cageve klasore. Misioni i shkrimtarit në shoqërimë tonë është shumë i lartë: ai ndikon në shpjegimin e drejtë të fenomeneve shoqërore dhe intime, në përgatitjen shpirtërore të njeriut punonjës, në kthesat e mëdha historike për të kuptuar p.sh. drejt kolektivizimin, hedhjen e bazave të socializmit, ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste. Detyra e shkrimtarit, e artistit është të hyjë në proceset e jetës dhe në ndërgjegjen e njeriut, pa rënë në subjektivizëm dhe duke e parë njeriun me botëkuptim të caktuar klasor.

Një tipar tjetër i rëndësishëm që del qartë duke lexuar përmbledhjen «Mbi letërsinë dhe artin», si edhe gjithë dokumentet e Partisë dhe veprat e shokut Enver, është zbatimi i parimeve marksiste-leniniste në kushtet e realitetit tonë, thellimi dhe pasurimi i tezave mbi probleme të artit. Këto mendime shtjellohen në kushtet e ashpërsimit të luftës klasore, të agresionit ideologjik të imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik, të luftës kundër oportunitizmit. Pikëpamjet e Partisë sonë mbi probleme themelore që kanë të bëjnë me zhvillimin e kulturës dhe të artit nisen nga ky realitet, i cili kërkon forcimin e pozitave të partishmërisë proletare dhe, përgjithësisht të metodës së realizmit socialist, shpjegimin më të thelluar dhe aktual të një varg kategorish dhe nocionesh teoriko-artistike, për të cilat klasikët e marksizëm-leninizmit kanë



hedhur baza të shëndosha. Të tilla janë problemi i karakterit klasor të artit tonë socialist, i thellimit të partishmërisë komuniste, i lidhjes dialektike midis traditës e novatorizmit, i karakterit popullor kombëtar të artit, i rolit të folklorit dhe i vendit të tij në kulturën artistike të sotme, i lëvizjes amatore, i kritikës, etj. Duke u nisur nga qëndrime materialiste në të shikuarit e artit dhe nga parimet kryesore të realizmit socialist, është theksuar gjithmonë domosdoshmëria e njohjes së jetës, të njeriut punonjës. Idetë subjektiviste, ëndërrimet nëpër dhoma të mbyllura pa përshtypjet dhe njohjen e gjithanshme të realitetit, nuk mund të shpien veçse në subjektivizëm, në vepra të cekta e formaliste. Parimin e mbështetjes në realitet, në njohjen e gjërave, siç dihet, e kishte të qartë edhe metoda realiste; e reja në realizmin socialist është pajisja me botëkuptimin marksist-leninist, që të lejon të hysh më thellë në proceset jetësore dhe të shohësh realitetin si revolucionar, me zhvillimin dhe specifikën e tij. Prandaj ne nuk mund të pajtohemi as me përsëritjen mekanike e të zbetë të drejtimeve të kaluara në artin tonë, as me bashkekzistencën e metodave të ndryshme në shoqërinë socialiste, siç kanë pretenduar estetë të njohur revizionistë. Lidhur me këtë problem, do të ishte me interes të rikujtonim mendimin e dhënë nga shoku Enver në diskutimin në mbledhjen e Byrosë Politike qysh më 1949: «Ka disa të ashtuquajtur shkrimtarë, tha ai, që kanë formuar vetëbindjen se pena e tyre nxjerr xhevahire. Ata, jo të bindur në jetën e re dhe duke qëndruar larg frymës së re revolucionare, përpiqen të imitojnë në mënyrë të dobët realizmin e tipit të vjetër...» (f.35). Dhe më poshtë ai vazhdon: «Shkrimtarët e rinj duhet ta braktisin këtë rrugë dhe të ndjekin rrugën e realizmit socialist, që pasqyron realitetin e ri, jetën e re, forcën e re». (f.35)

Ky mendim i shprehur nga shoku Enver qysh më 1949, duke u nisur nga praktika e letërsisë së vendit tonë, kur po dilte më në pah lufta ideologjike midis realizmit socialist, që atëherë kishte marrë një formë më të përcaktuar e më të plotë, dhe elementëve liberalë e anakronikë, të

cilët dilyn edhe në vepra të veçanta e ishin dukur edhe në vitet e para pas çlirimit në revistën «Bota e re», i pajistë shkrimtarët e artistët me një konceptim të drejtë të artit të ri socialist dhe i paraprinte luftës kundër revizionizmit e modernizmit që do të bëhej më e hapur dhe më e dukshme në vitet e mëpastajme.

Me qëndrimin e vet krijues, duke i qëndruar besnike parimeve marksiste-leniniste, Partia jonë ka përcaktuar një konceptim të drejtë të realizmit socialist, të cilin e sheh si një metodë krijuese në zhvillim e sipër, jo në forma të ngurta e statike, por që evoluon me dinamikën e jetës. Këtu qëndron forca e pashtershme e kësaj metode, përtëritja e saj e përhershme dhe lufta që ajo i bën si largimit nga normat estetike revolucionare, ashtu edhe qëndrimeve skolastike e dogmatike. Ky interpretim është një përgjigje e qartë edhe për ata krijues, lexues e artdashës të ndershëm nëpër botë, të cilët, të turbulluar nga propaganda borgjeze e revizioniste nuk e kuptojnë dot lehtë karakterin krijues të realizmit socialist. Disa prej tyre, si miq të vendit tonë, kur lexojnë veprat tona, ose bien në kontakt me artin e sotëm shqiptar kuptojnë më mirë se si tek ne fjalët nuk ndahen nga vepra dhe teoria nga praktika.

Krahas këtyre tipareve që mendojmë se spikatin në tërësinë e materialeve, bie në sy gjithashtu se zbatimi i ligjeve të përgjithshme të shoqërisë në letërsi dhe arte, mirret në specifikën e vet, shihet në lidhje të ngushtë me gjuhën e veçantë të artit dhe me veçoritë e arteve të ndryshme. Kjo ndihet fare qartë në trajtimin e problemeve të përgjithshme dhe të veçanta, në inkurajimin e mënyrave dhe stileve të ndryshme brenda parimeve estetike revolucionare, në gjerësinë me të cilën i shikon shoku Enver autorë dhe vepra të llojeve të ndryshme, që militojnë për një çështje të përbashkët. Problemi i përjasjes së kohëve, i pasqyrimin të perspektivës revolucionare shihet në lidhje të ngushtë me specifikën e çdo arti, duke luftuar largimin nga e vërteta si dhe banalizimet. Shoku Enver në të gjitha rastet, e sidomos me përparimin më të madh të artit tonë, në etapat e mëvonshme, ka folur për ngritjen e ni-



velit ideologjik dhe artistik, kundër botimit apo shfaqjes në teatër të veprave të dobëta, kundër qëndrimeve konformiste, mosprishjes së qejfit apo mbajtjes së hatëreve etj...

Veçoria e punës së artistit, e cila kërkon njohje të jetës, qëndrim me afat të gjatë në qendra pune e fshatra, po edhe lëvizje nga njëri vend në tjetrin për të njohur më mirë atdheun dhe njerëzit, kërkon kohë dhe studim të vazhdueshëm, duhet parë gjithashtu në lidhje me militantizimin e figurës së tij si aktivist shoqëror, mendimtar, njohës të historisë, të ekonomisë e të çdo problemi me të cilin jeton populli dhe Partia.

Këto do të ishin disa nga karakteristikat dhe përfundimet që nxjerrim duke lexuar përmbledhjen «Mbi letërsinë dhe artin». Në lidhje të ngushtë me këto përvijime kryesore do të shohim shkurt disa nga problemet që mendojmë se kanë një tingëllim të veçantë aktual, pa u ndalur veçanërisht në ato që janë rrahur më tepër.

### 3

Letërsia dhe arti shqiptar i realizmit socialist, të drejtuar nga mësimet e Partisë, kanë arritur rezultate të mëdha. Pas Plenumit IV e këtej pati një zhvillim të dukshëm; u luftuan ndikimet e huaja që ishin vënë re në vepra të veçanta. Ky përparim i mëtejshëm, që ndihet si në sasi ashtu edhe në cilësi, me luëlzimin e gjinive si romani, filmi, poema, baleti e gjinitë e mëdha muzikore, piktura e skulptura, është një vazhdim i natyrshëm i etapave të mëparshme të zhvillimit të artit socialist. Kjo u arrit, siç u përmend, me një luftë të ashpër që bëri e bën Partia dhe forcat krijuese si ndihmëse të saj kundër armiqve, presionit të huaj dhe mbeturinave të botës së vjetër në ndërgjegje. «Sa drejt kanë luftuar Partia dhe njerëzit e artit e të kulturës sonë popullore, — tha shoku Enver në fjalën e mbylljes në Plenumin IV të KQ të PPSH, — për të spastruar ferrat që mbytnin këtë kopsht kaq të lulëzuar dhe e nxorën në dritë dhe në bazën e saj, duke ndjekur tradi-

tën e bukur, krjuan vazhdimin e natyrshëm të saj, kulturën e një vendi socialist, të mbështetur fort në truallin dhe në gurrën kombëtare, i ruajtën asaj format e bukura dhe i zbukuruan përmbajtjen, i dhanë përmbajtjen socialiste revolucionare.» (f. 466)

Forcimi i mëtejshëm i kësaj përmbajtje socialiste dhe i formave të bukura që marrin frymëzim nga tradita, nga populli ynë dhe i përvetësojnë ato në mënyrë krijuese, është një problem i përhershëm dhe aktual. Gjatë gjithë viteve të jetës së Partisë shoku Enver e thekson vazhdimisht këtë moment si më themelorin. Pohimi i realitetit të ri socialist është aspekti më i rëndësishëm i brendisë së artit tonë. Por ky pohim nuk mund të bëhet në mënyrë metafizike; ai bëhet dialektikisht, duke mohuar të vjetrën, duke denoncuar botën borgjeze e mikroborgjeze, rrjedhimet e rënda të psikologjisë së pronës private në ndërgjegje, mbeturinat fetare, klerin dhe armiqtë e sotëm imperialisto-revizionistë. Pasurimi i brendisë arrihet si me njohjen e jetës, ashtu edhe të kulturës, të historisë, të mësimave të klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe të Partisë sonë. Kështu në vepra do të tingëllojnë më mirë virtytet komuniste, morali i shoqërisë së re, që do të formojë edhe më mirë e do të pregatisë shpirtërisht njerëzit kundër botëkuptimeve të huaja. Ne kemi mjaft vepra që arrijnë të kryejnë me mjeshteri këtë mision, por problemi mbetet kurdoherë i mprehtë dhe kërkon një thellim të mëtejshëm edhe të kritikës e të studimeve për t'i analizuar veprat me këtë sy.

Lidhur me aspektin e botëkuptimit revolucionar e të partishmërisë shoku Enver ka shtruar gjithmon me forcë edhe atë të karakterit popullor e kombëtar të artit. Ai ka folur në të gjitha dekadat për kulturën nacionale, për krijimin dhe forcimin e Teatrit Kombëtar, për të njohur stilin popullor e kombëtar (sidomos për arkitekturën). Në Kongresin VII, në raport, u theksua veçanërisht ky problem, në kushtet e sotme ndërkombëtare të luftës kundër superfuqive, kur mbrojtja e kulturave nacionale lidhet hap-tazi edhe me mbrojtjen e pavarësisë së popujve, të historisë dhe të së sotmes së tyre.



Problemi i karakterit kombëtar, i rrahur herë pas here edhe më shumë kohët e fundit, nëpër plenumet e Lidhjes e në mendimin tonë kritik është aktual dhe ka të bëjë me forcimin e mëtejshëm të artit tonë, me shfrytëzimin më të mirë krijues të traditës e të folklorit dhe të pasqyrimin të realitetit socialist. Lufta për të ruajtur pastërtinë ideologjike dhe karakterin kombëtar është e vazhdueshme dhe kërkon një vigjilencë të vazhdueshme në artet e ndryshme, që të mos depërtojnë ndikime të huaja, të mos bëhen shartime siç kanë ndodhur e janë kritikuar. Ne shkojmë drejt forcimit të karakterit kombëtar, por kërkohet një njohje më e thelluar e problemit dhe zbatim në kushtet tona, të ndërtimit të shoqërisë socialiste. Në shumë materiale të kësaj përmbledhjeje si dhe gjetkë problemi i karakterit kombëtar merret i pashkëputur nga ai i internacionalizmit proletar. Kështu p.sh. thuhet në përshëndetjen me rastin e 20-vjetorit të Teatrit Popullor, e në shumë raste të tjera. Vija e Partisë është e qartë, qëndrimi i artit tonë është revolucionar, ashtu si gjithë vija politike e saj. Internacionalizmi nuk ka asgjë të përbashkët dhe është krejt në kundërshtim me imponimin e kulturave «të mëdha», siç spekulojnë revizionistët sovjetikë ndaj kulturave të popujve më të vegjël. Marksizmi e flak këtë qëndrim shovinist dhe ngre flamurin e barazisë së popujve dhe të kontributit të kulturave kombëtare në thesarin e kulturës botërore.

Në këtë mënyrë konsekuente, që nga dokumentet e para deri në Kongresin VII, shoku Enver ka demaskuar vazhdimisht kozmopolitizmin dhe nacionalizmin borgjez. Ja ç'thotë te këshilla për shkrimtarët e rinj më 1949: «Ne jemi kundër kozmopolitizmit, sepse kozmopolitizmi përpiqet të zhdukë dashurinë për vendin tënd që duhet ta kemi kurdoherë të pakufishme. Për kozmopolitët borgjezë ndjenjat dhe idealet e popullit janë të huaja». (f. 35). Kozmopolitizmi dhe i ashtuquajti «ndërkombëtarizim» i artit demaskohen edhe në Kongresin VII.

Shoku Enver ka kritikuar si ksenomaninë, ashtu edhe ksenofobinë, si dy ekstreme të dëmshme, duke vënë theksin te forcimi i kulturës kombëtare socialiste. Ai ka çmuar

kurdoherë artin përparimtar të së kaluarës, autorë të mëdhenj si Eskilin, Shekspirin, Molierin, Dideronë, Hygonë, Balzakun, Verdin, Bizenë, Gorkin etj. Ai ka theksuar njohjen e thelluar sociale dhe estetike të veprës së këtyre autorëve, të kushteve kur kanë dalë këto vepra, në luftën e popujve kundër pushtuesve, për të vendosur lirinë nacionale apo të ashpërsimit të luftës klasore që kanë shprehur. Njohja e cekët e formale e autorëve të huaj apo edhe e autorëve tanë të së kaluarës të shpie në gabime, në imitime të dëmshme dhe në humbjen e personalitetit si artist.

Midis problemeve dhe aspekteve të ndryshme, të bëjnë përshtypje edhe orientimet që jep shoku Enver për trajtimin e temës historike. Njohjen e së kaluarës dhe pasqyrimin e saj ai e quan të nevojshme për të kuptuar se ç'rrugë ka bërë populli ynë që erdhi gjer në ditët e sotme, ç'kemi trashëguar dhe ç'duhet të mbajmë prej saj. Në dy materiale jepen porosi të veçanta për Monumentin e Pavarësisë në Vlorë (letër skulptorëve K. Rama, M. Dhrami dhe Sh. Hadëri) dhe në bisedën me punonjës të kulturës e të artit në Shkodër më 1962 për dramën «Plaku i maleve», kushtuar figurës së Bajram Currit. Në këto dy raste shoku Enver bën sugjerime konkrete, të cilat janë një sintezë e mendimit mbi konceptimin dialektik të temës historike, të lidhjes së saj me të sotmen dhe me perspektivën.

Duke folur për Monumentin e Pavarësisë ai thekson se, në këtë vepër, ideja themelore duhet të jetë: liria fitohet me pushkë. Uniteti i popullit dhe forca e tij duhet të ishin në qendër të vëmendjes. Ai thotë se figurat duhet të dilnin në sulm e jo në mënyrë statike dhe shprehet kundër stilizimeve të jashtme. Figura e Ismail Qemalit, do të vendosej në qendër, por jo e shkëputur nga populli dhe nga luftrat legjendare të tij. Shoku Enver tërhiqte vëmendjen se ideja e shpirtit patriotik e revolucionar të popullit tonë, nuk mund të bëhej me përzierje motivesh, po brenda temës së caktuar. (Siç dihet, këto këshilla ndihmuan skulptorët për të bërë një vepër të denjë).

Te «Plaku i maleve» dilnin disa ide të përfaqësuara me këto, si lidhja e heroit me masën, etj., ndonëse shoku



Enver në atë bisedë (ku, në përgjithësi e vlerësoi dramën) bënte vërejtje edhe për punë të thellimit në temën dhe idenë qëndrore, të heqjes së skenave të tepërta dhe që nuk lidheshin me subjektin, pra trajtoi çështje të përmbajtjes dhe të mjeshtërisë. (Është për të ardhur keq që në skenat tona teatrale nuk kemi tani ndonjë vepër mbi figurën heroike të Bajram Currit!)

Nga këto porosi dhe nga raste të tjera dalin dy mendime kryesore: 1) Veprat historike duhet të përshkohen nga ide revolucionare, duke ruajtur të vërtetën historike dhe 2) konceptimi i masës dhe i heroit duhet të jetë dialektik e materialist për të treguar se masat e bëjnë historinë, heronjtë dalin prej tyre dhe lozin rol pozitiv kur përfaqësojnë interesat e popullit.

Këto ishin disa nga problemet dhe përshtypjet prej leximit të kësaj përmbajtjeje. Ka shumë aspekte më të përgjithshme e më të veçanta që duhen studiuar e analizuar.

Mësimet e Partisë dhe të shokut Enver mbi letërsinë dhe artin udhëheqin në një rrugë të drejtë marksiste-leniniste, në rrugën e zhvillimit dhe lulëzimit të artit tonë socialist. Mësimet e shokut Enver mbi letërsinë dhe artin, që na jepen tani të përmbledhura në këtë vëllim, për shkrimtarët, artistët, kritikët e studiuesit, pedagogët, mësuesit, studentët, nxënësit e çdo lexues janë udhëheqje për punën krijuese, burim frymëzimi, dijesh e kulturë marksiste-leniniste. Ato janë një dokument revolucionar në luftën për mbrojtjen e artit të realizmit socialist.

1977

## **FRYMËZIMI POPULLOR, TRASHËGIMIA DHE E SOTMJA NË ARTIN TONË SOCIALIST**

*Duke lexuar vëllimin e 21-të të veprave të shokut  
Enver Hoxha.*

Njerëzit e kulturës dhe të artit, shkrimtarët dhe artistët, ashtu si gjithë punonjësit tanë, marrin në dorë vëllimin e 21-të të veprave të shokut Enver dhe shohin atje vijën e drejtë të Partisë sonë, shohin historinë e luftës ideologjike në fushat e ndryshme të jetës, për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e teorisë marksiste-leniniste.

Viti 1961 (periudha maj-shtator, së cilës i përkasin materialet e këtij vëllimi) është viti i mobilizimit të madh të Partisë e të popullit për realizimin e planit të tretë pesëvjeçar, viti i qëndrimeve të prera dhe parimore të Partisë sonë kundër vijës tradhtarë të revizionistëve hrushovianë, të cilët po shtonin veprimtarinë e tyre antimarksiste dhe antishqiptare. Atëherë ata përgatisnin bllokadën ekonomike, politike dhe ushtarake kundër Shqipërisë socialiste.

Të gjitha materialet e këtij vëllimi hedhin dritë në atë periudhë, janë një pasqyrë e gjallë e luftës dhe e punës në vendin tonë në fazën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, fazë që sapo niste, dhe kanë një vlerë të madhe aktuale.

Partia dhe shoku Enver i kanë orientuar gjithmonë shkrimtarët dhe artistët në rrugën marksiste-leniniste, si-



pas parimeve të realizmit socialist. Të gjitha dokumentet e Partisë për këto probleme kanë qenë dhe janë një ndihmë e madhe për shkrimtarët dhe artistët, për të shpurë më përpara krijimtarinë artistike.

Në vëllimin e 21-të botohet diskutimi i shokut Enver në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, më 22 maj 1961, që titullohet «Populli kërkon që shkrimtarët dhe artistët të krijojnë sa më shumë vepra me vlerë», si edhe fjala e tij në mbledhjen me shkrimtarët dhe artistët, më 11 korrik 1961: «Populli ynë ka trashëguar një kulturë të madhe me tradita përparimtare». Në këto dy materiale shtrohen probleme me rëndësi për vlerësimin, orientimin dhe inkurajimin e krijimtarisë, për traditën dhe novatorizmin, për luftën kundër çdo gjëje të huaj, për forcimin e karakterit kombëtar të letërsisë dhe të arteve si edhe për njohjen më të thellë të realitetit.

Letërsisë dhe arteve Partia i bëri atëherë një vlerësim pozitiv, që ishte nxitje e madhe edhe për krijimtarinë e mëvonshme. «Unë mund të them me pak fjalë, — tha shoku Enver, — se pikëpamja e Partisë dhe e udhëheqjes së saj është se zhvillimi i letërsisë dhe i arteve në vendin tonë ka qenë i vrullshëm në të gjitha fushat».

Në qershor të 1961 doli vendimi i KQ të PPSH mbi letërsinë dhe artet, ku bëhej një vlerësim dhe përcaktim i fazave të ndryshme të zhvillimit të tyre dhe thuhej se dekadat e ardhshme do të shënonin periudhën e një përparimi të dukshëm cilësor. Viti kur u botua vendimi i KQ të PPSH dhe kur Partia shtroi gjerësisht detyrat e asaj kohe para krijuesve, hyn në periudhën e një zhvillimi të ndieshëm në letërsi dhe arte. Edhe periudhat e mëparshme të krijimtarisë, ajo e Luftës Anatifashiste Nacionalçlirimtare, dhe pastaj e pasluftës, gjysma e viteve 40 dhe vitet 50, fazë e zhvillimit në gjerësi, shënuan sukseset e para të rëndësishme në fushën e krijimeve letrare-artistike. Siç është pohuar shpeshherë, këto periudha janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe qëndrimet nihiliste, që mbivlerësojnë një periudhë, duke nënvleftësuar ose mohuar të tjerat, janë dënuar nga Partia.

Dihet se zhvillimi nuk bëhet nëpër rrugë të sheshta; ai ndesh në vështirësi, kalon në farkën e luftës së klasave. Ashpërsimi i luftës ideologjike, presioni imperialisto-revizionist, qëndrimet subjektive pasqyrohen edhe në fushën e krijimtarisë, ku, herë pas here, vërehen ndikime të huaja, liberale dhe konservatore, po ku, në përgjithësi, procesi i përparimit është i pandërprerë. Ecja e shoqërisë sonë përpara, botëkuptimi marksist-leninist, kristalizimi i tipareve socialiste të njeriut të ri, këto sigurojnë edhe lulëzimin e arteve në të gjitha fushat. Ato ecin në rrugë të drejtë, trangu i tyre mbetet gjithmonë i shëndoshë. Mungesa, gabime, ndikime në disa vepra ka pasur dhe procesi i luftës është i vazhdueshëm, por deviacione në letërsi dhe arte nuk ka; ato nuk kanë rënë dhe nuk mund të bien në llumin e dekadentizmit, sepse drejtohen nga Partia dhe pasqyrojnë një realitet të shëndoshë.

Kjo frymë optimiste dhe ky kujdes i madh për shkrimtarët dhe artistët që spikat në fjalën e shokut Enver në 1961, përshkon të gjitha dokumentet e Partisë për letërsinë dhe artet. Është ky unitet i fuqishëm midis Partisë dhe popullit, Partisë dhe intelektualëve krijues — garanci e zhvillimit të vazhdueshëm të krijimtarisë. Shkrimtarët, artistët e popullit tek ne janë njerëz të nderuar; veprat e tyre pëlqehen nga populli, kërkohen, kritikohen kur janë të dobëta dhe kjo siguron një zhvillim të mëtejshëm të letërsisë dhe të arteve.

Atëherë, kur foli shoku Enver më 1961, që gjallëruar lëvizja letrare; kishin dalë firma të reja, krahas atyre të njohurave. Përmbajtja e re, thellimi në jetë, sillte edhe probleme të reja si të përmbajtjes, ashtu edhe të formës. Në shtypin letrar bëheshin diskutime, sidomos për probleme të poezisë. Krahas analizave të drejta, diskutimi nganjëherë nuk bëhej për probleme themelore, kapej nga forma për të dalë te përmbajtja, kurse duhej të ndodhte e kundërta. Kështu p.sh. diskutohej për problemin e vargut, se si duhet të jetë ky, pa u thelluar shumë në konceptimin funksional të tij, në problemet e traditës dhe të novatorizmit. Është e kuptueshme se janë ngritur e do të ngrihen



edhe probleme të mjeshtërisë (për këto kemi shumë nevojë); në mënyrë të veçantë mund të studiohet vargu i poezisë shqiptare dhe rrugët e evoluimit të tij në poezinë e realizmit socialist, por mendimi ynë kritik nuk duhet të bjerë në gabime formaliste dhe problemet e formës duhet t'i marrë gjithmonë në lidhje të ngushtë me idenë, me qëllimin dhe t'i çmojë veprat jo sipas disa rregullave skolasitike, por nga efekti që kanë në popull. Partia i mësonte poetët: «Afirmohuni në vargun tuaj dhe, në rast se ju do populli, ai varg është i mirë».

Që atëherë e deri tani kaluan shumë vjet dhe parashikimet që bënte Partia kanë dalë plotësisht. Poezia shkoi përpara me forma të larmishme, duke pasuruar, në radhë të parë, brendinë e saj. U afirmuan edhe mënyra e forma të reja vargjesh, të mbështetura në traditën kombëtare, duke sjellë edhe atë pasuri ritmike e atë muzikalitet të ri që përfitonte e reja në jetë, intonacionet e reja të realitetit. Në fjalën e tij shoku Enver përmendte poetë të një brezi më të vjetër, si A.Varfi e Ll.Siliqi dhe poetë që po afirmoheshin në ato vite si I.Kadare. Realizmi socialist zhvillohet nëpërmjet formash dhe individualitetesh të ndryshme. Partia e dënoi që atëherë, që në embrion, ndarjen e gabuar në «të rinj» dhe «të vjetër», që ishte një ndarje fiktive dhe që nuk mund të kishte vend në realitetin tonë. Më vonë, në Plenumin IV të 1973, Partia do ta ngrinte me forcë të madhe këtë problem, duke luftuar armiqtë e Partisë dhe të popullit, Fadil Paçramin dhe Todi Lubonjën, që donin të fusnin përçarje midis brezave dhe të thyenin unitetin në radhët e krijuesve.

Pas Plenumit IV shkrimtarët dhe artistët u bashkuan edhe më tepër rreth Partisë dhe forcuan unitetin në radhët e tyre.

Problemet më të rëndësishme që ngrihen në fjalën e shokut Enver të 1961 lidhen me disa tipare themelore të letërsisë e arteve, me vlerësimin e traditës dhe me konceptimin e drejtë të novatorizmit, si dhe me njohjen e jetës dhe të forcimit të karakteristikave kombëtare të artit tonë. Këto probleme ngrihen vazhdimisht në praktikën krijuese

dhe prandaj gjithmonë duhet të drejtohem i te mësimet e Partisë, t'i shohim ato në faza të ndryshme historike kur janë dhënë dhe t'i lidhim me detyrat e tanishme.

Duke folur për disa nga tiparet themelore të artit tonë të ri, shoku Enver thoshte: «Një çështje tjetër që ka rëndësi të madhe është fakti se zhvillimi i letërsisë, i muzikës, i arteve figurative etj. në vendin tonë ka një karakter masiv, ka një karakter popullor dhe thellësisht demokratik. Këtu duhet të gjejmë në arsyen e vërtetë që letërsia dhe artet tona nuk kanë rënë dhe me siguri nuk do të bien në llumin e dekadentizmit borgjez».

Këto karakteristika të artit tonë socialist masiv, popullor, demokratik e kanë burimin te ideologjia jonë, te qëndrimi leninist ndaj problemeve të kulturës. Në këtë rrugë kanë ardhur duke u zhvilluar më tej llojet e ndryshme të arteve, janë përhapur në masa, kanë forcuar përmbajtjen e tyre popullore; kanë përfshirë gjithmonë më gjerë e më thellë problemet që shqetësojnë masat e gjera të popullit dhe janë bërë më të kapshme, më të afërta me masat e lexuesve. Gjykuesi më i drejtë për veprat artistike është populli. Arti po bëhet gjithmonë e më masiv; lëvizja amatore ka marrë përpjesëtime të gjera. Këtë e tregojnë festivalet e shkëlqyera folklorike, lëvizja amatore në çdo rreth, pjesëmarrja e grupeve të amatorëve nëpër koncertet e majit që organizohen çdo vit në Tiranë dhe shumë aktivitete të tjera.

Që nga koha kur foli shoku Enver më 1961 është thelluar edhe më tepër në letërsi e arte fryma popullore dhe kombëtare. Kjo ndihet si në elementet e përmbajtjes, ashtu edhe në të formës. Më shumë ka hyrë në veprat tona heroi pozitiv, përfaqësues i masave popullore, figura e komunistit, skenat ku përshkruhet veprimi i masave. Kjo ndodh në letërsi, sidomos në gjini të mëdha si p.sh. romani, në gjinitë muzikore si opera, si edhe në tablo të pikturës, në baletet e shfaqje koreografike ku lëvizja masive, vrulli dhe forca shpirtërore e popullit është diçka e dukshme dhe e qartë. Fryma popullore e artit tonë ndihet edhe në konceptimin e historisë, të fateve të popullit



në momente të caktuara historike, në konceptimin e luftës së klasave dhe të pleksjes së problemeve politike e shoqërore, problemeve që zbulojnë lidhjet e kolektivitetit me individin. Ajo ndihet në gjithë frymëmarrjen e veprës artistike, në gjuhën, ngjyrimet poetike, dialogun, humorin popullor që është aq i gjallë dhe i këndshëm. Ndër shumë vepra letrare që e shprehin qartë këtë frymë le të përmendim «Lumin e vdekur» të J.Xoxes, një vepër me taban të fortë popullor e social, me tipa të gdhendur, me luftën e përditshme dhe luftën klasore në kushtet e rënda të periudhës së paraçlirimit, dhe në poezi, një ndër poemat tona më të mira, «Nënë Shqipëri» të D.Agollit, ku frymëzimi, pamjet e jetës, kalimet lirike, detaji dhe gjuha janë të gjitha të lidhura me idenë dhe jetën e popullit. Kështu mund të flisnim për karakteret popullore të vepra e A.Buzës, N.Zajmit, O.Paskalit, K.Ramës, S.Shijakut etj. apo në muzikë për intonacionet popullore që depërtojnë gjithmonë e më shumë në vepra të Ç.Zadejës, P.Gacit, T.Dajisë, N.Zoraqit, A.Mulës e shumë të tjerëve. Edhe në teatër dhe në filmat tanë të mrekullueshëm vërshon jeta e popullit, karakteristikat tona kombëtare si në zgjedhjen e temës, problematikës ashtu dhe të ngjyrave dhe të hollësive artistike.

Kur Partia ngrinte problemin e pastërtisë ideore të artit tonë dhe të domosdoshmërisë së ruajtjes së saj, më 1961, ishte koha kur letërsia dhe arti në Bashkimin Sovjetik, nën drejtimin e klikës revizioniste, po merrnin tatëpjetën dhe po largoheshin gjithmonë e më shumë nga parimet e realizmit socialist, nga rruga e Leninit dhe e Stalinit. Duke luftuar ndikimet borgjezo-revizioniste tek ne, në ato pak vepra që u dukën, (kjo u bë sidomos në Plenumin XV të KQ të PPSH, më 1965, dhe më vonë në Plenumin IV, (më 1973) letërsia dhe artet tona u vunë edhe më tepër përballë letërsisë dhe artit borgjezo-revizionist në luftë me të, forcuan brendinë ideore dhe ecën më tej në rrugën e realizmit socialist. Para viteve 60 dhe në fillim të tyre, në Bashkimin Sovjetik kishin dalë lloj-lloj teorish që, drejtpërdrejt apo tërthorazi, mohonin realizmin so-

cialist, që mbronin një lloj «sinqeriteti» në art, që rehabilitonin plotësisht shkrimtarët dekadentë të varrosur nga revolucioni dhe që hiqnin dalngadalë çdo kufi midis artit proletar dhe artit borgjez. Kjo vijë, në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste, ka ardhur duke u thelluar dhe tani këto letërsi janë vënë në shërbim të revizionizmit, të borgjezëve të rinj, janë bërë krejtësisht dekadentë dhe antipopullore. Ato kanë rënë plotësisht në «llumin e dekadentizmit». Letërsia dhe artet tona, së bashku me letërsitë dhe artet përparimtare, revolucionare në botë, qëndrojnë përballë degjenerimit borgjezo-revizionist, duke mbrojtur interesat e popullit, të lirisë dhe të komunizmit. Letërsitë revizioniste u zhytën në këtë llum, sepse mohuan karakterin revolucionar, popullor masiv dhe demokratik që qëndron në themel të artit proletar.

Një vend të rëndësishëm në fjalën e shokut Enver të 1961 zë vlerësimi i traditave të pasura në kulturë, në letërsi, arte figurative, në muzikë, në arkitekturë. Shoku Enver nënvizon luftën e pareshtur të popullit tonë për të ruajtur pavarësinë dhe lirinë dhe këtë nuk mund ta bënte një popull pa kulturë. Qëndrimi estetik, emocional i popullit tonë ndaj jetës, ndaj punës është i dukshëm në të gjitha pamjet e realitetit, në botën shpirtërore të tij, në këngët, në vajet, në mënyrën e të veshurit, në banesat, në bukurinë e brendshme të shtëpive. Në punën e madhe dhe plot mundime, të njerëzve të thjeshtë të popullit është derdhur një shpirt prej artisti, që ka lënë gjurmë të pashlyera. Edhe te krijimtaria e kultivuar, sidomos në ato arte që kemi pasur më të lëvruara, si poezia, gjejmë shembuj të shkëlqyer të patriotizmit, gjejmë karakteristika kombëtare të qarta që na frymëzojnë sot. Duke lexuar faqet e Vëllimit të 21-të neve na pushton një ndjenjë e veçantë respekti dhe dashurie për çdo gjë të shëndoshë shqiptare, për trashëgiminë e pasur kulturore që kemi, për krenarinë e ligjshme kombëtare, e cila kurrë nuk mund të jetë e huaj për marksistë-leninistët, sepse, po nuk deshe popullin tënd, vendin tënd nuk mund të duash popuj dhe vende



të tjerë. Këto ndjenja dhe mendime zgjon te cilido punonjës i republikës fjala e Partisë dhe e shokut Enver.

Në fjalën e shokut Enver të 1961 nxirret në shesh se tradita jonë kulturore është, në radhë të parë, përparimtare; «gjejmë fare pak vlera jopërparimtare në kulturën e në letërsinë e popullit tonë...» Shoku Enver e shpjegon këtë veçori të kulturës dhe artit të popullit tonë në të kaluarën: «Kjo ka ndodhur sepse populli ynë i vogël gjatë shekujve është udhëhequr kurdoherë nga idetë përparimtare të çlirimit, të mbrojtjes së tij, nga idetë e luftërave të drejta kundër shtypësve, kundër ideologjive grabitqare imperialiste të të huajve».

Duke folur për aspekte të ndryshme të trashëgimisë sonë kulturore, shoku Enver thekson nevojën e njohjes dhe zbulimit më të mirë të kësaj trashëgimie si edhe domosdoshmërinë e zhvillimit të pasurimit të karakteristike kombëtare të artit shqiptar. Të udhëhequr nga mësimet e Partisë, njerëzit e kulturës dhe të artit kanë luftuar për të hyrë më thellë në traditë, për ta kuptuar atë në thellësi dhe në prizmin e luftës së klasave, e kanë mbrojtur nga çdo qëndrim antimarksist dhe antishqiptar, apo nga qëndrimet nihiliste dhe mospërfillëse. Është luftuar si pikëpamja që mohonte traditën, ashtu edhe ajo që e fetishizonte duke frenuar zhvillimin e së resë. Për këto probleme ka folur shoku Enver edhe në Konferencën e 17 të Partisë për Tiranën (më 1968), dhe veçanërisht në Plenumin IV. Për të vendosur në një raport të drejtë traditën dhe novatorizmin, Partia ka tërhequr gjithmonë vëmendjen. Problemi është sqaruar teorikisht, po në praktikë kanë ndodhur pështjellime dhe, kur vjen puna për analizën konkrete të veprave, në këtë vështrim, ka ende vështirësi interpretimi dhe qëndrime jodialektike. Vihet re mungesa e gërshetimit të harmonishëm midis së vjetrës pozitive dhe së resë, midis mjeteve të njohura klasike dhe bashkëkohore. Kjo ndodh në raste të veçanta, në arte të ndryshme, si p.sh. në ndonjë shfaqje koreografike ku nuk ka koncepte të qarta për lëvrimin artistik të motiveve popullore, ku këto motive ndonjëherë shihen shkarazi, në

sipërfaqe dhe ku bëhen bashkime eklektike mënyrash që nuk përqasen me njëra tjetrën.

Është e qartë se veprat tona do të pasurohen me bren-di të re, me motive të jetës sonë socialiste dhe kjo kërkon edhe pasurimin e formave, të mjeteve artistike. Por siç është pohuar shpesh, kjo nuk do të thotë që të bësh diçka si të rënë nga qielli, të deformosh traditën, të largohesh p.sh. nga muzikaliteti në poezi, nga ritmi, nga harmonia dhe eleganca e valleve popullore, nga logjika e çdo detaji artistik. Nuk mund të jesh novator, po nuk njohe traditën. Nëse vepra e dikujt nuk do të shembëllente me asgjë nga ato që ka krijuar njerëzimi, ajo nuk do të kishte vlerë. Novatorizmi është tipar dallues i artit tonë, por ai është real, i fuqishëm kur vepra arrin të zgjojë mendime, ndjenja, kur arrin të prekë, të ngjallë përfytyrime. Nëse krijuesi nuk niset, në radhë të parë, nga ideja, nga qëllimi, nga materiali jetësor dhe nga studimi i formave të kristalizuara, nuk mund të bëhet novator i vërtetë. Këtë e tregon vazhdimisht praktika. Shoku Enver na mëson që ta kuptojmë novatorizmin, në radhë të parë, në përmbajtje dhe të tregojmë kujdes të veçantë për përmbajtjen, natyrisht, pa harruar asnjëherë formën, bukurinë e veprës e harmoninë e saj artistike.

1976



## **ROLI I MADH I LETËRSISË PËR FORMIMIN E BOTËKUPTIMIT REVOLUCIONAR**

Fjala e shokut Enver në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të Partisë, më 20 Dhjetor 1974, lidhur me zbatimin e detyrave të Plenumit IV mbi letërsinë dhe artet, ishte një analizë shumë e thellë dhe e gjithanshme e Partisë sonë për problemet aktuale që dalin në këtë fushë dhe një program i madh për rrugën e zhvillimit të mëtejshëm. Me një qartësi marksiste dhe me një ndjenjë realiste e, njëkohësisht shumë inkurajuese, shoku Enver shtron dhe u jep zgjidhje problemeve më të rëndësishme që lindin në praktikën e sotme letrare artistike dhe në mendimin teorik dhe estetik, të shikuar nga pikëpamja e Partisë dhe e ideologjisë së saj.

Duke vlerësuar shumë lart letërsinë dhe artet, duke i quajtur shkrimtarët dhe artistët ndihmës të Partisë për edukimin komunist të njerëzve tanë, shoku Enver, në fjalën e tij, ngre një varg problemesh me rëndësi të madhe praktike dhe teorike, të cilat kërkojnë të zbërthehen dhe të vihen në zbatim, si problemi i botëkuptimit, i ngulitjes së normave komuniste në ndërgjegjen e njerëzve dhe i rolit të madh të letërsisë dhe arteve në këtë fushë, problemi i kritikës letrare dhe artistike, i dobësive dhe i nevojës së ngutshme për një kapërcim cilësor të saj, ai i raportit midis muzikës së kultivuar dhe asaj popullore, i analizës dhe

zbërthimit të argumentuar të degjenerimit të sotëm në artin borgjez e revizionist, që ka mohuar krejtësisht tendencën realiste. Shoku Enver u kushton një vëmendje shumë të madhe talenteve të reja, sidomos në lëmin e poezisë, thekson gjithmonë, si edhe më përpara, raportin e drejtë që duhet të ekzistojë midis materialit jetësor e ideve dhe mishërimit të tyre artistik, stilit, gjuhës, mjeteve të ndryshme që përdor njëri apo tjetri artist.

Të gjitha këto porosi, orientuese si dhe probleme, që shtron Partia në kushtet e sotme të zhvillimit të jetës sonë si edhe të vetë artit, do t'i japin një shtytje të mëtejshme letërsisë dhe arteve, janë një burim i madh frymëzimi dhe, përveç këtyre, do të ndihmojnë për zbërthimin e shumë problemeve teorike në lëmin e mendimit tonë artistik e estetik.

\*  
\*   \*  
\*

Një ndër problemet themelore, që ngrihet në fjalën e shokut Enver dhe që mendojmë se duhet të analizohet në mënyrë të veçantë, është ai i botëkuptimit revolucionar, i luftës që ka bërë dhe bën Partia për të mos lejuar ringjalljen dhe përhapjen e botëkuptimit mikroborgjez dhe borgjez. Lidhur me këtë aspekt të luftës ai trajton disa shfaqje me rëndësi të madhe ideologjike të botëkuptimeve të huaja dhe shpjegon arsyet përse është e domosdoshme të intensifikohet lufta, të kuptohet mirë se ç'është presioni ideologjik i jashtëm dhe i brendshëm.

Botëkuptimi marksist-leninist, botëkuptimi materialist dhe revolucionar, që karakterizon si dukuri tipike jetën dhe ndërgjegjen e njeriut tonë, ndesh në disa pengesa e vështirësi, që duhet të luftohen e të flaken. «Partia, — thotë shoku Enver, — duhet të krijojë në njerëzit dhe në shoqëri atë botëkuptim, ato zakone, ato ndjenja, ato shije, atë etikë, atë filozofi revolucionare që të mos lejojë pikërisht as ringjalljen e as përhapjen e botëkuptimeve mikroborgjeze e borgjeze». Për të kryer me sukses këtë nuk du-



het harruar asnjëherë së lufta midis botëkuptimeve është e ashpër dhe e vazhdueshme, se ideologjia e vjetër, apo ideologjia e sotme reaksionare, regressive nuk i lëshon lehtë pozitat e veta dhe mundohet të qëndrojë në «skutat e errëta» të ndërgjegjes duke u shfaqur në shumë forma dhe stërholime të reja. Ajo shfaqet, p.sh., siç thotë shoku Enver, në përpjekjen për të zëvendësuar konceptin idealist të nënshtrimit para fatalitetit, para një fuqie imagjinare të mbinatyrshme, para idhujve me një varg konceptesh në thelb idealiste e subjektive dhe krejt të huaja për ne si fetishizimi i burokracisë, administratës, si egoizmi, ndjenja e pronës private, ambicia, pozita. Këto koncepte dhe vese të trashëguara nga shoqëritë me klasa antagonistë nuk shkullen aq lehtë nga ndërgjegjja, prandaj duhet luftë e madhe, e thelluar në të gjitha frontet e ideologjisë që të pastrohet ndërgjegjja dhe të zënë vend më mirë në të botëkuptimi i partishëm revolucionar, ndjenja e kolektivizmit, e dashurisë për punën e vetmohimit në emër të idealit shoqëror. Është e kuptueshme se kur pohojmë këtë domosdoshmëri dhe kërkesë, jemi të vetëdijshëm se Partia ka bërë shumë punë në këtë vështrim, se realiteti ka nxjerrë njeriun e ri me ndërgjegje të lartë revolucionare, i cili çdo ditë në punë jep shembuj të shkëlqyer heroizmi dhe ndërton socializmin. Këtë realitet të madhërishtëm ka pasqyruar e duhet të pasqyrojë më shumë akoma edhe arti ynë socialist. Po ideja e thellimit të botëkuptimit, e rrënjësjes së tipareve revolucionare lind nga vetë koncepti marksist i luftës revolucionare dhe i zhvillimit të mëtejshëm, nga gjendja e sotme e ashpërsimit të luftës klasore dhe e presionit më të madh ideologjik të jashtëm dhe të brendshëm.

Forcimi i botëkuptimit revolucionar bëhet në luftë kundër mbeturinave në ndërgjegje, duke qenë të vetëdijshëm dhe duke kuptuar thellë antagonizmat e brendshme dhe të jashtme, që janë «të pandara në jetën e një populli»; ai bëhet në luftë me botën kapitaliste, me tërë arsenalin e propagandës dhe të artit të saj, haptazi apo fshehurazi, konformist, në shërbim të borgjezisë. Shoku Enver na mëson se borgjezia llogarit në atë botëkuptim që i ka mbaj-

tur njerëzit si skllevër tërë jetën. Ky botëkuptim reaksionar prej padroni, që kërkon të gllabërojë njerëzit fizikisht dhe moralisht, është përpunuar në shekuj, mbahet me një frazeologji të stërholluar; ai u përqaftua edhe nga tradhtia revizioniste, nga tërë propaganda hipokrite e social-imperializmit, që nuk shpreh tjetër veçse restaurimin e plotë të kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik, fashistizimin e jetës në këtë vend. Prandaj, kundër botëkuptimit borgjez, kundër fytyrës së egër të kapitalit dhe degjenerimit të tij të plotë, me të cilin është ndeshur në shekuj mendimi përparimtar e revolucionar, ngrihet botëkuptimi ynë marksist-leninist, kultura dhe propaganda jonë, arti ynë socialist, që i qëndron përballë këtij si një pasuri shpirtërore e sinkertë, e qartë dhe e kuptueshme, që nisat nga interesat e popullit, nga mendimi revolucionar dhe nga qëllimi për t'i bërë njerëzit edhe më të lumtur, më të fuqishëm dhe të ndërgjegjshëm për rolin e tyre në histori.

Për të nxjerrë në shesh vetitë morale të njeriut të sotëm si edhe të njeriut të thjeshtë të popullit në të kaluarën e vendit tonë, shkrimtarët dhe artistët kanë krijuar shumë vepra, që kanë ndihmuar dhe ndihmojnë në formimin e botëkuptimit të shëndoshë, revolucionar. Pikësynimet kryesore të shkrimtarëve tanë, po t'i drejtohem i letërsisë, që në fillimet e veta, gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, kanë qenë të zgjojnë ndjenjën e patriotizmit, të urrejtjes për armikun, të zgjojnë krenarinë kombëtare, duke e kuptuar këtë si revolucionarë, sipas botëkuptimit të Partisë. Shkrimtarët janë thelluar gjithmonë e më shumë në problemet e jetës dhe të njeriut, duke kapur si kontradiktat antagონiste, në shfaqjet e tyre të ndryshme, ashtu edhe kontradiktat joantagონiste, në gjirin e popullit, të cilat duhen njohur edhe më mirë, nuk duhet të ngatërrohen me të parat dhe kërkojnë një zgjidhje të drejtë e tipike, sipas shembujve që jep jeta dhe sipas perspektivës revolucionare.

Duke shprehur me mprehtësi tiparet e kohës, ngjyrat e saj, duke njohur më thellë realitetin dhe gjendjen shpirtërore të kombit, shkrimtarët kanë dhënë vepra, që vlejné



për edukimin e njeriut dhe për të luftuar konceptet e huaja. Janë shquar dhe po shquhen për nga vlerat e tyre botëkuptimore, interpretimi realist i jetës dhe pasioni revolucionar, për frymën dhe gjuhën e tyre të bukur popullore, mjaft vepra gjinish të ndryshme, të shkruara në kohë të ndryshme.

Në veprat e autorëve tanë, me kalimin e viteve si edhe kohët e fundit në vepra të D.Agollit, I.Kadaresë, T.Laços, etj., janë trajtuar më gjerë e më në thellësi problemet botëkuptimore, është pasqyruar më mirë jeta në prizmin e luftës së klasave dhe, me ngjyra realiste, i është kënduar madhësisë së popullit dhe të vendit tonë, larg idilizimeve, vështrimeve fantastike apo imagjinare, që nuk kanë bazë të fortë në realitet, siç ndodh ende sidomos në krijime poetike të disa të rinjve.

Si pasojë e formimit më të mirë revolucionar të shkrimtarëve, e njohjes së jetës në ecurinë kryesore dhe në kontradiktat e saj, kanë dalë vepra në gjini të ndryshme, që luftojnë për moralin proletar, për një etikë të re në shoqëri dhe në familje. Një varg krijimesh letrare, që kapin probleme të punës, të kalimit nga gjendja e pronarit të vogël në gjendjen e punëtorit apo të kooperativistit, që shtrojnë problemin e pronës socialiste dhe të botëkuptimit të ri, që sjellin me vete marrëdhëniet socialiste në prodhim, i bëjnë një luftë të hapur ndjenjës së pronës private, duke treguar gjithë pasojat dhe rrezikun që sjell ajo në ndër-gjegje me egoizmin, karrierizmin, ambicien, interesin e ngushtë meskin dhe mbylljen në vetvete, si një pjellë e shëmtuar e psikologjisë mikroborgjeze. Këto probleme dhe aspekte të jetës janë trajtuar në letërsi, po ndihet nevoja që të trajtohen edhe më shumë e më thellë, duke vënë në qendër të veprave heroin pozitív dhe luftën e tij reale për të mbrojtur idealet e komunizmit. Letërsia borgjeze revizioniste dallohet sot pikërisht për humbjen e çdo ideali, për të mbjellë tek njerëzit farën e falsitetit, të egoizmit të ngushtë dhe të mosbesimit, farën e nënshtrimit ndaj fatalitetit. Letërsia jonë, që u kundërvihet këtyre pseudo-veprave, ka për detyrë të forcojë luftën ideologjike dhe të

ngrejë më lart idealet e mbështetura në jetë dhe jo abstrakte, të pakapshme. «Nën udhëheqjen e Partisë, tha shoku Enver, punonjësit e letërsisë dhe të arteve të bëjnë atë punë të thellë për të luftuar ndikimet dhe helmet e botës së vjetër dhe të asaj kapitaliste e revizioniste aktuale, për të vënë në dukje dhe për të rrënjosur në karakterin e njerëzve tanë virtytet e larta komuniste». Ky mësim i shokut Enver ka një përmbajtje shumë të rëndësishme dhe lidhet me thelbin kryesor, që duhet të kenë në brendinë e tyre veprat artistike. Këtej del qartë se një vepër arti ka mision shumë të madh në luftën e sotme dhe nuk e lot dot këtë rol ajo vepër, që niset nga njohja e cekët e jetës dhe e filozofisë, që mbetet në përmasat e pohimeve të thjeshta të deklaratës së jashtme apo të skematizmit. Ky mësim nuk mund të plotësohet në qoftë se artisti nuk ka baza të shëndosha botëkuptimore dhe nëse u lë vend në veprën e tij ndikimeve të huaja. Nga ky mision i lartë, i ndihmësit të Partisë, buron edhe nderimi i madh e përgjegjësia e madhe e shkrimtarit dhe artistit.

Ne kemi vepra të mrekullueshme, që nisen nga një bazë e fortë filozofike, ku gjendet e shkrirë organikisht politika e Partisë dhe faktet jetësore. Këto vepra ndezin zemrat e lexuesve, ato i lexojnë të gjithë me ëndje dhe mësojnë prej tyre; ato janë ushqim shpirtëror dhe e shoqërojnë njeriun gjatë jetës së tij. Disa vargje të bukura që nuk harrohen, një figurë e thellë me qëndrim të guximshëm dhe vetmohues, një përshkrim i bukur i natyrës sonë, një dialog i mençur, një ndeshje e zjarhtë, emocionale e mendimit, janë pjesë të së tërës, që i mban mend njeriu, i kujton herë pas here në jetë dhe i japin zemër për të vepruar dhe për të zgjidhur problemet e jetës.

Po krahas veprave të mira, siç është thënë, ne kemi pasur edhe vepra të veçanta me dobësi ideore, me koncepte të gabuara, nën ndikimin borgjezo-revizionist. Kritika, që iu bë këtyre veprave, ka vlejtur shumë dhe është bërë një hap i madh përpara, ndonëse asnjëherë nuk mund të themi se s'ka dhe s'do të ketë probleme të kësaj natyre. Tani është e domosdoshme që të forcohet baza ideologjike botë-



kuptimore e veprave tona në planin politik, filozofik, shoqëror e moral. Ndeshja e mendimit, lufta në planin e ideve vërehet në disa nga poemat tona dhe në poezitë e kohëve të fundit që trajtojnë probleme politike. Lufta e Partisë për formimin e botëkuptimit të ri duket edhe në disa vepra të prozës, të cilat trajtojnë probleme politike, tema ndërkombëtare. Këto vepra karakterizohen nga pozitat e partishme, nga njohja e problemeve politike dhe lidhja e ideve me faktet dhe hollësitë e jetës. Lufta e Partisë për formimin e botëkuptimit të ri duket edhe në disa vepra të prozës, të cilat trajtojnë problemet e forcimit të psikologjisë së njeriut të punës, kundër mentalitetit mikroborgjez dhe meskin, për një jetë me frymëmarrje të gjerë dhe me ndjenja të vërteta socialiste. Me botimin e romaneve, që janë shkruar kohët e fundit, do të dalë në shesh më mirë si e realizojnë shkrimtarët tanë porosinë e Partisë për formimin botëkuptimor të njeriut. Vetë gjinia e romanit ka mundësi për trajtimin e gjerë dhe të shumanshëm të këtyre problemeve.

Sa kohë shkon, sa më tepër rritet shoqëria jonë dhe kërkesat e masave, aq më e domosdoshme bëhet njohja e thellë e fenomeneve të jetës nga shkrimtarët, pregatitja e tyre filozofike dhe kulturore, kapja e kontradiktave, e antagonizmit të madh me armikun, si edhe e kontradiktave joantagoniste. Era e tokës, e baltës, frymëmarrja e njeriut real, dramat shoqërore, që duan një zgjidhje të drejtë, pasioni luftarak i heroit, që çan përpara jo me fjalë të mëdha por me punë, me bindje të thella, do ta forcojnë edhe më tepër letërsinë tonë, do ta bëjnë atë më socialiste, më kombëtare dhe më të dashur për masat e lexuesve.

Nëse, kohët e fundit, drama, si gjini letrare, e për pasojë edhe teatri, nuk kanë ecur me ritmin e duhur, kjo shpjegohet me një varg pengesash burokratike, me kuptimin e cekët të kontradiktës, sidomos nga disa administratorë po edhe nga autorë e, veç asaj edhe për arsye të një natyre më subjektive, sepse nuk janë marrë sa duhet me këtë gjini forcat më serioze të letërsisë sonë. Drama e realizmit socialist ka ecur përpara, po kjo prapambetje,

që ndihet tani në krahasim me disa nga gjinitë e tjera, duhet të kapërcehet dhe të ziejë jeta teatrale në vendin tonë. Është e kuptueshme se po të mos kapet konflikti, si të thuash për brirësh, po të mos ketë një mendim filozofik, karaktere të fortë, zgjidhje të drejta, të partishme dhe realiste, drama do të na lejë të ftohtë dhe nuk do t'ia arrijë qëllimit. Po sukseset nuk arrihen menjëherë në të gjitha gjinitë njëkohësisht dhe krijimet e dobishme edhe në këtë fushë duhet të përkrahen, të inkurajohen, që të dalin pas-taj edhe vepra më të mira. Kuptimi i drejtë i kontradiktës është problem i njohjes dhe i ideologjisë, problem i qartësisë botëkuptimore të shkrimtarit dhe i pasioneve të tij për të mbrojtur një ideal, për ta bërë atë të komunikueshëm dhe të dashur për masat.

Detyrat që shtron Partia për rolin e letërsisë dhe arteve në formimin e botëkuptimit të njeriut të sotëm janë shumë të mëdha. Zbatimi i tyre shpie drejt veprave të fuqishme, me tema themelore, me një frymëmarrje të gjërë ideologjike dhe me një pasuri mendimi dhe ndjenje. Veprat e mëdha përparimtare dhe revolucionare në të gjitha kohët nuk kanë qenë kurrë me «ide» të vogla, nuk janë pajtuar me formalizmin dhe cektësinë. Vërtet edhe përmes kufizimeve botëkuptimore, po ato kanë milituar për problemet e mëdha të kohës, kanë qenë pasqyrë e saj, e revolucionit, e gjendjes shpirtërore të një periudhe apo klase, pasqyrë e aspiratave, po hera-herës edhe e iluzioneve apo diziluzioneve të pashmangshme në shoqëritë e kaluara. Për letërsinë e realizmit socialist, që trashëgon atë ç'ka pasur më të mirë në letërsitë e mëparshme, është edhe më e domosdoshme dhe më organike tendenca e qartë botëkuptimore, pozita e caktuar e shkrimtarit ndaj asaj që përshkruan. Po është e kuptueshme se ky qëndrim ideologjik shprehet me gjuhën e artit, duke depërtuar thellë në gjirin e jetës dhe me mjetet e domosdoshme që kërkon një vepër artistike. Kjo është shumë e njohur dhe e përsëritur, por e theksojmë, sepse në praktikë na takon të hasim si pikëpamje estetizante dhe formaliste, që fetishi-zojnë veçoritë e artit dhe e bëjnë atë gjithçka, ashtu edhe



pikëpamja vulgare, sipas të cilave kanë rëndësi vetëm idetë e thata, renditja e tyre mekanike dhe jo aq mishërimi artistik i tyre. Duke u nisur nga kjo e vërtetë kuptohet vetiu se realizimi i botëkuptimit në art lidhet ngushtë me realizmin (në artin përparimtar, dhe se idetë abstrakte, pa jetë, pa njeriun, pa veprën dhe botën e brendshme të tij mbeten pa vlerë dhe nuk arrijnë ta vënë lexuesin në mendime apo të zgjojnë tek ai ndjenja. Për këtë arsye problemi i botëkuptimit dhe ai i metodës artistike janë shumë të lidhur me njëri-tjetrin dhe momenti i botëkuptimit është kyç brenda parimeve të tipizimit, po kurdoherë në atë kuptim që e përmendëm. Prandaj Partia jonë, që mbështetet në marksizëm-leninizmin, i shtron në të njëjtin plan si domosdoshmërinë e idesë, të pozitës botëkuptimore të artistit, ashtu edhe nevojën e njohjes së jetës, e zhytjes në këtë proces për të mbledhur material, për të kaluar pastaj në çastin e përgjithësimit dhe të shprehjes artistike të ideve.

Klasikët e marksizëm-leninizmit, mendimet estetike të të cilëve shoku Enver na mëson t'i studjojmë në mënyrë të veçantë, i kanë dhënë gjithmonë një rëndësi të madhe problemit të botëkuptimit, të tendencës në veprën e artit. Ata kanë folur për tendencën e qartë në krijimtarinë e autorëve të mëdhenj si Eskili, Aristofani, Dantja, Servantesi. Kanë përshëndetur romanin me prirje socialiste të asaj kohe; kanë shprehur gëzimin e tyre që një poet i madh si Hajne u afrua me lëvizjen socialiste dhe shkroi vargje politike në këtë frymë. Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini i kanë parë shkrimtarët dhe artistët si pjellë e kohës, e revolucionit apo e reaksionit, si shprehje e një gjendjeje shpirtërore me një botëkuptim të përcaktuar. Në krijimtarinë më të koklavitur dhe kontradiktore të autorëve të ndryshëm, ata kanë ditur të hedhin vështrimin e tyre depërtues dhe të zbulojnë të vërtetën sociale. Kështu Engelsi shpjegoi, p.sh. natyrën e dyfishtë të Gëtes prej demokraci dhe filistini; Marksi shpjegoi krijimtarinë e një poeti romantik, me ndjenja të stërholuara dhe psherëtima sentimentale si Lamartini, me ve-

çoritë e borgjezisë frënge, që ai i shërbente dhe përpiquej «ta qetësonte». Duke folur për Dideronë, filozofin dhe shkrimtarin e madh frëng, Engelsi, në veprën e vet «Ludvig Fojerbah» ka thënë: «Nëse ka njeri që gjithë jetën e vet ia ka kushtuar «së vërtetës dhe së drejtës» (në kuptimin e mirë të këtyre fjalëve), ky ka qenë Didëroi». Siç është e njohur, krijimtarinë aq komplekse të Tolstoit, Lenini e lidhi me botëkuptimin e fshatarit, me botëkuptimin patriarkal që nuk e duronte dot kapitalizmin, po që ngurronte të lidhej me revolucionin, i penguar nga prangat ekonomike dhe shpirtërore, duke përfshirë këtu fenë, humanizmin kristian.

Duke folur, në ndonjë rast, për kontradiktën midis botëkuptimit dhe realizmit në krijimtarinë e ndonjë autori të madh (si rezultat i forcës së fakteve, i logjikës që ato kanë) klasikët në asnjë mënyrë nuk e kanë shkëputur, siç pretendojnë estetët borgjezë dhe revizionistë, momentin e botëkuptimit nga ai i krijimit. Shumë kontradikta të shkrimtarëve kanë ekzistuar edhe në botëkuptimin e tyre dhe prandaj kanë dalë edhe në vepra.

\*  
\*   \*  
\*

Letërsia jonë ka bërë një punë të madhe për të formuar ndërgjegjen revolucionare të njeriut të sotëm, për të rrënjosur tek ai tiparet e moralit komunist. Një punë edhe më e madhe i del asaj përpara. Dhe, me siguri, të udhëhequr nga Partia dhe shoku Enver shkrimtarët dhe artistët do të dijnë t'i përgjigjen kësaj detyre të madhe duke e kalitur edhe më shumë ndërgjegjen e tyre dhe duke dhënë një ndihmë të çmuar në luftën e Partisë për t'i prerë rrugën çdo ideologjie të huaj, për të formuar njeriun me virtyte të larta komuniste.

1975



## **PARTISHMËRIA DHE KARAKTERI KOMBËTAR QËNDROJNË NË THEMEL TË LETËRSISË DHE TË ARTEVE TONA**

Në situatën e tanishme të ashpërsimit të luftës ideologjike në të gjitha fushat, pra edhe në atë të mendimit estetik e të praktikës krijuese, njohja me tërë thellësinë e vet e parimeve kryesore të realizmit socialist, zbatimi me besnikëri i kërkesave të tyre, mbrojtja me argumente teorike e praktike e këtyre parimeve nga çdo deformim dhe pasurimi i tyre me përvojë të re, veprimtaria krijuese dhe lufta ideologjike në këtë fushë përbëjnë për ne një detyrë të rëndësishme. Dhe ne po e bëjmë këtë duke u mbështetur fuqimisht në ideologjinë e në parimet e estetikës marksiste-leniniste, në mësimet e Partisë sonë për këto çështje, si dhe duke u nisur nga rruga krijuese e letërsisë dhe e arteve në vendin tonë, nga përvoja tashmë e pasur e tyre dhe nga lufta që zhvillohet sot në botë midis realizmit socialist dhe letërsisë e artit demokratik, përparimtar, nga njëra anë, dhe dekadentizmit e deformimeve të shumëllojta të realitetit në letërsinë dhe në artin borgjezo-revizionist, nga ana tjetër. Në këtë luftë letërsia dhe arti ynë, me realizimet e tyre të ndjeshme, me brendinë e shëndoshë socialiste, me karakterin popullor dhe kombëtar, u qëndrojnë përballë letërsisë dhe artit borgjezo-revizionist, ngrihen si barrikadë kundër tyre. Letërsia

dhe arti ynë kanë me vete në këtë luftë edhe të gjitha ato prirje përparimtare dhe socialiste që gjenden në letërsinë dhe në artin e popujve liridashës, të shtypur, të atyre që ngrihen kundër imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik dhe gjithë reaksionit për të ruajtur pa-varësinë dhe të drejtën e zhvillimit të kulturës së tyre.

Nën udhëheqjen e Partisë dhe të shokut Enver Hoxha, të mbështetur në parimet e estetikës marksiste-leniniste letërsia dhe arti ynë nisen nga parimi i partishmërisë proletare, që qëndron në bazë të metodës së realizmit socialist. Vepra llojesh e gjinish të ndryshme, ndër arritjet më të mira, si romani, poezia, kompozimi dhe portreti në pikturë, skulptura, opera, baleti, kënga, muzika instrumentale, teatri e filmi, gjithë arti e kultura jonë socialiste, kanë në themelin e vet partishmërinë komuniste. Ky parim nuk është një parullë apo tezë abstrakte. Ai hyn dhe mishërohet në thellësinë e veprave, duke përcaktuar frymëmarrjen e tyre, veprimin kryesor, problemet ideologjike që ngrihen në to me gjuhën e artit. E ngjeshur me materialin konkret jetësor, me një njohje të thelluar dhe jo të përciptë të realitetit, fryma e partisë në një vepër arti hedh dritë edhe në rrugën e karaktereve, në zbulimin e zgjidhjen e drejtë të kontradiktave. Partishmëria komuniste lidhet me udhëheqjen e Partisë në letërsi e art. Ajo përcakton pozicionin e krijuesit, qëndrimin e tij filozofik, njohjen reale të dukurive shoqërore në procesin e zhvillimit të tyre klasor dhe jo përmes një objektivizmi të ftohtë dhe «neutral», prapa të cilit fshihet ideja e pajtimit apo e nënshtrimit para borgjezisë.

Shigjetat e helmatisura si të teoricienëve borgjezë, ashtu dhe të atyre revizionistë, ndonëse një pjesë e këtyre të fundit përpiqen të mbulohen me fraza demagogjike, janë drejtuar dhe drejtohen pikërisht kundër parimit të partishmërisë, duke e quajtur si një kërkesë «të vjetëruar», si një «disiplinë të tepërt» për letërsinë dhe artin, të cilët, sipas tyre duhet të jenë «të lirë» nga gjithçka. Shpesh estetët revizionistë, edhe kur e pranojnë parimin e partishmërisë sa për sy e faqe, mundohen ta zhveshin



atë nga thelbi i tij, nga problemi i luftës së klasave dhe e shndërrojnë në një «partishmëri» krejtësisht revizioniste, për t'i shërbyer borgjezisë së re dhe politikës së saj. Estetika revizioniste mundohet t'i shtrembërojë pikëpamjet e klasikëve të marksizëm-leninizmit, të Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit, duke i interpretuar ato në mënyrë të njëanshme, antidialektike, duke u munduar të ndajnë p.sh. Stalinin nga Lenini, apo edhe drejtpërdrejt duke e quajtur të vjetëruar pikëpamjen leniniste të parti-shmërisë në letërsi e në art.

Shoku Enver Hoxha na mëson t'i studiojmë me shumë kujdes mësimet e klasikëve të marksizëm-leninizmit për problemet e letërsisë e të arteve, si dhe mendimet e tyre për autorë të veçantë. «Klasikët tanë të mëdhenj, — thekson ai, — Marksii, Engelsi, Lenini dhe Stalini, në vepërën e tyre kolosale kanë trajtuar edhe problemet e letërsisë e të arteve. Revizionistët dhe trockistët përpiqen ta minimizojnë këtë kontribut të madh të klasikëve. Një gjë të tillë ata e bëjnë me qëllim që të hapin fushë të gjerë për qelbësirat e tyre të të gjitha gjinive që po lëshojnë si rrëke nga të katër anët» (Enver Hoxha, «Shkrimtarët dhe artistët janë ndihmës të Partisë për edukimin komunist të njerëzve tanë»)

Marksii dhe Engelsi në shumë vepra ku kanë trajtuar probleme të superstrukturës, por edhe në letra të veçanta, si në atë të drejtuar Mina Kautskit, Margarita Harknesit apo Ferdinand Lasalit e në raste të tjera, kanë folur për tendencën në letërsi e në art, për qëndrimin sipas botëkuptimit të klasës punëtore kur ishte puna për artin e ri që po lindte. Që nga koha e tragjedive të Eskilit e deri te Hajneja, Gëtja, Hygoi e shumë të tjerë ata shihnin një proces të gjatë të krijimit artistik si shprehje e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e luftës së klasave në shoqëri, e mbajtjes së një ane të caktuar. Ata kanë mbrojtur me forcë tendenciozitetin në letërsi e në art, kanë kritikuar autorë që kalonin herë në pozita të demokracisë, herë në ato të aristokracisë, apo poetë që nuk u qëndronin gjer në fund besnikë pozitave të partisë dhe të klasës pu-

nëto. Ata kanë theksuar karakterin klasor të letërsisë e të artit, kushtëzimin e domosdoshëm social-historik të veprës artistike, vartësinë e saj nga zhvillimi shoqëror. Letërsia dhe arti i proletariatit ishin atëherë në hapat e para, por përfaqësonin një prirje të fuqishme që do të bëhej shumë e rëndësishme në procesin e zhvillimit të letërsisë dhe të artit botëror.

Mësimet e Marksit e të Engelsit si dhe tërë përvoja e zhvillimit të letërsisë dhe të artit në shekuj, dëshmojnë në mirëfilli për mbajtjen e një krahu të caktuar, e një tendencioziteti klasor, për mbrojtjen e interesave të caktuara klasore. Edhe kur vepra është shumë komplekse, edhe në format përralore apo në përfytyrimet e vendeve të largëta të krijuara nga fantazia, në themel qëndrojnë kurdoherë ëndrrat dhe interesat e një klase të caktuar. Sado që janë munduar e mundohen krijuesit dhe estetët, përfaqësues «izmesh» të ndryshme, ta fshehin këtë vartësi klasore me mënyra që vijnë duke u stërholluar, prapëseprapë ajo është e dukshme dhe nuk mund të mbulohet.

Duke folur për rrymat e sotme, që shprehin kalbëzimin e kulturës borgjeze, në Plenumin IV të Komitetit Qendror të Partisë shoku Enver Hoxha tha: «Çdo ditë dalin shkolla e shkollëza «të reja» që u përngjasin sekteve e herezive të panumërta fetare. Megjithëkëtë, ato kanë një bazë të përbashkët filozofike që është idealizmi me të gjitha stërhollimet e pafund të tij. Ky është thelbi edhe i atyre rrymave që në pamje të parë dalin gjoja si protesta të majta, radikale, kundër shoqërisë zyrtare borgjeze, kundër kulturës dhe moralit të saj» (Enver Hoxha, Raporte e fjalime 1972-1973, f. 320). Ky mendim i shokut Enver Hoxha zbërthen thelbin e mjaft rrymave të sotme, të cilat, duke u nisur nga disa protesta anarkiste dhe mikroborgjeze në të vërtetë të dëshpëruara e pesimiste, predikojnë më në fund pajtimin, duke e quajtur veten të pafuqishme të ndryshojnë diçka si dhe duke e konsideruar individin të huaj për shoqërinë. Këto pretekste individualiste dhe mikroborgjeze nxjerrin edhe estetikën e tyre



e cila në forma të tjera kthehet te parulla e vjetër e «artit për art», e abstraksionizmit, e absurditetit, e ekzistencializmit dhe e «izmave» të tjera. Edhe sot, në mënyra më të kamufluara, kemi të bëjmë me po ato raporte të artistit me shoqërinë borgjeze si atëherë kur fliste Lenini për vartësinë «nga qesja me para», nga kapitali.

Parimin e partishmërisë proletare, që formuloi më qartë Lenini më 1905 në artikullin «Organizata e partisë dhe letërsia e partisë», revizionistët e sotëm sovjetikë dhe revizionistët e tjerë e kanë shkëlur me të dyja këmbët. Këtë kanë bërë prej disa dekadash me radhë revizionistët në politikë dhe në estetikë, si Lukaç, Fisher, Garodi. Këtë e kanë bërë dhe e bëjnë në praktikë shkrimtarët sovjetikë që krijojnë vepra duke qenë plotësisht në pozita të kundërta me partishmërinë komuniste dhe me revolucionin, si Shollohovi, Ehrenburgu, Tvardovski, Simonovi, Jevtushenkoja e shumë të tjerë, të cilët janë munduar të falsifikojnë historinë, periudhën revolucionare, të hedhin baltë mbi figurën e Stalinit dhe t'u hapin udhë, nën drejtimin e klikës revizioniste, gjithë varianteve të artit të sotëm borgjez. Kështu, në letërsinë e sotme sovjetike zotëron fryma shoviniste, synimi për të përlegjur politikën ekspansioniste të socialimperializmit dhe për të trullësuar mendjet e njerëzve me gjithfarsoj pilulash të sheqerosura që kanë helmin brenda, për ta larguar vëmendjen e njerëzve nga problemet e mëdha shoqërore. Tendenciozitetit komunist revolucionar, që ishte në kohën e Gorkit e të Majakovskit ia ka zënë vendin tendencioziteti borgjez, zhurmëmadh i një superfuqie, apo llumi i dekadentizmit, ku ngjarjet kridhen në labirintin e kontradiktave morale e shoqërore dhe kultivohen ndjenja të errëta, fataliste dhe pacifiste. Letërsia e sotme revizioniste është e kundërta e asaj letërsie për të cilën fliste Lenini më 1905, kur thoshte: «Kjo do të jetë një letërsi e lirë, sepse nuk do të jenë lakmia dhe karrierizmi, por ideja e socializmit dhe simpatia për punonjësit, të cilat do të bëjnë që në radhët e saj të futen vazhdimisht forca të re-

ja. Kjo do të jetë një letërsi e lirë, sepse ajo do t'i shërbejë jo heroinës së ngopur, jo «dhjetëra mijëra vetëve të shtresës së lartë» që mërzhiten e vuajnë nga dhjami i tepërt, por miliona e dhjetëra miliona punonjësve që janë lulja e vendit, forca e tij, e ardhmja e tij» (V.I. Lenin, Vepra, vëll. 10, f.38). Sot pikërisht është «lakmia» dhe «karrizmi», zbatimi i politikës së borgjezisë së re që zotërojnë në letërsinë dhe në artin sovjetik.

Nën udhëheqjen e vazhdueshme të Partisë, në sajë të kujdesit të pareshtur që kanë treguar për to Partia dhe shoku Enver Hoxha, letërsia dhe artet tona të realizmit socialist janë zhvilluar shumë, në gjerësi e në thellësi dhe, në zjarrin e luftës së ashpër klasore të udhëhequr nga Partia, kanë fituar një pjekuri të madhe ideoartistike marksiste-leniniste. Duke zbatuar parimin e partishmërisë komuniste, letërsia dhe artet tona u kanë bërë jehonë luftës e punës vetëmohuese të masave popullore, me tendenciozitet klasor proletar i kanë pasqyruar e ngritur ato në art, gjë që u ka dhënë atyre edhe një karakter të theksuar popullor e kombëtar dhe i ka bërë armë të fuqishme në duart e Partisë në punën e saj të gjithanshme për edukimin estetik e revolucionar të masave.

Parimi i partishmërisë komuniste gjendet i mishëruar në veprat tona në aspektet e veta kryesore: si ideal i socializmit dhe i komunizmit, si ideal social-estetik që vë në lëvizje mendimin dhe synimin kryesor të veprës; si pasqyrim i luftës së klasave dhe i të shikuarit të realitetit me syrin e klasës punëtore, klasës më të përparuar të shoqërisë; si perspektivë revolucionare që, mbështetur në realitetin konkret, tregon zhvillimin historik, dinamikën e fenomeneve dhe të ardhmen. Këto aspekte të partishmërisë kanë ardhur duke u kristalizuar, duke u thelluar dhe po gjejnë një zhvillim të harmonishëm brenda vepërës artistike, gjë që flet edhe për pjekurinë dhe harmonizimin më të plotë të mendimit në krijimtarinë tonë. Partishmëria komuniste u vu në jetë që në fillimet e artit tonë të ri që çau rrugët e para me poemën «Epopeja e Ballit Kombëtar» të Sh. Musarajt, në të cilën mbahet edhe



një qëndrim klasor përmes demaskimit të tradhtarëve, të klasave të larta dhe spikat fryma popullore përmes mençurisë dhe fjalës së urtë të përfaqësuesit të popullit. Ajo vazhdon e thellohet më tej në mënyrë të dukshme.

Partishmëria komuniste, parim që nisët nga botëkuptimi marksist-leninist dhe nga realiteti i shoqërisë sonë, është orientues edhe në pasqyrimin e raportit të forcave shoqërore në art, në zgjedhjen e heroit kryesor të letërsisë e të artit, i cili duhet të jetë nga radhët e masave të popullit dhe të qëndrojë në qendër të veprës, si përfaqësues i denjë i asaj mase që përbën forcën kryesore lëvizëse të shoqërisë, me koncepte të qarta filozofike dhe me qëndrime e veprime që shprehin një pozicion klasor të përcaktuar mirë. Zbatimi i partishmërisë komuniste, i botëkuptimit marksist-leninist, është orientues për çdo vepër, me çdo lloj teme qoftë ajo, duke përfshirë edhe ato historike, sepse ka të bëjë me zbulimin e idealit më të përparuar të kohës të parë në dritën e aktualitetit, ka të bëjë me pasqyrimin e drejtë të luftës së klasave dhe nënvizimin e klasës më përparimtare të asaj kohe, por pa lënë pas dore edhe kufizimet e saj, gjë që do të thotë të mos jepen kudo «zgjidhje të lumtura» dhe të harrohen tragjeditë e mëdha popullore në të kaluarën. Në veprat tona historike të arrira vërehen këto momente, por më shumë duhen bërë që të gërshetohen aspektet dhe të dalin më mirë në pah përfaqësuesit konkretë të masave punonjëse. Shembull për realizimin e temës historike mund të merret, ndër të tjera, «Monumenti i Pavarësisë» në Vlorë, vepër e K. Ramës, Sh. Hadërit dhe M. Dhramit, ku, duke zbatuar porosinë e shokut Enver Hoxha në letrën që u drejtoi këtyre skulptorëve, jepet qartë atmosfera e kohës dhe perspektiva historike, e tëra në një unitet të mendimit dhe të artit.

Letërsia dhe artet tona janë orientuar gjithmonë, në tërë fazat e zhvillimit të tyre, nga mësimet e Partisë të sintetizuara në shumë dokumente të saj, si dhe në ato ku trajtohen probleme ideologjike të lidhura me këtë fushë të veprimtarisë. Kështu, në vendimin e KQ të Partisë të

qershorit të vitit 1961 mbi letërsinë dhe artet, në takimin e shokut Enver Hoxha me shkrimtarë e artistë po në vitin 1961, në Plenumin XV të KQ të PPSH mbajtur në vitin 1965, në Konferencën e 17-të të Partisë për Tiranën më 1968, në Kongresin V e VI të PPSH, në mënyrë të veçantë në Plenumin IV të KQ të PPSH mbajtur në vitin 1973 dhe në fjalën e shokut Enver Hoxha të 20 Dhjetorit 1974 në Sekretariatit e KQ të Partisë dhe në të tjera raste, Partia dhe shoku Enver Hoxha e kanë vënë theksin gjithmonë në problemet e partishmërisë, të karakterit popullor e kombëtar, në problemet e ruajtjes së pastërtisë ideologjike të letërsisë e të arteve dhe të mbrojtjes së parimeve të realizmit socialist.

Partia kurdoherë ka orientuar dhe inkurajuar krijuesit. Ajo ka vënë në dukje gjithashtu se edhe në fushën e letërsisë dhe të arteve zhvillimi bëhet nëpërmjet luftës së ashpër klasore, kundër ndikimeve të huaja, që vijnë si rezultat i presionit ideologjik armiqësor të brendshëm e të jashtëm. Mbi baza të tilla trangu i letërsisë dhe i arteve tona ka qëndruar dhe është zhvilluar i shëndoshë. Por, siç u theksua në Plenumin IV të Komitetit Qendror të Partisë, ka pasur edhe shfaqje të huaja në vepra të veçanta. Opinioni i shëndoshë letrar dhe artistik, tërë opinioni ynë shoqëror u ngritën në luftë kundër qëndrimeve liberale, u bënë debate, u goditën ashpër pikëpamjet e huaja, të cilat dukeshin në radhë të parë në largimin nga parimi i partishmërisë proletare. Si pasojë e kësaj lufte ideoestetike, nën drejtimin e Partisë, u goditën ashpër shtrembërimet borgjezo-revizioniste, nxitësit dhe përhapësit e rrymave të huaja moderniste, armiqtë e Partisë dhe të popullit Fadil Paçrami e Todi Lubonja, u luftuan shfaqjet e deheroizmit, të kuptimit të shtrembër të kontradiktave, të simbolizmit e të konvencionalizmit në vepra të veçanta të disa lloj artesh, si teatri, poezia, piktura; u luftuan modernizmi në brendi, që lidhej me nënvizimin e një intimiteti të ngushtë dhe të sëmurë, me shkëputjen e analizave psikologjike nga analiza e thelluar klasore dhe shoqërore, me zgjedhjen e temave të vogla,



si dhe modernizmi në formë, që shfaqej me elemente hermetikë, me figura të çoroditura dhe me largimin nga njeriu për t'u futur në animizime. Si pasojë, parimi i partishmërisë proletare dhe karakteri kombëtar i artit tonë u forcua; brendia mori një kuptim më të thelluar, duke çuar përpara traditën e shëndoshë, dhe forma u bë më e qartë, më popullore, duke ruajtur bukurinë e shprehjes dhe të fjalës shqipe.

Por, me gjithë arritjet e mëdha që duken në letërsinë e artet tona, si në sasi ashtu edhe në cilësi, me gjithë forcimin e partishmërisë komuniste në to, nuk mund të thuhet se gjithçka u arrit dhe aq më tepër nuk duhet të na mbulojnë vetëkënaqësia, euforia, të dobësojmë vigjilencën ideologjike dhe të flemë mendjen mbi dafina. Është materialiste dialektike të nisemi nga koncepti filozofik marksist-leninist i lëvizjes dhe i zhvillimit përmes luftës së të kundërtave, nga koncepti i luftës së klasave që vazhdon e zhvillohet e ashpër, gjë që na i tregon edhe praktika krijuese letraro-artistike e kohëve të fundit. Është i vërtetë dhe shumë pozitiv fakti që shumica dërrmuese e veprave letraro-artistike militojnë me një frymë të shëndoshë. Por nuk kanë munguar edhe disa shkrime të botuara apo të pabotuara, si dhe krijime të disa llojeve të tjera, si në muzikë e në artet figurative, në të cilat vihen re shfaqje të moszbatimit të partishmërisë komuniste në thellësinë e duhur, shfaqje që tregojnë se nga disa autorë ky parim kuptohet përciptazi dhe nuk mbahet mirë parasysh në krijimtari. Në emër gjoja të realizmit, të paraqitjes së vështirësive, ka raste kur nxihet realiteti, nuk vihen në raporte të drejta individit me shoqërinë, deri atje sa në ndonjë vepër të pabotuar të jenë dukur edhe pikëpamje frojdiste në përcaktueshmërinë e një karakteri në vend të analizës sociale dhe të zgjidhjes së drejtë që jep jeta jonë. Doemos tipat negativë do të bëhen objekt i pasqyrimit për t'i luftuar, për të treguar shkaqet shoqërore që i favorizojnë dhe duan t'i ruajnë, por gjithmonë nga pikëpamja e Partisë, nga pozita të drejta revolucionare, duke u vënë përballë tipat pozitivë, të cilët duhet

të zotërojnë dhe t'i japin tonin veprës, si bartës të drejt-përdrejtë të idealeve të Partisë. Ka edhe raste që në ndonjë dramë raporti i klasave nuk del drejt, nuk pasqyrohet si duhet solidariteti midis klasës punëtore dhe shtresës së inteligjencies popullore, nuk tregohen me vërtetësi marrëdhëniet e udhëheqjes së organizatës bazë të Partisë me masën, gabimet dhe dobësitë nuk motivohen nga pikëpamja socialo-politike, por disi sentimentale dhe në mënyrë të cekët.

Duke vënë theksin në luftën kundër liberalizmit, lidhur me zbatimin e parimit të partishmërisë, nuk duhet harruar të luftohen njëkohësisht edhe shfaqjet e vulgarezimit në të kuptuarit e në zbatimin e këtij parimi. Ka pasur raste kur nga ndonjë autor partishmëria është kuptuar në mënyrë të përciptë; kurse ky parim i rëndësishëm nuk mund të shprehet në thellësinë e duhur me krijimin e disa personazheve anemikë, pa mish e gjak, që nuk zbërthejnë ide të thella, karaktere dhe që janë agjitativë. Ndodh gjithashtu që edhe vërejtjet për ndonjë vepër të bëhen sipas disa skemave dhe, pa hyrë në thellësi të saj, të kërkohet deri në një uniformitet tematik, duke mos kuptuar se partishmëria është botëkuptim dhe jo skemë, se ajo është tendencë revolucionare, që duhet të përshkojë veprën nga kreu deri në fund dhe që, ndër të tjera, presupozon edhe larminë e temave, gjë që do të thotë se krahas temave për probleme madhore, për të cilat kemi shumë nevojë, duhet të shkruhet edhe për vatrat familjare, për natyrën tonë e për dashurinë e pastër, por natyrisht, jo me anakronizma apo sentimentalizma si dikur dhe as nga pozita liberale. Në vetë strukturën e veprës, në konceptimin e saj të thellë qëndron fillesa filozofike dhe jo në deklaratat e sipërfaqshme.

Problemi i karakterit popullor dhe kombëtar të letërsisë dhe të arteve është një problem i rëndësishëm teorik e praktik që lidhet drejtpërdrejt me partishmërinë komuniste. Art demokratik, popullor ka pasur në të gjitha



kohët, dhe këtë traditë ne e respektojmë. Karakteri kombëtar në art është shtruar me formimin e kombeve dhe ka ardhur duke u thelluar në periudhat e mëvonshme dhe sot. Por karakteri demokratik, popullor e kombëtar i letërsisë dhe i arteve të realizmit socialist ka një ndryshim cilësor, sepse është partishmëria komuniste që vë në to vulën e vet. Kjo do të thotë se për herë të parë në historinë e letërsisë dhe të artit masat bëhen heroi i vërtetë, se lëvizja popullore shikohet nga pozita e klasës më të avancuar, të klasës punëtore, nga pozita e partisë së saj, me të cilat letërsia dhe artet e realizmit socialist arrijnë shkallën më të lartë të karakterit të tyre demokratik popullor.

Letërsia dhe artet tona kanë një frymë të theksuar, që trashëgon tiparet popullore dhe demokratike të veprës së Naimit, De Radës, Çajupit, Nolit, Mjedës, Migjenit etj. dhe i zhvillon ato në një shkallë cilësisht të re. Kështu, romane të tilla si «Lumi i vdekur» i J. Xoxës, «Ata nuk ishin vetëm» i S. Spases, «Komisari Memo» i D. Agollit, «Para agimit» i Sh. Musarajt, «Këneta» i F. Gjatës, «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» i I. Kadaresë dhe mjaft të tjerë e kanë të qartë frymën popullore në mënyrat e ndryshme të të shkruarit.

Ka qenë një kohë kur bëheshin debate deri diku fiktive se cila vepër është më popullore nga tjetra dhe ndodhte që kjo përcaktohej më tepër vetëm nga kriteri i aftësisë komunikuese të saj. Natyrisht, ky është një tipar i domosdoshëm, por jo vetëm ai përcakton frymën popullore të një vepre. Ajo përcaktohet, së pari, nga tema dhe problematika me rëndësi për historinë e një populli që kap një vepër, së dyti, nga këndi i të shikuarit, nga pozitativat e mbrojtjes së interesave të popullit dhe, së treti, nga aftësia komunikuese që duhet të ketë. Ne kemi vepra ku pleksen bukur këto aspekte, por kemi dhe të tjera që lënë për të dëshiruar. Vepra duhet parë në themel për të kuptuar brendinë popullore, demokratike dhe kombëtare të saj; por, nga ana tjetër, nuk mund të neglizhohet edhe aftësia komunikuese, sepse arti ynë krijohet për masat

dhe jo për një elitë «të zgjedhur» si në vendet borgjeze.

Letërsia dhe artet tona, sidomos disa gjini të veçanta, kanë shumë për të bërë që të pasqyrojnë masat si forca lëvizëse të historisë, të japin drejt raportin e masës me heroin dhe ta shohin këtë me sy dialektik, me vërtetësinë historike dhe në dritën e problematikës aktuale. Kjo kërkon studim të thellë të teorisë, të jetës, njohje të epokës dhe vështrim të gjerë filozofik.

Ne kemi vepra në gjini të ndryshme që e trajtojnë mirë këtë aspekt dhe kjo shpeshherë përcakton forcën dhe novatorizmin e këtyre veprave. Letërsia dhe artet vepronjë me personazhe konkrete të individualizuara. Por në letërsinë dhe në artin e realizmit socialist pasqyrimi i tyre gërshetohet gjithmonë e më shumë në skenat masive, me paraqitjen e vrullit popullor. Themelor në këtë problem është qëndrimi filozofik marksist-leninist ndaj rolit të masës në histori. Ky qëndrim të shpie pastaj në një interpretim të drejtë.

Me gjithë arritjet në këtë drejtim, edhe më tepër mundet e duhet të bëjnë për pasqyrimin e veprimtarisë së masave sidomos gjini të tilla si romani, kompozimi, skulptura apo piktura monumentale, opera e baleti. Por, në anën tjetër, kjo nuk do të thotë në asnjë mënyrë të mbetemi thjesht në paraqitje të përgjithshme dhe amorfë të masave, por të gdhendim karaktere dhe heronj konkretë të lidhur me masën që i ka nxjerrë, kurse lëvizjet masive duhen parë më thellë me vështrim klasor, pa rënë në idilizime të kota.

Problemi i karakterit kombëtar shtrohet sot me forcë të madhe për të përballuar agresionin ideologjik dhe kulturor borgjezo-revizionist, si edhe për shkaqe që lidhen me vetë zhvillimin e letërsisë dhe të arteve tona. Lindja e problemeve të reja, zhvillimi i realitetit socialist kombëtar, pasurimi i gjinive, i brendisë dhe i formave të pasqyrimin, nevoja për të rishikuar të kaluarën kombëtare nga pozitat e sotme, këto dhe të tjera motive na shtyjnë gjithashtu për ta studiuar dhe për ta pasur gjithmonë parasysh karakterin kombëtar. Edhe në plan botëror ky problem



ngrihet më shumë sot, si shprehje e prirjes së popujve dhe kombeve për të afirmuar vetveten dhe kulturat e tyre.

Karakterit kombëtar i letërsisë dhe i arteve është i lidhur me lindjen e kombit, me formimin e konstitucionit shpirtëror të një populli. Por, siç dihet, elementet kombëtare si në jetë, në psikikë, ashtu edhe në ndërgjegje kanë lindur përpara formimit të kombeve. Këto i gjejmë në historinë e popullit tonë, në folklorin e tij, dhe, më pas, në letërsinë e në kulturën e tij, sidomos në poezinë, që ka një traditë më të lashtë.

Ky problem ka qenë dhe mbetet i rëndësishëm, sepse historia e popujve, e klasave, lidhet me historinë e kombeve dhe, në një periudhë shumë të gjatë të ekzistencës së kombeve si një domosdoshmëri historike, ai do të mbetet gjithmonë i mprehtë. Partia jonë dhe shoku Enver Hoxha e kanë sqaruar këtë problem në disa dokumente dhe fjalime, duke vlerësuar traditën tonë dhe duke orientuar që gjithmonë momenti esencial i karakterit socialist revolucionar të letërsisë dhe të arteve tona, partishmëria komuniste e tyre, të merret në lidhje të ngushtë me atë të fizionomisë kombëtare.

Shoku Enver Hoxha thekson se kur luftojmë për frymën kombëtare të letërsisë dhe të arteve tona në nënvizojmë karakterin e tyre «revolucionar e socialist». Pra këto probleme merren të pandara, dhe themelore është partishmëria komuniste, janë ide të revolucionare. Por, në kushtet tona, të një kombi socialist, kur kemi dy klasa mike, klasën punëtore e fshatare dhe shtresën e inteligjencës popullore, kur është krijuar një unitet kombëtar, moralo-politik, nuk ka kontradiktë midis konceptit socialist dhe kombëtar, sadoqë është e kuptueshme se këto nuk janë identike. Kur themi frymë ose karakter kombëtar kemi parasysh traditën më të vjetër, atë më të re dhe të sotmen, ato veçori të brendisë dhe të formës që janë tipike për kombin dhe popullin tonë, i cili ka historinë e tij, tiparet e kristalizuara dhe jetën që i nënshtrohet një ndikimi të vazhdueshëm social dhe psikologjik. Kjo veçori

e temave, e problematikës, e ngjyrave, e gjuhës, e mjeteve shprehëse përbën atë që quajmë kombëtare dhe që hyn në thesarin e kulturës së përbotshme. Kjo frymë, duke pasur në themel partishmërinë, nënkupton internacionalizmin proletar, të cilin letërsia dhe artet tona e kanë në brendinë e vet ideore dhe e shprehin nëpërmjet saj, si dhe nëpërmjet shumëve të kësaj natyre që kanë kapur.

Te ne është mbrojtur e mbrohet ideja se karakteri kombëtar në letërsi e në arte duhet parë jo vetëm në formë, por edhe në përmbajtje, sepse, po ta shohim atë të shkëputur nga përmbajtja, ka rrezik të mbetemi vetëm në disa kërkesa të jashtme, në një kolonit të sipërfaqshëm dhe harrojmë kryesoren. Është theksuar gjithashtu se nga pikëpamja e brendisë ana kombëtare përcaktohet nga botëkuptimi marksist-leninist, nga partishmëria komuniste. Por nuk mund të injorohen edhe elementet e formës kombëtare, të cilat i japin veprës ngjyrat dhe aromën që e bëjnë atë të dashur dhe të afërt për masat. Ky problem është rrahur në shtypin letrar dhe nëpër diskutime krijuese dhe mund të thuhet se janë arritur disa përfundime. Por ende mbetet për ta thelluar më tej si në aspektin teorik, ashtu edhe konkret.

Duke e parë në atë raport që përmendëm elementin socialist dhe kombëtar, ku përcaktues është qëndrimi socialist, i partishëm, del fare e qartë se aspekti kombëtar është pjesë përbërëse e domosdoshme e përmbajtjes së veprës. Siç dihet, nocioni i përmbajtjes në një vepër arti lidhet me materialin jetësor, me tematikën e problematikën dhe me idenë që e përshkon atë. Por nuk ka se si zgjidhja e temës dhe e problemit të mos kenë vullën kombëtare, të parë si histori dhe si aktualitet. Për shembull, tema e rrethimit, e pritjes së agresorëve të shumtë me tëhun e shpatës dhe me grykën e pushkës, e qëndresës heroike e të papërkulur të popullit tonë kanë qenë dhe mbeten në radhët e temave kryesore të letërsisë dhe të arteve tona, si karakteristikë e popullit dhe e kombit tonë. Revolucioni dhe lufta e klasave te ne kanë edhe ato specifikën e tyre, që nuk ka si të mos gjejë pasqyrimin e vet



edhe në letërsi e në art. Edhe emancipimi i gruas, konceptimi i jetës, i vdekjes, zakonet e miqpritjes, të besës etj. kanë vulën kombëtare. Sigurisht se të gjitha këto nuk mbeten inerte, të pandryshueshme. Edhe zakonet e mira evoluojnë. Populli ynë është karakterizuar në shekuj për dhënien e mbajtjen e besës. Por tani ajo nuk u nënshtrohet më ligjeve feudale të kanunit, kur mund të hynte edhe hasmi në shtëpi dhe ishte i detyruar ta prisje. Këto zakone morën një kuptim të ri, ato u bënë dhe po bëhen socialiste, duke ruajtur çka ishte më e shëndoshë. Kjo, natyrisht ka të bëjë me brendinë dhe formën e tipareve kombëtare. Është detyra e letërsisë dhe e arteve tona t'i zbulojnë dhe t'i pasqyrojnë ato edhe më thellë e më bukur.

Problemi i formës lidhet me mishërimin konkret të këtyre elementeve në vepër me anë të gjuhës, të koloritetit e të mjeteve të tjera shprehëse, të paraqitjes së temperamentit e të tjera. Përgjithësisht letërsia jonë nuk është «e shtruar» dhe disi «e ftohtë» si ndonjë letërsi tjetër. Ajo ka shumë nerv, përshkohet nga një lloj poezie dhe romantike e kohës sonë. Neve na pëlqejnë subjektet e gjalla, dinamike, hera-herës me kontraste të forta dhe dramatike, sepse kjo shpreh temperamentin dhe dinamikën e jetës sonë. Gjuhën e duam me ngjyra të gjalla, me dialog të mprehtë dhe të individualizuar, duke nënkuptuar me këtë të fundit mënyrat dhe stilet e ndryshme.

Përparime edhe më të dukshme në forcimin e karakterit kombëtar të letërsisë dhe të arteve tona janë bërë sidomos pas Plenumit IV të Komitetit Qendror të Partisë. Më mirë janë shfrytëzuar folklori dhe pasuria shpirtërore e popullit në llojet e ndryshme të arteve.

Ne kemi luftuar dhe luftojmë largimet nga fryma kombëtare që u goditën sidomos në Plenumin IV, por që nuk janë zhdukur plotësisht edhe sot. Janë bërë diskutime për një fizionomi më të theksuar kombëtare në arte, si në koreografi, në arkitekturë. Lidhur me këtë aspekt është folur edhe për poezinë, muzikën, pikturën etj. Problemi është aktual dhe vigjilenca nuk duhet të shuhet, por të bëhet më e mprehtë, pasi lufta e klasave vazhdon dhe ndi-

kimet e huaja mund të paraqiten në forma të ndryshme.

Ndikimet e huaja në këtë fushë kanë në themel konceptin e gabuar, me nuanca kozmopolite, mbi karakterin kombëtar të letërsisë e të arteve. Mbështetja në realitetin tonë, në karakteret kombëtare, në pasurinë e madhe të krijimtarisë sonë popullore, në folklorin tonë siguron një kuptim dhe trajtim të drejtë të këtij problemi. Terren të favorshëm largimi nga fryma kombëtare mund të krijojnë shijet e huaja për estetikën tonë, ndjenja e nënshtrimit ndaj së huajës reaksionare dhe moderniste, nënvleftësimi i kulturës kombëtare që mund të përhapin elementët armiq apo të pafornuar ideologjikisht. Ne duhet të zbatojmë porosinë e shokut Enver Hoxha që të mos jemi as ksenomanë, as ksenofobë, por të mbajmë një qëndrim dialektik ndaj së huajës.

Në largimin nga konceptimi i drejtë i kombëtares të çojnë edhe mosnjohja ose nënvleftësimi i traditës kulturore kombëtare, i folklorit, si i asaj të kaluar dhe aq më tepër i traditës së re socialiste. Tradita e kaluar duhet çmuar për tërë vlerat e bukurinë e saj, por të merret në mënyrë krijuese dhe jo mekanike. Edhe qëndrimet euforike idilizuese të traditës të folklorit janë të dëmshme. Ato duhen parë gjithmonë të pashkëputura nga kushtet shoqërore dhe nga konceptet filozofike të kohës në të cilën janë krijuar, nga evolucioni që kanë pësuar, duke çmuar kurdoherë atë që është pozitive për sot. Një konceptim klasor i traditës, brenda parimit të historizmit e të kërkesave aktuale, të shpie në qëndrime të drejta. Nuk ka arsye përse të marrim, p.sh. një melodi të vjetër që ka përmbajtje moralore të huaj për ne, p.sh. një melodi fetare dhe t'i veshim asaj fjalë të reja, kur dihet se përmbajtjen e muzikës e jep në radhë të parë melodia, motivi muzikor. Po ashtu është i dëmshëm ai lloj eklektizmi në shfrytëzimin e traditës, në valle, që shprehet atëherë kur bashkohen pa kriter motive krejt të ndryshme që nuk lidhen organikisht, gjë që bëhet edhe më e dëmshme kur kemi shartim të valleve tona me të huajat. E njëjta gjë



mund të thuhet edhe për poezinë kur në ndonjë rast ajo priret pa kriter nga ritmika e huaj.

Duhet bërë një dallim midis ruajtjes së vlerave artistike të popullit si diçka autentike, dëshmi e një kohe të caktuar, dhe krijimtarisë së gjallë të sotme të popullit, që vlen si një ushqim shpirtëror, estetik. Edhe kjo krijimtari duhet drejtuar dhe mbështetur gjithmonë te tradita kombëtare, por të mos harrojmë asnjëherë se ajo është prodhim shpirtëror i socializmit dhe si e tillë, do të ketë vulën e sotme, do të evoluojë, siç e tregojnë disa valle me burra e gra, këngë korale gërshetuar me instrumenta popullore, ritmika më dinamike e disa këngëve popullore, konceptimi më bashkëkohor i ngjyrave në veshje etj. Të gjitha këto duhen pasur parasysh për një zhvillim të mbarrë të krijimtarisë sonë të kultivuar dhe amatore e folklorike me frymë kombëtare.

1976

## KARAKTERI KOMBËTAR I LETËRSISË DHE ARTEVE NË INTERPRETIMIN MARKSIST- -LENINIST

### KUPTIMI HISTORIK DHE RËNDËSIA E PROBLEMIT

Problemi i karakterit kombëtar në letërsi dhe arte ka qenë shtruar veçanërisht nga romantikët në art qysh me premisat dhe me formimin e kombit borgjez dhe ka ardhur duke u bërë më i mprehtë e më konkret me realizmin, i cili e ka trajtuar pa atë vellon romantike dhe me një shikim më të përcaktuar klasor.

Shtrimi teorik i këtij problemi dhe kërkesat estetike të shprehura nëpër manifeste drejtimesh letrare-artistike, apo në *credot* e autorëve, nuk përkon krejtësisht me praktikën krijuese. Kjo ndodh sepse, para formimit të kombeve, në kuptimin klasik të tyre, ekzistonin fiset dhe shtetet, popullsitë paraardhëse të kombeve dhe kombësitë, të cilat dalloheshin nga një varg tiparësh të përbashkëta shoqërore dhe shpirtërore. Kështu ne flasim me saktësi për veçoritë e qarta të letërsisë antike greke, e cila lindi në një mjedis të caktuar, me një botëkuptim dhe në një realitet shoqëror konkret. Koha kur «mitologjia greke, siç thoshte Marksi, përbënte jo vetëm arsenalin e artit grek, por edhe truallin e tij», kur *polisi* grek krijoi kushte për lëvrimin e artit, i cili shprehu si etjen për liri e dritë të njeriut, ashtu edhe kontradiktat e shoqërisë skllavopronare, në etapat e ndry-



shme të zhvillimit të saj, — kjo kohë dha modelet e padekshme të artit grek, që hyjnë në fillimet e artit botëror, kanë edhe vulën e tyre konkrete.

Po të hedhim një shikim shumë të shpejtë në zhvillimin e letërsisë botërore, nëpër etapa të ndryshme të saj, do të vëmë re se si evoluon dhe shpërthen ajo në cilësi të reja, duke shprehur si natyrën universale të luftës së klasave dhe karakterin shoqërisht të përcaktuar të humanizmit, si problem i klasave progresive, ashtu edhe natyrën konkrete kombëtare, ose parakombëtare, përmes premisave të kombit që do të merrte më vonë fizionomi të qartë.

Përfshihet tërësisht p.sh. në kulturën kombëtare të pënpëruar spanjolle «Don Kishoti» i Servantesit, i cili i përket edhe kulturës botërore, me tipat e problemet që shtron, me thellësinë e komizmit dhe pasqyrën e gjerë e të larmishme të shoqërisë së shek. XVI e XVII. Jo vetëm me koloritin, me mënyrën e të treguarit, me mjediset që përshkruan, po edhe me tërë realitetin dhe vulën e kontraktave të thella shoqërore, ajo veprë ka lindur në një truall konkret, kur mbretërit dhe inkuizicioni ishin bërë një pengesë e madhe për zhvillimin e shoqërisë, kur depërtonin kudo idetë përparimtare të Renesansës, me humanizmin që lindte e mëkëmbej. Gërshetimi i kontraktave të shoqërisë spanjolle, kur mbeturinat mesjetare, *hidalgot* me *ushta*, që shtegtonin majë kalit, ishin bërë një anakronizëm me gjestet e tyre kalorsiake, të nxitura nga qëllime fisnike, po të porealizueshme në një kohë të re, — kur këto mbeturina plekseshin me padrejtësitë e reja shoqërore që sillte monarkia dhe feja, marrëdhëniet e reja borgjeze, shfrytëzimi i njeriut dhe roli i parasë që vinte duke u rritur në periudhën e grumbullimeve të hershme të kapitalit, — ky gërshetim është skalitur në veprën e madhe të Servantesit dhe i japin asaj domethënie universale dhe origjinalitet të papërsëritshëm kombëtar.

Po kështu, duke parë disa kulme të letërsisë botërore, do të vëmë re tiparet kombëtare dhe vlerën e përgjithshme që ka arti i Shekspirin, i cili vjen e na emocionon dhe na trondit edhe në ditët tona. Idetë e humanizmit

evropian, të cilat kishin burim klasor të përcaktuar, gjejnë një deziluzion me zhvillimin e marrëdhënieve borgjeze, me thellimin e kontradiktave dhe kështu, siç është e njohur historikisht, nis etapa e krizës së humanizmit, e cila gjen pasqyrimin e vet të shkëlqyer përmes ngjarjesh dhe mendimesh të fuqishme në veprën e Shekspirit. Idealet tronditen, thyhet besimi në virtytet me të cilat nisi Renesansa dhe kjo sjell turbullime të mëdha në mendjet dhe zemrat e njerëzve. Ky realitet më i përgjithshëm, tipik për një varg vendesh të zhvilluara feudo-borgjeze për atë periudhë (fillimi i shek. XVII) gjen shprehjen e vet konkrete dhe ngjyrat e theksuara angleze në tragjeditë e Shekspirit. Karakteri filozofik i teatrit anglez shekspirian, dialektika e mendimit dhe e ndjenjës, të dhëna përmes fjalës së zgjedhur me ndjenjë e mendim, përmes mënyrave shpesh metaforike, vargu dhe dialogu i fuqishëm vijnë si pasojë e një realiteti të shqetësuar, plot kontradikta, të kredhura në helmin e kohës, po edhe me realizmin dhe optimizmin që rridhte nga demokratizimi i artit (brenda mundësive të asaj periudhe). Realiteti anglez i dha mundësi Shekspirit të krijonte tablo të pashlyeshme nga kujtesa. Dhe është kuptimplotë fakti që Shekspiri mori mjaft subjekte nga historia italiane, daneze, greke etj. dhe, duke kapur një botë më të gjerë e interesa universale, dha njëkohësisht realitetin anglez, ato kontradikta të mprehta, atë gjakderdhje të egër që ndodhte në Anglinë e asaj kohe. Duke u nisur nga realiteti konkret dhe duke i marrë temat historike në funksion të realitetit ai la gjurmë shumë më të mëdha në historinë e letërsisë se ata që i përmbaheshin historisë me një pedantizëm shkollaresk dhe trembeshin se mos kapërceheshin caqet që ndanin historinë nga aktualiteti.

Nuk është qëllimi i këtij artikulli për të bërë inkursione të gjata në historinë e letërsisë. Si këta shembuj mund të sillëshin edhe shumë të tjerë për të ilustruar mendimin se gjithmonë arti i vërtetë ka qenë konkret, ka shprehur interesat e klasave të caktuara brenda realiteteve konkrete e kombëtarë. Është e njohur ideja e luftës së



të kundërtave, e dy kulturave brenda një kombi. Gjithmonë letërsia përparimtare është zhvilluar në luftë me korentet zyrtare reaksionare, konformiste apo dekadente.

Në periudhat historike kur ka dalë më i mprehtë problemi i ruajtjes së kombit, i krenarisë dhe dinjitetit të tij, i historisë dhe aktualitetit, për të hedhur dritë edhe në të ardhmen, poetë e shkrimtarë të mëdhenj kanë shkruar vepra patriotike me pasion e madhësi; kanë ngritur lart zemrat e bashkatdhetarëve dhe kanë lëshuar kushttrimin për të mbrojtur atdheun. Kështu, kjo temë e madhe dhe e pavdekshme ka kaluar në të gjitha kohërat dhe ka qenë burim frymëzimi për popujt. Autorë si Hygoi, Bajroni, Tolstoi e shumë të tjerë i kanë trajtuar gjerësisht këto tema.

Dihet se si në letërsinë tonë të rilindjes problemi i çlirimit të atdheut, i luftës kundër armikut të huaj e tradhtarëve ka qenë qendror në vepra të Naimit, Çajupit, Mjedës dhe autorëve të tjerë. Dashuria e thellë dhe e pasionuar, malli për atdheun në poezinë e Naimit ka bërë që poezia e tij të përshkohet nga kushttrimet dhe dridhjet më të holla shpirtërore për vendin e tij, për malet, lumenjtë, për lisat e gjatë e për çdo gjë që i jepte «emërin shqipëtar». Letërsia e ndier patriotike dhe më vonë sociale realiste me Fan Nolin, Migjenin, etj., ishte në kundërshtim të hapur me letërsinë e Fishtës, Koliqit dhe përfaqësuesve të tjerë të letërsisë klerikale apo antirealiste e formaliste, e cila shprehte interesat antipopullore dhe bën-te pjesë në letërsinë zyrtare të klasave dhe qarqeve kombëtare sunduese. Letërsia demokratike përparimtare, që përfaqësonte interesat e popullit, ishte letërsia e pjesës së vërtetë të kombit dhe hyn, me të drejtë të plotë, në trashëgiminë tonë kulturore e përbën vlerat e vërteta kombëtare të së kaluarës.

Me konsolidimin e kombit tonë në periudhën e pasçlirimit, në realitetin socialist, siç do të mundohemi të shohim në këtë artikull, tiparet kombëtare të letërsisë e artit bëhen më të theksuara dhe shtrihen më gjerë në kulturë. Letërsia shqiptare demokratike e përparimtare e

së kaluarës dhe letërsia e realizmit socialist e kanë forcën, bukurinë dhe origjinalitetin e tyre sepse mbështeten në truallin amtar. Me këtë fizionomi ato hyjnë e do të hyjnë edhe më shumë akoma në vlerat përparimtare të kulturës botërore.

\*

\* \*

Përpara se të shqyrtojmë disa probleme aktuale mbi karakterin kombëtar në letërsi, duam të paraqesim shkurtimisht se si mendimi përparimtar dhe mendimi revolucionar marksist-leninist gjithmonë e kanë vlerësuar këtë aspekt të krijimtarisë. Kështu p.sh. esteti përparimtar gjerman, me prirje realiste, Lesingu, e shtronte drejt rëndësinë e tipareve kombëtare të artit, kur thoshte: «Origjinaliteti nacional është një faktor i rëndësishëm për kulturën botërore». Gjithë shkrimtarët dhe estetët apo kritikët e përparuar kanë qenë kundër frymës amorge, të papërcaktuar në art, kanë luftuar në periudhat më të vona, të kapitalizmit e imperializmit, kozmopolitizmin, që shënon në thelb fundin e kulturës së vërtetë dhe që drejtohet kundër interesave të popujve. Me krijimtarinë dhe me mendimin e tyre autorë të mëdhenj të huaj e shqiptarë si Hygoi, Hajne, Shileri, Gorki, Majakovski, Brehti, tek ne Naimi, Noli, Migjeni, etj. kanë pasqyruar në veprën e tyre karakterin kombëtar, të cilin e kanë lidhur me interesat e popullit dhe me vlerat universale të kulturës. Sa të freskëta dhe aktuale tingëllojnë edhe sot vargjet e Naimit që evokojnë bukuritë e atdheut dhe çojnë peshë zemrat e shqiptarëve, duke i gatuar «me dëshirë e me zjarr», si edhe ato ku flet për dashurinë dhe vëllazërimin midis popujve të «Dëshirë e vërtetë e shqiptarëve» dhe gjetkë. Ndjenja kombëtare, si edhe qëndrimi demokratik e vëllazëror për marrëdhënie të mira midis popujve në luftë kundër pushtuesit të huaj, kanë qenë tipike për tërë rilindasit tanë.



Mendimi marksist-leninist i ka dhënë vendin e merituar problemit të kombit dhe të kulturës kombëtare në teorinë e përgjithshme të revolucionit dhe të luftës së klasave. Marksisi dhe Engelsi në fushën e kulturës, e kanë parë atë në funksion të çështjes së proletariatit dhe kanë luftuar me të madhe si nacionalizmin borgjez, që shpie në shkëputjen e problemit kombëtar nga ai i revolucionit proletar dhe në largimin prej idesë së bashkëpunimit të kulturave proletare, ashtu edhe përpjekjet e borgjezisë për të shuar luftërat e popujve për liri nacionale (në faza të caktuara të zhvillimit shoqëror) si edhe për të injoruar dallimet nacionale të kulturave. Ata kanë mbrojtur pikëpamjen se kombet me një kulturë përparimtare demokratike mund të jenë të aftë të kontribuojnë në çështjen e përgjithshme të revolucionit dhe kanë theksuar veçoritë e kulturave dhe të autorëve të kombeve të ndryshme. Është i njohur mendimi i Engelsit mbi karakteristikat e tragjedisë së Shekspirit, me veprim të gjerë në një sfond historik të madh, dhe mbi tendencën ideore në dramën e Shilerit. Drama e shoqërisë së ardhme komuniste, thoshte ai, do t'i shkrijë këto tipare në një të vetme për të dhënë dramën revolucionare me aksionin historik të masave dhe mendimin e qartë e të thelluar mbi gjendjen dhe perspektivën e shoqërisë. Marksisi dhe Engelsi kanë folur shumë herë për tiparet e letërsisë gjermane, sidomos të poezisë së saj, po edhe të dramës, për romanin francez e anglez, për tiparet e reja proletare që lindnin brenda kulturave kombëtare.

Lenini fliste për krenarinë kombëtare në kuptimin marksist të patriotizmit, i cili nuk mund të merret i veçantë nga shpirti revolucionar. Kurse Stalini, siç dihet, i kushtoi vëmendje të veçantë problemit të kombit dhe të kulturave kombëtare, duke i parë në prizmin marksist-leninist. Ai luftoi tendencat borgjeze e mikroborgjeze të «autonome» nacionale dhe dha përcaktimin marksist të kombit që nënkupton bashkësinë e gjuhës, të territorit, bashkësinë historike e ekonomike si edhe «formimin psikik që shfaqet në bashkësinë e kulturës». Stalini e quan-

te formimin psikik të një kombi si konstitucion shpirtëror të tij dhe karakterin socialist e kombëtar të kulturës i merrte në lidhjen e tyre dialektike, në raportin midis përmbajtjes dhe formës. Stalini e shikonte problemin e zhvillimit të kulturave kombëtare në evoluimin historik, në dialektikën e vet dhe jepte një zgjidhje shkencore të këtij problemi. «Në fazat e para të kapitalizmit, thoshte Stalini, akoma mund të flitet për «bashkësinë kulturore» të proletariatit dhe të borgjezisë. Por me zhvillimin e industrisë së madhe dhe me ashpërsimin e luftës së klasave «bashkësia» fillon të shkrihet. Nuk mund të flitet seriozisht për «bashkësi kulturore» të një kombi kur padronët dhe punëtorët e të njëjtit komb nuk kuptohen më me shoqi-shoqin (Vëll. 2, shqip, f. 326.). Siç kuptohet, Stalini, edhe kur e pranon bashkësinë, e vë në thonjëza, pra e merr si diçka relative dhe mendimi i tij këtu përkon me mendimin e Leninit mbi dy kulturat.

Partia dhe shoku Enver i kanë kushtuar gjithmonë një vëmendje të madhe problemit të karakterit kombëtar në kulturë e art. Tek në ky moment i rëndësishëm për zhvillimin e kulturës sonë socialiste është parë gjithmonë sipas pozicionit marksist-leninist në kushtet e sotme të luftës kundër superfuqive, imperializmit amerikan e socialimperializmit sovjetik si edhe çdo qëndrimi oportunist e reaksionar. Në këto rrethana të agresionit ideologjik dhe të synimeve kozmopolite e hegjemoniste të vendeve të mëdha për t'iu imponuar vendeve dhe kulturave, sidomos popujve të vegjël, problemi i ruajtjes së pavarësive dhe kulturave kombëtare merr një rëndësi të veçantë. Qëndrimi revolucionar, internacionalist proletar, qëndrimi i ndershëm prej komunisti është i lidhur ngushtë me patriotizmin, i cili mbështetet në traditat tona të rrënjosura thellë dhe merr një kuptim dhe shkëlqim të ri. Po s'deshe vendin tënd, popullin tënd, nuk mund të duash edhe popujt e tjerë. Këtë na kanë mësuar Partia dhe shoku Enver gjithmonë, përmes dokumentash dhe veprash revolucionare. Shoku Enver, duke zbatuar me besnikëri dhe në mënyrë krijuese parimet marksiste-leniniste mbi



karakterin kombëtar të kulturës, ka analizuar trashëgiminë tonë të kaluar, ka porositur të çmojmë çdo gjë të mirë që ka krijuar populli dhe të flakim tej atë që është e huaj dhe antipopullore. Ai ka çmuar lart Naimin dhe autorë të tjerë të së kaluarës dhe ka treguar thelbin antipopullor e shovinist të Fishtës etj., që bëjnë pjesë në kulturën regressive dhe reaksionare të së kaluarës. Shoku Enver ka folur për vlerat e mëdha të traditës së re të realizmit socialist, për ngjyrat popullore dhe kombëtare në krijimet e poetëve dhe shkrimtarëve tanë si D. Agolli, Sh. Musaraj, I. Kadare, Ll. Siliqi e shumë të tjerë. Ai ka treguar se kultura jonë e re është zhvilluar në luftë me kozmopolitizmin, me pikëpamjet mbi të ashtuquajturin ndërkombëtarizim të artit dhe se ajo mbështetet fort në truallin kombëtar, në realitetin konkret, në krijimtarinë e popullit. Fryma kombëtare dhe internacionalizmi proletar janë të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin dhe merren në raportet e tyre dialektike. «Kultura jonë socialiste, — tha shoku Enver në Kongresin VII të Partisë, — asnjëherë nuk është mbyllur në guaskën nacionale. Ajo ka përfitur nga arritjet më të mira të kulturës përparimtare botërore dhe, nga ana tjetër, duke qenë bartëse e idealeve të popullit tonë për liri, pavarësi e socializëm ka qenë dhe është e afërt edhe për popujt e tjerë» (Raporti në Kongresin VII të PPSH, f.178).

Duke e parë problemin shkurtimisht në plan historik, përmes mendimit të klasikëve dhe të Partisë sonë, kuptojmë rëndësinë e tij të madhe aktuale, mprehtësinë ideologjike dhe estetike të problemeve që kanë dalë e do të rrihen edhe këtej e tutje.

### **TIPARE TË KARAKTERIT KOMBËTAR NË LETËRSINË TONË**

Letërsia jonë e realizmit socialist ka karakter të theksuar kombëtar, gjë që duket si në temat themelore, në zgjidhjen e problemeve, ashtu edhe në ngjyrën dhe format e saj të papërsëritshme. Letërsia e sotme, e udhëhequr nga

mësimet e Partisë, mbështetet në traditat e kulturës shpirtërore të popullit tonë, në traditat e shëndosha kombëtare dhe krijon një eksperiencë cilësisht të re.

Letërsia përparimtare shqiptare e periudhës së paraçlirimit kishte, siç u përmend, si tematikë kryesore çlirimin e kombit nga pushtuesi i huaj, ëndrrën e lirisë dhe të përparimit. Kjo përbente edhe problematikën kryesore të veprave të Naimit, De Radës dhe autorëve të tjerë. Problemet e çlirimit kombëtar erdhën e u gërshetuan më vonë me probleme më të ndërlikuara politike e shoqërore në veprën e Çajupit, Fan Nolit, Mjedës e pastaj Migjenit dhe të tjerëve. Përmbajtja patriotike si edhe demokratike e revolucionare zinte vendin më të rëndësishëm në letërsinë tonë përparimtare të paraçlirimit dhe i jepte asaj tingëllimin kryesor. Problemet e kohës kur shkruhej kjo letërsi kanë qenë të lidhura me ato të historisë së Atdheut, të ngjarjeve dhe figurave kyçe të historisë kombëtare. Letërsia jonë romantike apo realiste, ka vulën kombëtare dhe u zhvillua e u forcua në luftë me letërsinë në thelb antikombëtare, anakronike apo formaliste që nuk mund të linte gjurmë të dukshme në historinë e kulturës sonë.

Karakteri kombëtar i letërsisë sonë vërehet në trajtimin e temave dhe problemeve të mëdha të historisë aktuale dhe të së kaluarës së kombit tonë, të luftës që ka bërë populli për liri dhe pavarësi, për të ruajtur ndërgjegjen kombëtare, si edhe në kohën e sotme, për zhvillimin e kombit socialist, për të mbrojtur pasuritë shpirtërore dhe materiale të popullit.

Vetë historia jonë, heroizmi dhe qëndresa, si përpara, ashtu edhe tani, kanë përcaktuar edhe temën e qëndresës, të krenarisë kombëtare dhe të militantizmit të vazhdueshëm, që, nën drejtimin e ideve të Partisë, sot është një militantizëm konsekuent revolucionar. Në shumë vepra të letërsisë sonë që nga «Epopeja e Ballit Kombëtar» e Sh. Musarajt, «Prishtina» e Ll. Siliqit, të «Nënë Shqipëri» e D. Agollit e shumë të tjera del me forcë të madhe kjo temë dhe ky mendim. Sidomos në gjininë e poezisë, të këngës, në skulpturën monumentale etj., spikasin motive të



tilla. Është trajtuar e po trajtohet (ndonëse duhet bërë më shumë) edhe tema e luftës kundër revizionizmit, duke e parë në prizmin e ruajtjes së pastërtisë marksiste-leniniste dhe të ekzistencës si komb, me historinë dhe të sotmen e vet. Kështu p.sh. kjo ide trajtohet në vepra të I. Kardareshë me përmasa të gjera si romani «Dimri i madh», në romane si «Zbulimi» i A. Kondos, etj.

Romani «Dimri i madh» mishëron historinë e re të kombit tonë në një periudhë kyçe, në momentin e demaskimit me rëndësi botërore që Partia jonë dhe shoku Enver u bënë Hrushovit dhe revizionistëve sovjetikë; ai pasqyron edhe atmosferën e kohës dhe (në variantin e tanishëm) sfondi shoqëror i qëndron më mirë përkrah sfondit politik dhe historik. Kjo, si edhe vepra të tjera të kohëve të fundit e të mëparshme, afirmojnë tiparet e larta të kombit tonë socialist.

Për të njohur historinë tonë kombëtare, luftën e popullit kundër pushtuesve, për formimin e ndërjegjes kombëtare, kanë lojtur dhe lozin rol edhe veprat letrare historike si p.sh. ato të viteve të fundit «Skënderbeu» i S.Godos, tregime me temë historike të Dh.Shuteriqit, «Zgjidimi» i S.Spases. Krahas temave të sotme, shkrimtarët tanë më shumë mund t'u drejtohen momenteve kyçe të historisë sonë, duke vënë në qendër popullin dhe duke treguar një lidhje të ngushtë të udhëheqësve përparimtarë me të. Kjo do të forconte edhe më tepër brendinë kombëtare të veprave tona dhe do t'i bënte jehonë problemeve të sotme.

Një tipar tjetër i rëndësishëm i karakterit kombëtar në letërsinë tonë, lidhur me të parin, është edhe pasqyrimi i unitetit moral-politik të popullit tonë në epokën e sotme, duke e shikuar këtë problem jo të shkëputur nga lufta e klasave, po në aspektin e unitetit kombëtar për të mbrojtur fitoret e arritura dhe për t'iu kundërvënë armiqtë të jashtëm dhe të brendshëm. Ky tipar del qartë në veprat tona e forcohet edhe më tepër duke kapur tema të mëdha me rëndësi historike dhe kombëtare.

Një aspekt i problemit është trajtimi i karaktereve kombëtare, tipave shqiptarë sidomos në gjinitë e mëdha

epike. Nuk mund të ketë art të vërtetë pa gdhendjen e karaktereve me tipare të qarta kombëtare. Këta gërshetojnë në vetvete historinë dhe të sotmen, traditën dhe aktualitetin. Shqiptari, që përfaqëson kombin dhe popullin, është trim dhe luftëtar, njeri me temperament, me ndjenja të fuqishme të dashurisë dhe të urrejtjes. Ai, nga përvoja që ka, nga kostitucioni i tij shpirtëror, e koncepton në mënyrën e tij jetën dhe vdekjen, shokun dhe mikun. Këto tipare kombëtare të njeriut tonë kanë ardhur duke u forcuar e kristalizuar, ato janë pasuruar te shqiptari i sotëm që lufton për socializmin si njeri patriot dhe internacionalist. Në veprat tona kanë dalë heronj me një fizionomi të qartë kombëtare si te «Lumi i vdekur» e J.Xoxës, «Para agimit» e Sh.Musarajt, «Kënetë» e F.Gjatës, «Komisari Memo» e D. Agollit, në poema si «Përse mendohen këto male» e I.Kadaresë, «Alarme të përgjakura» e F.Arapit, në drama si «Toka jonë» dhe «Përmbytja e madhe» të K. Jakovës, «Familja e peshkatarit» e S.Pitarkës, «Cuca e maleve» e L.Papës, «Zonja nga qyteti» e R.Pulahës, «Djem të mbarë» e F. Krajës, etj. Këto tipare janë dhënë jo vetëm përmes thelbit kryesor, por edhe në detaje të shumta, në mënyrën e të menduarit dhe të folurit, në lidhje me natyrën, me njerëzit, në konceptimin e së bukurës, në mënyrën optimiste, e njëkohësisht realiste të të parit të botës. Këto tipare dalin edhe në mënyrën si trajtohen konfliktet, si pasqyrohet lufta e klasave. Fytyra kombëtare duhet parë në tërësinë e tipareve themelore dhe të detajeve që i formojnë këto karaktere. Në këtë fushë është bërë e mund të bëhet edhe më tepër për të njohur më thellë njerëzit traditën dhe të sotmen.

Karakterit apo frymë kombëtare është një kategori që merret në zhvillim të vazhdueshëm. Kjo lidhet me konceptimin dialektik, duke e parë kombëtarin në prizmin historik, të një evoluimi të vazhdueshëm të saj. Letërsia jonë e realizmit socialist e forcon karakterin kombëtar në luftë me konceptimin reaksionar, borgjez-liberal dhe konservator. Ajo lufton me pikëpamjet liberale dhe kozmopolite që duan të zhdukin thelbin dhe ngjyrat kombëtare,



ashtu edhe me ato konservatore që e shohin kombëtarin në format e vjetra dhe të ngurtësuar. Prandaj, duke u mbështetur te tradita e shëndoshë, shkrimtarët tanë e shohin karakterin kombëtar si një kategori dialektike që zhvillohet krahas me jetën, me ndryshimin e kushteve social-klasore dhe me rrënjosjen më të thellë të botëkuptimit materialist në ndërgjegjen e njeriut punonjës. Për këtë arsye zbulimi i temave dhe problemeve thelbësore të periudhave të ndryshme historike është një moment me rëndësi për trajtimin e drejtë të tipareve artistike në frymë kombëtare.

Përveç këtyre aspekteve kryesore të përmbajtjes, karakteri kombëtar në letërsinë tonë, duket edhe në punë të gjuhës letrare dhe të mjeteve të tjera shprehëse, të cilat kanë ardhur duke u pasuruar dhe kanë marrë ngjyra më konkrete. Gjuha jonë, duke u zhvilluar më tej, ruan bazën e vet popullore, pasuron leksikun nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, duke flakur konservatorizmin e dikurshëm klerikal antikombëtar. Tradita, folklori dhe kultura e sotme socialiste shqiptare kanë lënë gjurmët e veta në zhvillimin e gjuhës letrare. Është e nevojshme të forcohet lufta për pasurimin e mëtejshëm gjuhësor të veprave letrare, për të luftuar strukturat e huaja, leksikun e huaj të panevojshëm dhe sidomos për të individualizuar më mirë personazhet përmes gjuhës dhe frazeologjisë popullore.

Për të mbrojtur parimet e realizmit socialist, për të forcuar frymën revolucionare, socialiste dhe kombëtare është dashur të bëhet një luftë e ashpër kundër ndikimeve të huaja, qëndrimeve liberale e konservatore. Në disa vepra letrare e artistike depërtuan, siç është thënë në Ple-numin IV, një frymë e huaj borgjeze e revizioniste që nuk kishte të bënte me rrugën që ndjek kombi ynë dhe, pra, kjo kishte edhe një karakter antikombëtar. Për nxitjen dhe kultivimin e këtyre shfaqjeve bënë një punë armiqësore Fadil Paçrami e Todi Lubonja, të cilët shfrytëzuan predispozitat, qëndrimet liberale apo mungesën e formimit të partishëm të disa elementeve krijuese. Këto shfaqje

u dukën në imitimet e huaja, në muzikë, poezi, arte figurative, dramë, skenografi, arkitekturë, etj. Me goditjen që u bëri Partia dhe tërë opinioni ynë artistik e shoqëror këtyre shfaqjeve, letërsia dhe artet shkuan edhe më përpara duke forcuar, midis të tjerave, edhe tabanin e tyre kombëtar. Ne kemi arritje tashmë të njohura në të gjitha gjinitë letrare e artistike, një afrim më të madh me problematikën e vërtetë kombëtare të shikuar në prizmin revolucionar, kemi një shfrytëzim më të madh krijues të gjuhës popullore, të intonacioneve e motiveve të kulturës së popullit, të folklorit. Në të gjitha artet, duke përfshirë edhe arkitekturën, një art ku e dobishmja me të bukurën kanë lidhje më të dukshme, po bëhen përpjekje për të shprehur më mirë karakterin kombëtar.

Por, kuptohet, se nuk mund të themi që u arrit gjithçka edhe në këtë aspekt, sepse ky është një problem i vazhdueshëm, i cili lidhet me luftën kundër synimeve të superfuqive për shkombëtarizimin e popujve dhe me mbrojtjen e pavarësisë, të kulturës kombëtare dhe të jetës sonë socialiste.

Në kohën e sotme, kur superfuqitë, imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik, mundohen t'u diktojnë popujve hegjemoninë e tyre lindi lloj-lloj teori kozmopolite apo, nga revizionistët sovjetikë, përdoret demagogji dhe, në të vërtetë, mbrohet ideja e «pansllavizmit»; në këto kushte bëhet edhe më e domosdoshme lufta për forcimin e karakterit kombëtar kundër kozmopolitizmit dhe deformimit të artit. Kjo luftë tek ne zhvillohet nga pozita të drejta marksiste-leniniste, ajo nënkupton, doemos, momentin e internacionalizmit dhe është kundër nacionalizmit borgjez. Shumë vepra tona, si në poezi e në gjini të tjera, që trajtojnë temën e internacionalizmit proletar dëshmojnë për zgjidhjen e drejtë të këtij problemi nga ana jonë. Në Plenumin IV thuhet, lidhur me situatën e tani-shme, kur duhet mbrojtur me forcë karakteri kombëtar i letërsisë dhe arteve: «Në këto kushte për ne bëhet edhe më imperative lufta për të ruajtur fizionominë kombëtare të artit, pasurinë kulturele të popullit.»



Në kushtet e intensifikimit të propagandës borgjezo-revizioniste kundër artit proletar, artit të realizmit socialist dhe parimeve të tij është e domosdoshme që shkrimtarët dhe artistët, kritikët dhe studiuesit, të shtojnë edhe më tepër vigjilencën duke forcuar artin socialist kombëtar dhe duke u prerë udhën ndikimeve të huaja. Është e nevojshme që të shtohen përpjekjet për t'u mbështetur më mirë në traditën kombëtare të vjetër dhe të re, për t'i dhënë një origjinalitet edhe më të madh artit tonë. Kjo duhet të ndihet si në brendi, edhe në formë, në përdorimin e mjeteve shprehëse, të gjuhës, tingujve, ngjyrave të vargut, atmosferës së dramave etj. Natyrisht, siç është sqaruar disa herë nga Partia jonë, mbështetja në tradita nuk do të thotë rutinë dhe anakronizëm, por konceptim dialektik i problemit. Të kapësh atë që është e re, novatore në kombin tonë, si në përmbajtje ashtu edhe në formë, është një detyrë e dorës së parë.

Me gjithë përparimin e ndjeshëm, veçanërisht në periudhën pas Plenumit IV, për forcimin e fizionomisë e frymës kombëtare në artin tonë, prapë vihen re mungesa e dobësi. Tashmë mund të themi se është kapërcyer edhe faza e një konceptimi idilik, anakronik dhe larg problemeve social-klasore, por prapë ka vepra që mbeten të cekëta në këtë anë dhe u mungon vështrimi i thelluar historik.

Sukseset kanë qenë të dukshme në të gjitha gjinitë, por nuk mund të thuhet se depërtohet me thellësinë e duhur në problemet që preokupojnë sot e kanë preokupuar edhe në të kaluarën kombin. Ka pak vepra me vështrime tërësore, të plota historike për fatin e kombit në periudha të caktuara. Psikologjia kombëtare spikat nëpër vepra të ndryshme, po më tepër duhet të bëhet për ta pasqyruar atë me tërë origjinalitetin e saj. Veprat tona kanë ngjyrat dhe aromat e papërsëritshme të vendit tonë, po edhe më shumë duhet të ndihen këto. Po të shohim gjini të veçanta si p.sh. poezia, veç problemeve të pasurimit të brendisë, del edhe problemi i përvetësimit më të mirë, sidomos nga të rinjtë, të vargut të poezisë përparimtare të kombit tonë

dhe të traditës sonë të re të realizmit socialist. Edhe figurat stilistike, në disa raste janë më tepër imitime letrare të huaja se sa fryt i një talenti origjinal kombëtar të mbështetur në truallin dhe në realitetin e kombit. Natyrisht, edhe forma demokratike, përparimtare të huaja janë marrë e mund të merren, po duke iu përshtatur kërkesave tona, natyrës së gjuhës dhe brendisë ideore. Kështu, aty-këtu janë vërejtur në të kaluarën imitime të teknikave të huaja në artet figurative, poezi, etj., të marra nga rryma moderniste. Imitime të tilla, ndonëse rrallë, ndihen edhe tani. Ka edhe poezi, me gjithë suksesin e arritur në këtë gjini, që nuk kanë fizionomi të përcaktuar kombëtare, mbeten amorfe.

Tani është kapërcyer, në përgjithësi, rreziku i hermetizmit në poezi, po ka ende figura të paqarta, me ndikime të huaja. Rreziku kryesor tani mbetet ndërtimi, disa herë i huaj, larg traditës kombëtare, i vargut poetik që ngjan si prozë dhe nuk krijon emocionet e poezisë së vërtetë kombëtare.

Në ndonjë gjini si drama apo edhe proza, ka raste kur nuk jepet sa duhet ngjyra kombëtare ose, nga ana tjetër, kur nuk pasqyrohet karakteri kombëtar në tërë zhvillimin socialist, me problemet aktuale që dalin sot, po hasen forma melodramatike të vjetëruara.

Ka disa krijime, ndonëse të pakta, që nuk përcaktohen në hapësirë dhe në kohë, nuk kanë sa duhet vulën kombëtare. Ndothë që mbeten kështu si tema «të përjetshme» dhe këto janë më tepër rezultate të leximeve dhe të një lidhjeje të pamjaftueshme me realitetin. Kjo vihet re sidomos në disa poezi të të rinjve.

Një nga problemet që shtroi Plenumi IV është mbështetja te folklori, lufta kundër teorive që krijojnë «gogolin» e paqenë të folklorit, në të vërtetë, për t'u hedhur në modernizëm dhe për t'u larguar nga tabani kombëtar. Gjatë kësaj periudhe janë shtuar përpjekjet për të përveçësuar më mirë folklorin tonë të shëndoshë. Kryesore në këtë moment është të nxitim krijimtarinë drejt frymëzimeve popullore të çmuara dhe jo rreziku i folklorizmit.



Por, krahas kësaj, gjithmonë duhet tërhequr vëmendja për një qëndrim marksist-leninist, klasor ndaj traditës, për të mos idealizuar asgjë të kaluar në emër gjoja të saj dhe për të mos huazuar në mënyrë mekanike forma të folklorit, të lindura në një realitet tjetër dhe sipas koncepteve të tjera filozofike.

Do të ishte e nevojshme të trajtoheshin disa aspekte teorike të karakterit kombëtar dhe të lidhjes së tij me nocione të tjera.

### *KARAKTERI KOMBËTAR DHE LUFTA E KLASAVE*

Qëndrimi klasor në fushën e krijimtarisë letrare e artistike është një problem themelor ideologjik dhe estetik që lidhet drejtpërdrejt me parimin e partishmërisë proletare. Mbrojtja e idealit pozitiv, pasqyrimi revolucionar i proceseve të luftës klasore në sfera të ndryshme të jetës si edhe pozicioni klasor proletar që duhet të qëndrojë në themel në çdo veprë të realizmit socialist, janë aspekte të rëndësishme të problemit të partishmërisë.

Krahas partishmërisë komuniste dhe në lidhje të ngushtë me të Kongresi VII i Partisë shtroi dhe problemin e karakterit kombëtar popullor të artit tonë, domosdoshmërinë e forcimit dhe thellimit të tij. «Në kushtet e sotme, thuhet në raportin e shokut Enver, kur imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë, të nisur nga qëllimet e tyre për sundimin e botës, për skllavërimin shpirtëror e politik të popujve, përhapin idetë e kozmopolitizmit, të të ashtuquajturit ndërkombëtarizim të artit dhe të kulturës, një rëndësi shumë të madhe merr lufta për të mbrojtur kulturën kombëtare të popujve».

Problemi i karakterit kombëtar në tërësi, veçanërisht në fushën e kulturës e të artit, nga filozofia dhe mendimi estetik marksist-leninist është parë kurdoherë në varësi të idesë së revolucionit dhe duke patur gjithmonë parasysh se lufta e klasave është forca kryesore lëvizëse e

shoqërisë. Me një qartësi të tillë pikëpamjesh, klasikët e marksizëm-leninizmit, Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini e kanë shtruar këtë problem.

Në kushtet e sotme të luftës së popujve kundër superfuqive, kundër imperializmit dhe socialimperializmit, në kushtet e agresionit ideologjik dhe kulturor të tyre, Partia jonë dhe shoku Enver kanë dhënë e po japin një kontribut të çmuar në fushën e mendimit marksist, duke e parë problemin e karakterit kombëtar në kulturë e art të lidhur ngushtë dhe të ndërvarur nga partishmëria dhe qëndrimi klasor. Forcimin e karakterit kombëtar e popullor, Partia jonë e sheh si një problem të luftës klasore në plan kombëtar e ndërkombëtar, si një problem që lidhet ngushtë me edukimin patriotik dhe revolucionar të masave nëpërmjet veprave letrare dhe artistike. Forcimi i mëtejshëm i karakterit kombëtar e popullor arrihet, siç na porosit Kongresi VII i Partisë, duke pasqyruar me syrin klasor realitetin tonë socialist dhe të kaluar, duke përvetësuar me një qëndrim krijues traditën dhe duke u mbështetur në krijimtarinë e shëndoshë popullore.

Raporti midis kuptimit të luftës klasore dhe të karakterit kombëtar është problem shumë i rëndësishëm ideo-estetik. Ky raport midis dy nocioneve, që lidhen me parime dhe tipare të artit në përgjithësi, është i ndërlikuar dhe kërkon një konceptim të qartë.

Lidhja midis këtyre kuptimeve qëndron këtu: për cilin komb flasim, se asnjëherë nuk flitet për kombin në përgjithësi, dhe interesat e cilave klasa mbrojmë brenda kombit. Në rastin tonë ne bëjmë fjalë për kombin socialist dhe për mbrojtjen e interesave të klasës punëtore dhe gjithë punonjësve të tjerë.

Karakterit klasor i artit është një ligjësi e përgjithshme e tij në shoqërinë me klasa, duke përfshirë edhe shoqërinë tonë, ku janë zhdukur klasat antagoniste. Është e njohur teza e Leninit mbi dy kulturat në shoqërinë borgjeze. «Në çdo kulturë kombëtare, thoshte Lenini, ekzistojnë, qoftë edhe të pazhvilluara, elemente të kulturës demokratike dhe socialiste, sepse në çdo komb ka një masë



punonjëse dhe të shfrytëzuar, kushtet e jetës të së cilës lindin në mënyrë të pashmangshme ideologjinë demokratike dhe socialiste. Por në çdo komb ekziston gjithashtu edhe kultura borgjeze (dhe në shumicën e kombeve ekziston edhe një kulturë ultrareaksionare dhe klerikale) — dhe jo vetëm në trajtën e «elementeve», por si kulturë sunduese».

Mendimi i Leninit mbi dy kulturat, mendim që mbështetet në qëndrimin klasor revolucionar ndaj problemit të kombit dhe të kulturës kombëtare, vërtetohet edhe sot në praktikën e jetës. Kultura sunduese është shprehje e ideologjisë së klasës në fuqi dhe zhvillimi i elementeve socialist, demokratik në kushtet e shoqërisë borgjeze varet nga shkalla e lëvizjes demokratike dhe revolucionare, nga rrethana konkrete të çdo vendi. Përballë dekadencës borgjeze, përballë rrymave të shumta të stërholluara formaliste ekzistojnë edhe vepra realiste, që shquhen për kritikën ndaj shoqërisë. Krahas këtyre kanë ekzistuar e zhvillohen edhe më shumë sot, sidomos në ato vende ku lëvizja marksiste-leniniste po merr hov, elementët socialistë revolucionarë në vepra të veçanta. Kjo tendencë përparimtare është në kundërshtim të hapët me artin borgjez si edhe me përfaqësuesit mikroborgjezë të dekadentizmit, me rrymat në dukje kontestuese, por që në të vërtetë kontestojnë vetëm elementë të formës, të traditës estetike dhe nuk prekin aspak thelbin e shoqërisë kapitaliste.

Revizionistët në estetikë, tërthorazi ose haptazi, kanë mohuar tezën e Leninit mbi dy kulturat, duke predikuar «rrjedhën e përbashkët» të një kulture të vetme, që qëndroka gjoja përmbi klasat, ose, në disa raste, duke i shndërruar ato në tri kultura. Dy estetë revizionistë sovjetikë, F.Njedoshivin dhe F.Kunjicin, thonë se, ndofta, janë pjekur vërtet kushtet për të dalë me mendimin se, në disa vende, nga më të zhvilluarat, ka tashmë, të thuash, tri kultura. Me këtë pohim estetët revizionistë e kanë fjalën për kulturën e shtresave të mesme, të intelektualizuar, për atë kulturë që, sipas tyre, qëndron midis borgjezisë e proletariatit dhe nuk mund të përfshihet në dy ten-

dencat kryesore të kulturës së kombit borgjez, tendenca që Lenini i shikonte si reflekse të antagonizmit themelor në shoqërinë kapitaliste midis borgjezisë dhe proletariatit. Nuancat e shkollave dhe të rrymave të ndryshme dekadente, formaliste nuk prekin thelbin e tyre të përbashkët që, si pikënisje filozofike, kanë idealizmin dhe, në praktikë, vihen në shërbim të borgjezisë. Qëndrime të tilla si edhe të tjera, ku flitet për kapërcimin gjoja të problemit të kulturës kombëtare dhe të zëvendësimit të tij me idenë e «ndërkombëtarizimit» të artit, kur quhet si i paqenë problemi i psikologjisë kombëtare etj., nuk janë tjetër veçse qëndrime revizioniste, që mundohen të përlligjin, në njërën anë, idenë e ekspansionit dhe të hegjemonizmit të socialimperializmit sovjetik, si edhe, në anën tjetër, atë të pajtimit të plotë me ideologjinë borgjeze, rrymat mikroborgjeze dhe oportuniste.

Ky problem lidhet me luftën e klasave në të kuptuarit e karakterit kombëtar në plan ndërkombëtar. Lufta ideologjike dhe estetike në konceptimin e këtij problemi është shfaqje e drejtpërdrejtë e luftës së klasave në kushtet aktuale. Partia porosit që të mbahet gjithmonë parasysh ky moment, të luftohet presioni borgjezo-revizionist dhe ndikimet e huaja në këtë fushë.

Në kushtet e vendit tonë nuk mund të flitet kurrsesi për dy kultura, por për kulturën socialiste, që vjen duke u forcuar e konsoliduar. Po do të bënim një interpretim jo marksist dhe kundër realitetit po të mos vërejm luftën klasore që bëhet në kulturë e në art brenda kombit tonë, si pasojë e presionit të huaj dhe e mbeturinave të botës së vjetër. Në krijimtarinë artistike dhe në kulturën tonë të sotme ne ndeshemi me elemente të veçantë të ideologjisë dhe kulturës së huaj borgjezo-revizioniste, të kulturës anakronike, konservatore të së kaluarës. Këto nuk mund të përbëjnë një drejtim më vete, po janë shfaqur si ndikime në vepra dhe në teorizime të veçanta. Pra, kultura jonë kombëtare sunduese është kultura socialiste. Por, kuptohet, se termat kombëtare dhe socialiste, sado të afërta që janë në realitetin tonë, nuk mund të me-



rren si identike. Elementi klasor revolucionar është esen-  
cial për kulturën tonë. Në përmbajtjen dhe në formën e  
artit hyn organikisht edhe aspekti kombëtar, që ka të bë-  
jë me rrugën historike të vendit tonë, me veçanësinë e  
revolucionit tek ne, me temat dhe problemet që sugjeron  
realiteti ynë dhe me formën adekuate që kërkon për-  
mbajtja.

Në një varg veprash të rëndësishme të letërsisë dhe  
arteve tona, del qartë lidhja e karakterit klasor me atë  
kombëtar si në frymën e përgjithshme ashtu edhe në  
ngjyrat e veçanta. Kështu, p.sh. po të marrim vetëm pak  
raste, sidomos nga periudha e fundit e krijimtarisë, ndër  
shembujt e shumtë mund të përmendnim në letërsi poe-  
mën «Nënë Shqipëri» të D.Agollit, e cila bashkon në vet-  
vete idenë e patriotizmit dhe të krenarisë kombëtare me  
atë të zhvillimit të shoqërisë sonë socialiste, përmes luftës  
klasore. Brendia klasore dhe karakteri kombëtar janë vë-  
në në themel të kësaj vepre.

Nga artet figurative për këtë aspekt bie në sy vepra  
e njohur «Monumenti i Pavarësisë» në Vlorë, i skulpto-  
rëve K.Rama, M.Dhrami, Sh.Hadëri. Kjo vepër ngre pro-  
blemin e çlirimit kombëtar, të fiksuar në një moment ma-  
dhështor, duke nxjerrë në dukje demokratizmin e lëviz-  
jes patriotike, pjesëmarrjen e masave popullore në të, ba-  
shkë me figura udhëheqësish, njerëz të pushkës e të pe-  
nës.

Po kështu edhe në muzikë, midis veprave të ndrysh-  
me, që e shprehin këtë gërshetim mund t'i drejtohem ba-  
letit «Cuca e maleve» me muzikë të N. Zoraqit. Kjo vepër  
shpreh qartë motive nacionale të muzikës sonë popullore,  
përmes rikrijimit artistik, si me çastet dramatike, të cilat  
pasqyrojnë ndeshjen e mendimeve dhe ndjenjave të kun-  
dërta, ashtu edhe me kalimet lirike, që krijojnë një atmo-  
sferë shqiptare.

Forcimi i karakterit kombëtar popullor të artit tonë  
lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e luftës së klasave, me  
rënjosjen e ideologjisë së klasës punëtore, të partishmë-  
risë komuniste. Duke e kuptuar thellë dhe duke zbatuar

drejt në kulturë e art luftën e klasave u pritet rruga elementëve antisocialistë. Mbrojtja e interesave të kombit në kushtet e domosdoshmërisë historike të ekzistencës së tij, nuk është diçka abstrakte, por lidhet me mbrojtjen e interesave të popullit, të përparimit dhe të lumturisë së tij. Uniteti moralo-politik i kombit tonë përcaktohet nga aleanca e klasës punëtore, me fshatarësinë punonjëse, të udhëhequr nga klasa punëtore, me Partinë në krye. Në kohën e sotme, për vendin tonë, elementët antisocialistë janë edhe antikombëtarë, sepse socializmi është një arritje e madhe e kombit që siguron, nën udhëheqjen e sigurt marksiste-leniniste të Partisë, zhvillimin dhe lulëzimin e tij. Dihet se kurdoherë fizionomia e kombit formohet nga një klasë e caktuar, që i jep tonin jetës dhe kjo klasë tek ne është klasa punëtore. Prandaj pasqyrimi i kësaj klase, i fshatarësisë punonjëse dhe inteligjencies popullore, i së sotmes dhe i historisë së kombit në luftën e tij për liri, pavarësi e socializëm, sipas ideologjisë së klasës punëtore, ndihmon edhe në forcimin e karakterit kombëtar të letërsisë e arteve tona. Natyrisht, veçoritë dhe psikologjia kombëtare janë diçka më e gjerë se ato të një klase të caktuar. Prandaj në përshkrimin e psikologjisë së përfaqësuesve të klasave të caktuara do të mbahet parasysh ana klasore dhe kombëtare që ka të bëjë me traditën dhe të sotmen, me ato tipare dhe veçori të papërsëritshme, që lidhen me anën e shëndoshë të kombit, e cila përbën, tek e fundit, historinë e vërtetë të tij.

Për mbrojtjen dhe forcimin e karakterit të kulturës dhe artit tonë socialist, është dashur të bëhet një luftë e ashpër klasore me elementët antiparti dhe antikombëtarë Fadil Paçrami, Todi Lubonja dhe pasuesit e tyre, të cilët kërkonin ta fusnin krijimtarinë tonë të shëndoshë në rrugën e imitimeve të huaja, të modeleve të artit borgjezo-revizionist. Plenumi IV i KQ të Partisë u dha një goditje të fortë këtyre pikëpamjeve dhe orientoi shkrimtarët e artistët për t'u thelluar edhe më tej në pozitën e partishmërisë, të karakterit kombëtar e popullor. Letërsia dhe artet u forcuan në përmbajtjen e tyre ideestetike, u



shtuan krijimet dhe u rrit niveli. Arti ynë kombëtar socialist është në fazën e një zhvillimi të mëtejshëm.

Tiparet kombëtare e socialiste kanë gjetur e po gjejnë një shkrirje më organike në veprat tona letrare e artistike. Shkrimtarët dhe artistët tanë mbështeten në traditën e shëndoshë kombëtare, të vjetër e të re, si edhe në traditën përparimtare e revolucionare botërore. Kjo traditë përvetësohet në mënyrë krijuese.

Nga arti i kombeve të tjerë ne marrim atë që na ndihmon për të njohur historinë dhe luftërat e popujve. Vlera shoqërore e tij lidhet edhe me frymën dhe shprehjen kombëtare. Sa më shumë originalitet të ketë një art, kur ky është përparimtar, aq më tepër interes zgjon. Arti i vendeve të ndryshme është i lidhur përmes interesave klasore të përbashkëta, përmes botëkuptimit përparimtar e revolucionar që mbron. Kjo bashkësi interesash nuk shuan kursesi veçoritë kombëtare, atë origjinalitet dhe freski që sjell çdo komb në thesarin e kulturës botërore.

Kongresi VII i Partisë shtron detyrën që të luftohet për forcimin e mëtejshëm të karakterit kombëtar në tërë kulturën e artit tonë. Me gjithë përparimet e arritura në këtë fushë, mbetet për të bërë që të sqarohen më mirë disa probleme teorike e praktike, sidomos në koreografi, në muzikë, arkitekturë. Edhe në fusha të tilla të krijimtarisë si letërsia mungojnë studimet për të përcaktuar gjini të veçanta, p.sh. si romani etj., nga pikëpamja e vlerave të karakterit dhe veçorive kombëtare. Janë luftuar shartimet e dëmshme në koreografi, është kritikuar kuptimi eklektik i lidhjes së aspektit kombëtar e krahnor dhe janë arritur rezultate më të mira. Imitimet e huaja, ndonëse tani më të rralla, interpretimi metafizik i shfrytëzimit të vlerave kombëtare etj. janë shprehje e luftës klasore në art dhe ky problem duhet të jetë gjithmonë në qendër të vëmendjes.

Në disa vepna letrare e artistike me tema historike ka dalë problemi për ta parë më mirë karakterin kombëtar në thelbin e vet, asnjëherë jashtë interesave klasore të kombit, po duke gjetur kontradiktën themelore të ko-

hës dhe duke i lidhur përmbajtjen me kuptimin e sotëm klasor të partishëm.

Problemet teorike dhe praktike, që lidhen me karakterin kombëtar popullor, janë rrahur më shumë kohët e fundit, por ndihet nevoja për studime më të thelluara shkencore. Janë luftuar teorizimet që mundoheshin të përligjinin, drejtpërdrejt apo, tërthorazi, modernizimin dhe elementët antikombëtarë, të cilët serviroshin në forma gjoja të luftës kundër provincializmit për të «zgjeruar» kufijtë e artit, për «modernizimin» e tij. Këto nuk ishin tjetër veçse tendenca kozmopolite, që u goditën ashpër duke zbuluar thelbin e tyre të vërtetë.

Mendimi ynë teorik dhe kritik edhe më parë, po si domos pas Plenumit IV e këtej, është munduar të shpjegojë kuptimin e saktë të karakterit kombëtar, lidhjen e tij me partishmërinë dhe karakterin socialist të artit. Problemi nuk ka qenë aq i lehtë e mbetet ende për të bërë. Por mund të themi se janë arritur disa përfundime dhe kjo ka qenë e mundur nga vetë zhvillimi i artit tonë dhe, veçanërisht, nga mësimet e Partisë, që na kanë ndihmuar për ta kuptuar drejt edhe problemin e karakterit kombëtar. Në këtë vështrim është luftuar pasaktësia dhe eklektizmi i termave, që shpreh edhe një konfuzion në konceptimin e gjërave, është saktësuar më mirë të kuptuarit e karakterit kombëtar.

## PËRMBAJTJE DHE FORMË

Karakterin kombëtar është një tipar i rëndësishëm dallues i artit tonë të realizmit socialist. Elementët kombëtarë janë një e vërtetë objektive, që formohen e evoluojnë historikisht dhe shprehen në kulturën shpirtërore të një vendi. Arti është formë e kësaj kulture që i shfaq më qartë elementet nacionalë.

Si shtrohet teorikisht problemi i përmbajtjes dhe formës në raport me karakterin kombëtar? Karakterin kombëtar, kuptohet, është një tipar i domosdoshëm i kultu-



rës dhe artit të një populli, të një kombi që ka historinë e tij dhe frymën e fizionominë e formuar në shekuj. Nëse një art nuk ka fytyrën e tij kombëtare, nuk mund të shprehë interesat e popullit të vet dhe të zërë vend në kulturën botërore. Kuptohet pra se si i tillë ky problem i përket edhe përmbajtjes edhe formës.

Në diskutimin që u zhvillua tek ne, sidomos pas Plenumit IV, ku shtrohej me forcë edhe problemi i mbështetjes në truallin amtar, i luftës kundër qëndrimeve anti-kombëtare, janë rrahur pikëpamjet sidomos mbi dy probleme kryesore: 1) përse e quajmë karakterin kombëtar si çështje të përmbajtjes dhe të formës e jo vetëm të formës dhe cilat kanë qenë qëndrimet ndaj këtij aspekti; 2) karakteri kombëtar nuk është diçka inerte, e pandryshueshme, por një tipar që vjen e zhvillohet, sipas rrethanave historiko-shoqërore.

Karakterin kombëtar, së pari, është trajtuar si çështje e përmbajtjes dhe e formës, sepse veçoritë kombëtare, tiparet historike, shoqërore, psikologjike, qëndrimet ndaj ngjarjeve të mëdha të jetës, mënyra e perceptimit të sendeve dhe dukurive dhe pasqyrimi apo shprehja e tyre në art nuk mund të jetë thjesht çështje forme, po ka të bëjë drejtpërdrejt edhe me përmbajtjen. Pasqyrimi i ndërgjegjes së një kombi nuk mund të jetë vetëm punë e formës artistike.

Si e kuptojmë përmbajtjen dhe formën në karakterin kombëtar dhe si shprehen këto aspekte konkretisht?

Momenti i përmbajtjes, që ka të bëjë me idetë dhe me materialin jetësor, me temën dhe problematikën, në letërsinë dhe artin tonë përfshin si aspektin socialist, ashtu edhe atë kombëtar. Idetë socialiste, revolucionare që janë ide marksiste-leniniste, lidhen ngushtë me specifikën kombëtare, me një problematikë, tematikë dhe me raporte, që janë tipike për një vend si yni. Kushtet historike tradita dhe e sotmja, format ekonomike-sociale kanë përcaktuar edhe një psikikë të dhënë, disa veçori që kanë zënë një taban dhe vijë e përpunohen, evoluojnë. Ta pasqyrosh këtë problematikë konkrete, të gjesh temat ti-

prike për kohën dhe zgjidhjet origjinale që përfton jeta jonë, kjo do të thotë të hysh në brendinë kombëtare të artit, duke e marrë atë në lidhje të ngushtë me idetë socialiste, të cilat (meqë është fjala për qëndrim botëkuptimor) janë përcaktuese në unitetin e karakterit socialist dhe kombëtar. Kur flasim për momentin kombëtar të përmbajtjes kurrsesi nuk e përthyejmë konceptimin tërësor të idealit socialist dhe të frymës revolucionare. Këtu është puna për një vështrim të problemit në kompleksitetin e vet.

Do të ishte e gabuar që, duke mos dashur të biem në kuptimin e njëanshëm të karakterit kombëtar vetëm si formë, të mohonim ose të minimizonim aspektin e formës. Nëse me përmbajtje kombëtare kuptojmë pasqyrimin e ndërgegjes së një kombi, veçoritë e temave, të problematikës, të rrugëve konkrete, historike të zgjidhjes së konfliktëve dhe të psikikës së një populli; me formë kuptojmë pasqyrimin konkret të këtyre elementeve përmes gjuhës, ngjyrave, hollësive etnografike, zakoneve dhe shumë anëve të tjera që mishërojnë veprën e artit. Në disa raste ndarja midis përmbajtjes dhe formës është vështirë të bëhet pa rënë në skolasticizëm, po përsëri nocionet kanë kuptimin dhe caqet e tyre.

Kështu, pra, edhe përmbajtje, edhe formë. Në të dy këta komponentë qëndron forca e karakterit kombëtar te vepra e Naimit, te «Bagëti e bujqësi» p.sh., ku malli për vendlindjen kthehet në një këngë sa madhështore, aq edhe të thjeshtë e të ngrohtë. Shumë vargje janë shkruar për atdheun në letërsinë romantike botërore, po veçoria historike e vendit tonë, lufta e gjatë kundër pushtuesve, malli i dhembshëruar i patriotëve është shprehur te Naimi me një origjinalitet të veçantë, me malet e fushat, me blegërimën e qingjave dhe me pasionin e madh për t'i kënduar bukurisë së tokës amtare. Rrethanat historike përcaktuan edhe veçorinë e romantizmit shqiptar që shquhet, në radhë të parë, për frymën e tij patriotike. Problemin e kontradiktës së individit me shoqërinë ai nuk e ngre në atë kohë në planin social, siç ndodhte me drejtimin roman-



tik. Por poezia e Naimit nuk do të mbetëj e tillë, e paharruar dhe e gdhendur në zemra, nëse krahas idealit nuk do të kishte gjetur epitelin, detajin, kadencën tipike për poezinë shqiptare, të ngritur në art, krahasimet e natyrshme dhe të bukura që buronin nga psikologjia e shqiptarit.

Letërsia jonë e realizmit socialist e ka shpërë përpara traditën tonë të shëndoshë dhe e ka pasuruar në mënyrë të pakrahasueshme me të kaluarën tematikën, problematikën dhe format e shprehjes.

Në çdo problem apo temë të madhe që ka kapur letërsia jonë si Lufta Nacionalçlirimtare, Reforma Agrare, industrializimi i vendit, uniteti moralo-politik i popullit, qëndresa në rrethim, lufta kundër armiqve, në tema të dashurisë, të familjes etj. Ikudo kanë spikatur, natyrisht, veçoritë konkrete-historike të realitetit tonë. Kështu p.sh. gjejmë të pasqyruar kalimin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në një revolucion popullor, veçorinë e luftës klasore për rindërtimin e vendit dhe për të zbatuar Reformën Agrare, origjinalitetin e rrugëve, të shndërrimeve socialiste në një vend si yni me mbeturina sociale të formacioneve të ndryshme, luftën e sotme për formimin e njeriut të ri, kundër imperialistëve e revizionistëve etj.

Po të hedhim një sy në prozën tonë me temë nga Lufta p.sh. si të «Para agimit» e Sh. Musarajt deri të «Njeriu me top» e D. Agollit, do të vëmë re veçoritë kombëtare të gërshetimit të patriotizmit me luftën klasore dhe me problemet etiko-morale. Qytetari i varfër, apo fshatari i mençur, intelektual, borgjezi, liberali, tradhtari në romanin e Sh. Musarajt kanë vulën shqiptare, kanë dalë nga ky realitet dhe nuk ngatërrohen me të tjerë (kjo nuk do të thotë se romanet botërorë përparimtarë për luftën nuk kanë pikat e tyre të afrimit: ideja e luftës kundër fashizmit është e përbashkët). Po kështu edhe «Njeriu me top» harmonizon problemet e çlirimit kombëtar me ato moralo-psikologjike, duke u nisur nga realiteti i një pjese të fshatarësisë sonë. Problematika është origjinale, edhe lidhja me armën është tipike për shqiptarin, i detyruar në shekuj t'i bëjë ballë armikut. Pleksja e problemeve dhe

zgjidhja e tyre kanë vullë kombëtare. Gjuha, koloriti, dialogu shquajnë në shumë vepra tonat.

Gjallëria e naracionit, dialogu i shkathët dhe me frazeologji të pasur popullore, poezia herë-herë e vrullshme dhe me theks romantik, episiteti i subjektit, dramaticiteti dhe kontrastet e dukshme, mund të thoshnim se janë tipike për letërsinë tonë, sidomos për gjinitë e mëdha. Kjo ka arsye historike dhe psikologjike e lidhet me përmbajtjen dhe formën.

Së dyti, karakteri kombëtar nuk mund të shihet si diçka inerte, që mund të përdoret nga të gjithë në kohë të ndryshme. Po të mos kuptohet drejt ky problem, dashur pa dashur, kalohet edhe në gabimin se karakteri kombëtar nuk vjen duke u zhvilluar, por pasqyron diçka të dhënë një herë e përgjithmonë. Ky aspekt i problemit i përket historisë e sociologjisë e po kështu edhe artit. Ndër diskutime është thënë se karakteri kombëtar nuk duhet të konfondohet me atë që është e vjetër dhe e prapambetur, me atë çka lidhet me statet e kapërcyera të zhvillimit shoqëror. Shumë elementë të shëndoshë nga tradita mbeten dhe ka një vazhdimësi historike që formon karakterin e kombit. Por ka zakone e tipare që ua lënë vendin të tjerave ose marrin një trajtë të re, duke iu përshtatur kushteve të sotme politiko-shoqërore. Kështu besa, besnikëria është një tipar i lartë popullor po tani nuk mund të shprehet ky si një kanun i ngurtësuar feudal, që kishte lindur në kushte të tjera dhe i shërbente atij formacioni shoqëror. Ky tipar tani lidhet me besnikërinë ndaj parimeve, me bindjet komuniste, me zhvillimin e personalitetit të njeriut. Këto veti morale i ka pasqyruar letërsia jonë, duke u ndeshur edhe me rutinën dhe me konceptimin anakronik apo idilik të zakoneve, dokeve, etj., larg kushtëzimit social-historik.

Temat e realitetit socialist sot lidhen me veçoritë historike të luftës dhe të punës së popullit tonë nën udhëheqjen e Partisë. Konsekuenca revolucionare, lidhja e individit me kolektivitetin, largimi nga psikologjia e pronës private dhe përqaqimi i normave të reja të jetës janë tipare



socialiste që i takojnë historisë aktuale të kombit tonë. Vetvetiu edhe zakonet evoluojnë. Në dasma, në festa popullore, në gëzime e hidhërime, tani njerëzit qëndrojnë edhe më shumë se përpara pranë njëri-tjetrit dhe kudo ka një solidaritet të madh. Karakteri shqiptar, duke ruajtur vërtetë më të mira tradicionale, është zhvilluar e fisnikëruar edhe më shumë. Edhe artin njeriu ynë e do të pastër, të qartë, të kuptueshëm, me përmbajtje të thellë e formë të bukur.

Jeta shqiptare nuk mund të jepet në art me anë të ekzotikës, por me një gërshetim dialektik të shfaqjeve reale të së sotmes dhe të lidhjes organike të tyre me traditën.

\*  
\*   \*  
\*

Letërsia dhe artet tona ecin në rrugën e forcimit të karakterit kombëtar duke u nisur nga detyra e pasqyrimin të realitetit aktual dhe historik, duke u mbështetur në traditën më të mirë dhe në krijimtarinë popullore. Gjithmonë e më shumë ato pasurojnë e kristalizojnë përmbajtjen dhe shtojnë ngjyrat, detajet, format e papërsëritshme që çdo art përparimtar sjell me vete sa më shumë të zhvillohet. Qëndrimi i partishëm marksist-leninist në zgjidhjen e problemeve, të cilat lidhen me përvetësimin më të mirë të veçorive kombëtare shpie në arritje të reja dhe në interpretimin e drejtë e të thelluar të dukurive që praktika krijuese nxjerr gjithmonë para letërsisë e arteve. Kuptimi i thellë i marksizëm-leninizmit dhe i shpirtit të popullit e të kombit, i problemeve me të cilat jeton populli në lidhje me botën që e rrethon, si edhe forma origjinale, e papërsëritshme e shprehjes së brendisë, këto sigurojnë krijimin e veprave revolucionare, socialiste, me tipare të dallueshme kombëtare.

1977.

## **GJALLËRIA E PASHTERSHME E METODES SË REALIZIMIT SOCIALIST<sup>1)</sup>**

Arti i sotëm shqiptar shpreh gjendjen e shoqërisë socialiste shqiptare, arritjet shpirtërore dhe kulturore. Ai mbështetet në realitetin konkret dhe në idealin shoqëror-estetik, marksist-leninist. Ky është arti i një shoqërie në rritje, në zhvillim të vazhdueshëm. Gjithmonë e më shumë arti shqiptar i sotëm gjen përhapje në masa, bëhet një ushqim shpirtëror për to. Në jetën kulturore të vendit letërsia, artet figurative, muzika, kinemaja, dhe teatri lozin një rol shumë të madh; ato ndihmojnë për edukimin e njeriut të ri, i japin kënaqësi estetike dhe i zgjerojnë horizontin e jetës.

### *TRADITAT DHE LINDJA E ARTIT SHQIPTAR*

Baza filozofike e artit të sotëm shqiptar është marksizëm-leninizmi, mësimet e klasikëve të marksizmit, parimet estetike marksiste-leniniste, mësimet e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të shokut Enver Hoxha që zbatojnë teorinë marksiste në kushtet e sotme kombëtare dhe ndër-kombëtare. Këto e udhëheqin artin në rrugën e drejtë të revolucionit. Burimet ideologjike janë të lidhura ngushtë me realitetin ekonomik dhe shoqëror, me njeriun e sotëm që ndërton socializmin, me zhvillimin e luftës së

---

1) Ky artikull është botuar në revistën «Shqipëria sot».



klasave në gjendjen e tanishme dhe me perspektivat e së ardhmes. Letërsia shqiptare e sotme, e cila i ka fillimet e veta që me Luftën Nacionalçlirimtare, ka si metodë të sajën krijuese realizmin socialist. Parimet e përqëndruara në këtë metodë janë mbështetur në traditën revolucionare artistike botërore dhe kanë lindur në truallin kombëtar. Arti i ri shqiptar, i cili filloi me këngë të kushtrimit, me himne luftarake, lindi në tokën shqiptare, u mbështet në faktet revolucionare, në tiparet e njeriut të ri dhe u zhvillua më tej me gjini të mëdha, me zëra të shumtë krijues, me vepra të shumëllojta, të cilat e pasqyrojnë jetën në plane të gjera dhe komplekse.

Cila është tradita kombëtare e artit shqiptar? Ai ka pasur një traditë të shquar, sidomos letrare, veçanërisht në lëmin e poezisë. Ndjenjat romantike liridashëse, ekzaltimi i bukurisë së vendit, i njeriut, urrejtja ndaj pushtuesit shpinin te poezia që i këndoi me aq pasion lirisë, natyrës, atdheut dhe dashurisë. Romantizmi i rilindjes kombëtare lindi në truallin shqiptar; ai ka pika afrimi me romantizmin evropian, sidomos me ato vepra që i këndonin patriotizmit dhe që e shihnin problemin e çlirimit kombëtar si një domosdoshmëri historike dhe si një kërkesë të brendshme të individit, të njeriut të popullit, të etur për liri.

Në llojet e tjera të arteve ka pasur gjithashtu tradita, ndonëse jo në përpjesëtimet e letërsisë, sidomos në artet figurative, në arkitekturë, po edhe në muzikë. Në këto arte ka spikatur shpirti shqiptar nëpër shekuj, pikëllimi i njeriut të robëruar, por edhe optimizmi i pashuar popullor, ka dalë në shesh ndjenja e shijes dhe e elegancës së njeriut të thjeshtë, puna e madhe dhe plot mundim e tij në shoqërinë me klasa antagonistë.

Nga kjo traditë përparimtare shqiptare, nga vepra e poetëve të mëdhenj si Naim Frashëri, De Rada, Çajupi, Mjeda, Fan Noli, Migjeni etj., e piktorëve si Onufri, Mio, etj., ka përfituar arti i ri shqiptar i realizmit socialist. Një burim i rëndësishëm ka qenë dhe mbetet

folklori me poezinë, muzikën dhe vallet popullore të pavdekshme.

Si burim letrar dhe artistik, përveç traditës kombëtare, ka shërbyer edhe tradita botërore e artit përparimtar dhe revolucionar. Në Shqipëri, në periudhën e pasçlirimit, janë përkthyer e botuar shumë kryevepra dhe vepra të njohura të shkrimtarëve të huaj, që nga Homeri e deri tek autorë të ditëve tona. Ne kemi në shqip vepra të Servantesit e Shekspirit, Hygoit e Balzakut, Gëtes e Shilerit, Tolstoit e Gorkit, Shout e Ibsenit, Lu Sunit dhe shumë e shumë autorë të tjerë.

Realizmi socialist është vazhdues i traditës përparimtare e, në radhë të parë, i traditës realiste. Ndaj trashëgimisë të së kaluarës mbahet një qëndrim kritik: krijimtaria vlerësohet në lidhje me kushtet historike dhe botëkuptimin e shkrimtarit.

Duke çmuar autorë të realizmit socialist si Gorki dhe Majakovski, mendimi i sotëm historiko-letrar shqiptar i kërkon premisat e kësaj metode krijuese edhe më përpara, te poezia e Komunës së Parisit, te poetë si Hajne, të cilin e patën vlerësuar lart, për thekset revolucionare të disa poezive, Marksi dhe Engelsi.

Me gjithë tradhtinë revizioniste, që shprehet me largimin e plotë nga pozitat e realizmit socialist në Bashkimin Sovjetik e gjetkë, me gjithë luftën që i bëhet nga estetët borgjezë dhe revizionistë kësaj metode, parimet e saj janë të pavdekshme dhe vlejné si një përgjithësim i praktikës së artit revolucionar dhe i mendimit krijues marksist-leninist në këtë fushë. Arti revolucionar ka vlerat e veta në shumë vende të botës dhe përbën një realitet të pakontestueshëm historik.

### *DISA NGA TIPARET KRYESORE DHE ARRITJET E ARTIT SOCIALIST SHQIPTAR*

Duke u mbështetur në filozofinë marksiste-leniniste, në konceptin materialist, arti shqiptar i sotëm, që udhëhiqet ideologjikisht nga Partia dhe shoku Enver Hoxha,



niset nga parimi bazë se realiteti është primar, atje gjenden temat dhe frymëzimi dhe se bota e artistit nuk është vetëm ndërgjegja e tij subjektive. Artistët shqiptarë e luftojnë subjektivizmin, në çdo pamje që të paraqitet. Nga ana tjetër, ata nuk janë as për një objektivizëm të ftohtë që do të shpinte në natyralizëm apo në një tablo indiferente të jetës. Idetë, mendimi transformues, zgjidhja që u jep artisti problemeve të jetës, lozin rol të madh në veprat e realizmit socialist. Kështu që parimi i vërtetësisë së jetës është i lidhur ngushtë me momentin botëkuptimor dhe me atë parim që ne e quajmë partishmëri komuniste.

Letërsia përshkruan anët epike, lirike dhe dramatike të jetës. E vërteta është se vetë ngjarjet dhe rrethanat e jetës sonë, lufta kundër bllokadës imperialisto-revizioniste, heroika e jetës kanë shpурë më tepër drejt epizmit dhe prandaj kanë pasur një zhvillim të dukshëm, gjini si romani, filmi, piktura dhe skulptura monumentale etj. Por kjo nuk do të thotë se s'kanë pasur zhvillimin e tyre edhe lirika dhe dramatika e jetës. Këto aspekte janë gërshetuar me njëra-tjetrën. Bota e brendshme e poetit është një pjesë e realitetit të sotëm shqiptar dhe ai nuk e ndan veten nga problemet e mëdha të kombit.

Në dokumentet kryesore të Partisë, në fjalimet e shokut Enver është theksuar gjithmonë nevoja e njohjes së jetës, të njeriut punonjës, thellimi në luftën e klasave dhe pasqyrimi i tyre nga pozitrat revolucionare.

Duke folur për përvetësimin e mëtejshëm të mësimave të Partisë dhe për t'u futur më thellë në vruillin e jetës, shoku Enver Hoxha, në fjalën e tij të 20 Dhjetorit 1974, thotë për krijimet e shkrimtarëve dhe artistëve:

«Veprat e tyre do t'u përngjasin, për nga dobia e madhështia, hidrocentraleve gjigante, fabrikave e kombineve, fushave të bukura me grurë dhe bregoreve plot pemë frutore, do t'u përngjasin bukurive të qyteteve tona, shkollave e çerdheve, ku cicërojnë

kalamanët e lumtur të vendit tonë socialist, ku klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe inteligjenca popullore, me mendjen dhe me mjeshtërinë e tyre, krijojnë dhe ndërtojnë një jetë të re, të lumtur e të begatshme».

Veprat më të mira të letërsisë dhe arteve të tjera dëshmojnë për një lidhje të ngushtë me jetën, për zbatimin e parimeve të realizmit, të pasqyrimin të «karaktereve tipike në rrethana tipike», siç thoshte Engelsi. Kështu, p.sh. romani shqiptar i realizmit socialist plotësoi edhe boshllëqe të së kaluarës duke dhënë tablo të plota realiste, përmes subjekteve shumëplanëshe. Njohja e jetës, e njeriut, e veprimtarisë së tij shoqërore dhe e botës psikologjike qendrojnë në bazë të shumë veprave artistike.

Edhe në artet e tjera, sidomos në pikturë, në gjininë e kompozimit apo të portretit, gjejmë të realizuara aspekte të jetës, të heroizmit popullor, të historisë dhe të së sotmes shqiptare. Ngjyrat e pikturës janë të gjalla, siç është edhe natyra shqiptare; figurat janë të kuptueshme dhe të qarta, por me një bukuri artistike që lidhet me konceptimin realist dhe me dritën e perspektivës që hedh mbi to ideali komunist.

Parimi i vërtetësisë, i qartësisë dhe materiali i pasur jetësor janë të pranishëm në tërë artin shqiptar, në të gjitha llojet dhe gjinitë e tij.

Ky parim është i lidhur ngushtë me partishmërinë komuniste, që qëndron në themel të metodës së realizmit socialist.

Shumë shembuj të artit tonë mund të silleshin për të treguar si partishmëria komuniste nuk e largon artistin nga e vërteta e jetës, po përkundrazi e shtyn drejt saj dhe kështu bëhet një shkrirje harmonike midis të dy fillesave. Elementet patriotike dhe internacionalistë duken në mjaft vepra, sidomos në poezi, që i këndon atdheut dhe popujve që luftojnë për liri dhe pa-varësi.

Krahas këtyre karakteristikave të realizuara nëpër



vepra konkrete, arti shqiptar ka një tipar të rëndësishëm dallues, frymën kombëtare dhe popullore. Duke mbrojtur këto parime, ne luftojmë kundër kozmopolitizmit të përhapur në teoritë reaksionare në botë, edhe kundër estetizmit, qëndrimit aristokratik ndaj artit. Tradita kombëtare nënkupton frymën internacionaliste. Nuk mund të kontribuojë asnjë vend në thesarin e kulturës botërore, po s'pati kultura e tij ngjyrë kombëtare, po nuk dha shpirtin e popullit të vet. Një vepër, ndër të tjera, që jep qëndrimin kundër revizionizmit dhe miqësinë me njerëzit e ndershëm të botës është edhe romani «Zbulimi» i Anastas Kondos, që përshkruan planet armiqësore të një grupi gjeologësh të huaj, të dërguar nga një vend revizionist, midis të cilëve ka edhe një njeri të ndershëm dhe mik të vendit, siç janë të shumtë sot në botë.

Këto parime kryesore të artit shqiptar kanë siguruar lulëzimin e tij dhe kanë sjellë edhe zhvillimin harmonik të llojeve e gjinive, përcaktimin e individualiteteve krijuese që vijnë e bëhen më të theksuar. Stilet janë nga më të ndryshmet. Dikush priret nga një prozë më epike, narrative si J. Xoxa, me thekse popullore publicistike si Sh. Musaraj, me ngjyra lirike humoristike si D. Agolli, dikush shquhet për aftësi përshkruese dhe dramaticitet si F. Gjata me romanin «Kënetë», për stilin popullor; si S. Spasse një tjetër narracionin e mbështet më shumë në dokumentet historike si S. Godo me «Skënderbeun», apo priret nga simboli a alegoria brenda realizmit si I. Kadare me «Gjeneralin e ushtrisë së vdekur» ose disa shquhen për një stil psikologjik si Dh. Xhuvani me romanin «Përsëri në këmbë», A. Abdihoxha me «Një vjeshtë me stuhi», Dh. Shuteriqi me tregimet e tij, për lirizëm e nuanca të botës femërore si në krijime të E. Kadare, E. Mandia, L. Leka, etj. Numri i tyre si në letërsi edhe në arte të tjera vjen duke u shtuar.

Po kështu edhe në pikturë e muzikë spikatin individualitetet përmes gjinive dhe mënyrës së pikturimit

apo të kompozimit. Individualitete krijuese në artet figurative, të cilët dallojnë për stilet e tyre janë O. Paskali, A. Buza, F. Stamo, K. Rama, K. Buza, M. Dhrami, Sh. Hadëri, L. Dhrami, F. Haxhiu etj.

Në fushën e kinematografisë ka gjithashtu realizime të theksuara dhe krijime të bukura ashtu siç ka edhe në teatrin dramatik. Arti skenik po bëhet gjithmonë e më popullor, më i dashur për masat. Filma si «Komisari i dritës», me regjisor V. Gjiken dhe Dh. Anagnostin dhe skenarist Ll. Siliqin; «Rrugë të bardha» me regjisor V. Gjiken dhe skenarist Vath Koreshin, etj., gëzojnë një popullaritet të madh tek ne.

Filmi «Komisari i dritës» niset nga ideja fisnike e përhapjes së arsimit edhe në skajet më të largëta të atdheut dhe tregon se me ç'luftë u arrit kjo në Shqipërinë e pasqirimit. Përhapja e fjalës shqip kërkoi sakrificat dhe ndonjëherë vetmohim të plotë në luftë me klerin dhe injorancën. Kurse filmi «Rrugë të bardha», përmes një drame të thjeshtë dhe njerëzore, tregon punën e një fillrojtësi, i cili sakrifikon veten që njerëzit të komunikojnë me njëri-tjetrin, të gëzojnë Vitin e Ri. Ka shumë lirizëm, dashuri të sinqertë dhe ngjyra të gjalla në kuadrot e këtij filmi.

Krijimtaria artistike bëhet gjithmonë më e gjerë dhe me cilësi më të lartë.

### ÇFARË MBROHET DHE Ç'PIKËPAMJE ESTETIKE LUFTOHEN SOT NË SHQIPËRI?

Arti i sotëm shqiptar, duke u nisur nga parimet e metodës së realizmit socialist, thëllon edhe më tej realizmin. Ata që akuzojnë këtë metodë krijuese si dogmatike dhe stanjante i mbështetin mendimet e tyre, gjoja shkencore, mbi të ashtuquajturën ide të novatorizmit të vazhdueshëm, të teknikave të reja që duhet të zëvendësojnë njëra-tjetrën, te teoritë e «mosangazhimit» dhe të «vetëshprehjes» së artit që ka, sipas tyre,



vetëm vlera subjektive dhe nuk ka pse të niset nga qëllimi për t'i shërbyer shoqërisë. Të gjitha këto dhe të tjera teorizime janë vazhdim i shkollave formaliste subjektiviste dhe, në të vërtetë, mundohen të fshehin var-tësinë e artistëve nga kapitali; ato janë shprehje të drejt-përdrejta të kaosit shpirtëror apo të pështjellimeve filo-zofike të shtresave të lëkundshme mikroborgjeze.

Mendimi estetik revolucionar shqiptar lufton në ra-dhë të parë që arti t'i qëndrojë besnik idealeve socia-liste dhe komuniste, që ai të jetë i përshkruar nga fry-ma popullore dhe kombëtare. Kjo kërkon të ruhet pas-tërtia marksiste-leniniste dhe lidhja e drejt-përdrejtë me jetën, me masat punonjëse, prej nga burojnë temat dhe frymëzimi. Kjo frymë revolucionare e artit shqiptar është në kundërshtim me rrymat moderniste dekadente dhe me artin që u përmbahet ideve dhe politikës revizioniste të sotme në Bashkimin Sovjetik dhe në vende të tjera ish-socialiste.

Revizionizmi në politikë e ideologji ka gjetur shpreh-je të plotë në vepra letrare e artistike që kanë dalë e dalin në Bashkimin Sovjetik që prej kohës kur erdhi në fuqi klika hrushoviane. Arti i këtij vendi ka he-dhur poshtë çdo traditë revolucionare; me gjithë dema-gogjinë që përdorin teoricienët revizionistë sovjetikë, nuk ka mbetur asgjë nga tradita e dikurshme. Fryma antirevolucionare e këtij arti, që niset nga pacifizmi e humanizmi abstrakt dhe deheroizimi, duket qartë në ve-pra si «Shkrirja», e I. Ehrenburgut, «Fati i njeriut» e M. Shollahovit, «Pas hapësirës, hapësirë» e A. Tvar-dovskit, «Të gjallë e të vdekur» etj., të K. Simonovit, si edhe të shumë poezi konformiste, që ndjekin haptazi po-litikën hrushoviane, poezi të Jevtushenkos, etj. Kjo fry-më vazhdon të thellohet me vepra të mëvonshme në dy drejtime kryesore, që kanë një bazë të përbashkët anti-revolucionare: me drejtimin e hapur të politikës së su-perfuqisë socialimperialiste, e cila shprehet në vepra që frymëzojnë «madhështinë» rusomadhe, në vepra shovi-niste që përshkohen nga ideja e pansllavinizimit, larg

çdo vështrimi social, si dhe me drejtimin tjetër, që vazhdon të thellohet, të dekadencës morale. Ky drejtim duket në vepra ku mbrohet njeriu i gjymtuar, ku injorohen apo shikohen me skepticizëm heronjtë e dikurshëm të luftës patriotike; vërehet në vepra ku spikasin marrëdhëniet e zymta morale dhe rënia e familjes, borgjezimi i saj dhe vërshimi i gjithë mërzitjes dhe pikëllimit individualist. Kjo duket edhe në vepra me një nostalgji të hapur për gjithçka të vjetër e sllave. Këta janë tregues të qartë të penetrimit të rrymave moderniste-dekadente në artin e sotëm revizionist sovjetik.

Në Bashkimin Sovjetik sot mundohen ta përlligjin këtë lloj arti që prodhohet. Përdoret edhe shumë demagogji, ndonëse ka një hendek të madh midis fjalëve dhe vetë krijimtarisë. Në teorizimet sovjetike për artin, shpesh dilet edhe haptazi në pikëpamje se gjoja janë vjetëruar tezat mbi partishmërinë, heroin pozitiv dhe, mbi të gjitha, ata mohojnë luftën klasore, idealet komuniste dhe pasqyrimin e tyre në veprën e artit. Të gjitha këto i përlligjin, nga ana e jashtme, gjoja me idenë e «evoluimit» të vazhdueshëm të artit në kushtet e sotme. Nuk ka gjë më të neveritshme dhe më false se pohimet hipokrite kur degjenerimi paraqitet si «progres» dhe mohimi i parimeve revolucionare si «qëndrim krijues ndaj tyre!».

Arti i realizmit socialist në Shqipëri, që hedh poshtë këtë art dhe këto pikëpamje është një art me novatorizëm të thellë, sepse karakteri i tij novator nuk nisët nga eksperimentimet subjektiviste, por nga e reja në jetë, nga përmbysja e marrëdhënieve të vjetra feudo-borgjeze dhe zëvendësimi i tyre me marrëdhënie socialiste. Ky novatorizëm i përmbajtjes sjell edhe novatorizëm në formë, po këtë raport midis përmbajtjes dhe formës ne e shohim me sy dialektik dhe s'pajtohem me mohimin e traditës, ashtu sikundër nuk pajtohem as me format anakronike, të vjetëruara. Novatorizmi nuk qëndron tek ndryshimi i termave apo te emërtimi i shkollave; kryesore këtu është brendia dhe më novator se



realizmi i vërtetë dhe aq më tepër se realizmi socialist, nuk mund të ketë, sepse ky nisët nga jeta dhe pikërisht jeta është ajo që ndryshon vazhdimisht, sipas disa ligjeve të caktuara ekonomike dhe shoqërore. Mendimi i partishëm, kritika, opinioni letrar në Shqipëri gjithmonë kanë mbrojtur dhe mbrojnë idenë se realizmi socialist duhet kuptuar jo si diçka e ngurtë dhe statike, por gjithmonë në lëvizje, në dinamikë, sepse shoqëria socialiste ecën përpara me ritme të shpejta dhe nuk duhen përsëritur në mënyrë mekanike po ato tema dhe po ato zgjidhje artistike. Lufta kundër modernizmit dhe kundër rutinës konservatore janë një realitet që vëreshen në praktikë dhe ndihen në rrugën e zhvillimit të artit. Kështu ka evoluar romani, duke marrë përpjesëtime të gjera në pasqyrimin e masës dhe të individit, në gërshetimin e planeve kohore për të zbërthyer më mirë analogjinë e kohëve dhe mendimin e shkrimtarit; është zhvilluar më tepër skulptura monumentale që jep madhështinë e kohës; edhe gjini të njohura e të lëvruara më parë si portreti, peizazhi, kanë pasur ndryshime; poema ka shkrirë realitetin me botën e brendshme të shkrimtarit; filmi është pasuruar me dramacitet dhe me skena masive, kurse baleti ka ngërthyer format klasike dhe kombëtare duke përfutur emocione të reja të fuqishme, të denja për një art që nisët nga mendimi se populli është forca kryesore lëvizëse e historisë dhe se individi i shquar i ka rrënjët te populli dhe te historia e tij. Të gjitha këto forma të evoluimit janë tipike për artin shqiptar dhe krijojnë larmi stilistikore, pasuri përmbajtjeje dhe individualitetesh artistike. Por qëllimi i artistëve është i përbashkët — revolucioni, fryma dhe idetë e tij, pasqyrim i popullit. Kjo i bashkon individualitetet që nuk veprojnë veç e veç, nuk bien në labirintin e individualizmit.

Në qendër të artit duhet të jetë njeriu; nuk kanë jetë të gjatë, si të gabuara në themel, pikëpamjet e dehumanizmit. Ky problem nuk duhet parë në më-

nyrë abstrakte dhe jashtë luftës së klasave. Njeriu në artin dhe në mendimin teorik, shihet si një qenie shoqërore, që i përket një klase të caktuar, shihet si një «tërësi e marrëdhënieve shoqërore», siç thoshte Marksii. Shprehjet e humanizmit mbiklasor, apo shprehjet e përjashtimit të njeriut nga arti, duke e zëvendësuar me simbole, me shenja konvencionale, janë të huaja për artin shqiptar dhe, kur janë dukur aty-këtu vepra të veçanta apo në teorizime, janë kritikuar e luftuar. Në të gjitha kohët arti i vërtetë ka pasur në qendër njeriun, shtresat përparimtare të shoqërisë dhe konvencionalizmi ekstrem apo abstraksionizmi nuk kanë të bëjnë me thellimin e përgjithësimeve dhe të filozofisë, siç pretendohet, po përkundrazi, me deformimin e mendimit, me filozofinë e çoroditjes dhe të pesimizmit. Arti sot bëhet më filozofik, më poetik, se mendimi hyn gjithmonë e më mirë në pëlhurën e veprës bashkëkohore, që ka në qendër faktin dhe realitetin. Format stilistikore mund të jenë të shumta dhe të larmishme; kuptohet edhe nevoja e përdorimit të simboleve dhe konvencionit kur burojnë nga jeta dhe kur nuk prishin raportet e drejta midis objekteve dhe pasqyrit të tyre (arti mund t'i zërthejë më mirë anët e ndryshme të fenomeneve dhe të botës së njeriut, po jo t'i deformojë gjer në mosnjohje dhe shtrembërim që shkon në absurditet). Në nisemi nga filozofia e jetës dhe jo e vdekjes, nga humanizmi revolucionar dhe jo abstrakt, nga mundësia e njohjes së botës së njeriut dhe jo nga agnosticizmi, prandaj jemi kundër abstraksionizmit apo ekzistencializmit si edhe kundër revizionizmit në art.

Teoritë që përlligjin largimin nga realizmi e quajnë të vjetëruar natyrën figurative të artit, (kemi parasysh artet që mbështeten mbi figurën artistike) pretendojnë se është kapërcyer në artin bashkëkohor domosdoshmëria e pasqyrit konkret të njeriut, në kohë dhe në hapësirë, si dhe të formave reale të natyrës e, madje, edhe vetë pasqyrimin e konsiderojnë të panevojshëm etj. Këto teori kanë filluar qysh në manifestet e rrymave



subjektiviste të fillimit të shekullit e kanë vazhduar edhe më vonë me teoritë e «antiromanit», me shkollat formaliste e strukturaliste e kanë për bazë filozofike idealizmin. Është e qartë se pasqyrimi nuk jep kopjen adekuate të objekteve (dhe për artin realist kjo as që është e nevojshme) se përfytyrimi realist gërsheton thelbin dhe shfaqjen e tij konkrete, të parë në dritën e idealit, të botëkuptimit artistik. Mundësitë e njohjes janë të shumta dhe të pashterueshme, kështu që artisti, i cili do të zbulojë të vërtetën, nuk mund të kënaqet me shkallën e arritur dhe gjithmonë priret drejt njohjes emocionale dhe racionale të botës. Realizmi socialist nuk pajtohet me natyralizmin dhe synon përherë drejt zgjerimit të mundësive njohëse të jetës. Por kjo nuk mund të bëhet duke mohuar specifikën figurative të artit. Mënyrat e reja të shprehjes artistike mund të vënë në dukje më mirë një anë apo një tjetër të fenomenit, sipas temës, idesë, pikësnyimit, të autorit, veçorive të një kulture, të folklorit të një vendi etj. Por largimi nga karakteri konkret i figurshëm i artit (nuk është fjala për arte dekorative) sjell vetëm deformimin, e izolon artin nga jeta dhe vetvetiu shpie drejt shuarjes së tij. Në këto raste, siç vumë re në shkolla të ndryshme moderniste, kur shkatërrohet çdo formë reale apo skematizohet dhe shprehet me simbole që janë vetëm konvencione të pakapshme, arti nuk ka të bëjë më me qëllimin e madh për t'i shërbyer njerëzimit, siç ka nisur që në kohët më të lashta, po kthehet në një gënjeshtër, zbrazëti dhe degjenerim të plotë.

Mendimi estetik shqiptar ka mbrojtur dhe mbron idenë e pasqyrimin të heroit pozitiv në letërsi e arte, të njeriut më të mirë në shoqëri që haset tani më shpesh në jetën e përditshme. Ky hero s'duhet të jetë skematik, po i gjallë, jetësor dhe të dalë në luftë e sipër përmes pasqyrimin të kotradiktave, me ideale të qarta e të fuqishme shoqërore. Pasqyrimi i kontradiktave të jetës dhe zgjidhja e drejtë e tyre është një

problem i madh i realizmit socialist. Tradita në këtë fushë ka shumë. Për arsye të zbulimit të thellë të konflikteve të shoqërisë borgjeze, në Shqipëri pëlqehen shumë vepra të Balzakut, Tolstoit, Dikensit, Ibsenit, Drajzerit, Shout, Kazanqaqisit, etj. Për frymën antikonformiste revolucionare, antifashiste gëzojnë respekt poezi e drama të Fularit, Lorkës, Brehtit, Maçados, që zgjojnë edhe sot urrejtje kundër forcave të errëta, fashizmit, kundër frankizmit; pëlqehen shumë gjithashtu veprat bashkëkohore të autorëve patriotë antiimperialistë të Evropës, Azisë, Afrikës, Amerikës Latine, që luftojnë për sigurimin e të drejtave të tyre e për liri.

Arti shqiptar i realizmit socialist është duke u zhvilluar dhe ka një perspektivë të sigurt. Për këtë dëshmojnë veprat që botohen e shfaqen, simpatia që gëzojnë këto në masa, ndikimi real që sjellin ato në ndërgjegjen e njerëzve. Artistët shqiptarë kanë shumë miq bashkëluftëtarë në të gjitha anët e botës dhe janë të bindur se e ardhmja i takon artit që thotë të vërtetën dhe që ngrihet e do të ngrihet gjer në mendimin revolucionar komunist.

1976.



## POEZI E VITEVE 1973-1975

Poezia, si një fushë e veçantë, e bukur e shprehjes artistike të mendimeve dhe ndjenjave, ka lojtur dhe lot një rol të madh në kulturën shpirtërore të vendit tonë. Poezia nuk i ka munguar asnjëherë këtij populli me shpirt të pasur dhe origjinal, me fantazi të mprehtë, që ka kaluar një jetë të vështirë plot vuajtje e mundime, plot luftëra e kontraste të mëdha shoqërore, gjersa fitoi lirinë në shoqërinë e re socialiste, i udhëhequr nga Partia. Por poezia e jetës së re është shumë e pasur, një poezi optimiste dhe revolucionare. Kjo poezi e jetës plot heroikë, bukuri morale dhe ndeshje të reja, ka gjetur e po gjen shprehje në artin poetik, i cili shpie përpara, me krijime të shumëllojshme dhe autorë të ndryshëm, fijet më të qëndrueshme dhe më të bukura të poezisë sonë që zënë fill nga krijimtaria e pavdekshme e popullit, e cila zhvillohet edhe sot në sytë tanë, nga poezia e gjerë, e dhemshur dhe e ndritur e Naimit, nga vargjet plot dritë e bardhësi të De Radës, apo nga mendimi i thellë dhe fjala plot dhimbje e revoltë e Migjenit. Poezia jonë e realizmit socialist shfrytëzon traditën e shëndoshë të së kaluarës dhe, në një realitet revolucionar e me botëkuptim të ri, është bërë një poezi cilësisht e re, e lindur nga revolucioni dhe që i përket atij. Etapat

e ndryshme të zhvillimit të saj, si edhe të gjithë letërsisë dhe arteve tona shënojnë vetëm shkallë të ndryshme zhvillimi, janë hallka të një zinxhiri të lidhur dhe të pandarë. Nga poezia e Luftës Nacionalçlirimtare, ku gjejmë fillimet e realizmit socialist dhe thekset romantike, me një frymë optimiste dhe heroike, nga vargjet-këngë të F. Gjatës, A. Varfit etj., nga poezia therrëse dhe e frymëzuar satirike e Sh. Musarajt, apo nga vargjet e ndiera të shkruara në një mënyrë popullore të M. Metos e Sh. Peçit, poezia e pasçlirimit, në kushte të reja, filloi t'i gërshetojë notat romantike me një vështrim më të gjerë realist, duke ruajtur gjithmonë temperamentin, intonacionin heroik dhe duke zgjeruar sferën e problemeve dhe të temave që trajtonte. Ajo bëri përgjithësim më të ndjeshme për luftën, zuri të pasqyrojë temat e aktualitetit dhe të vazhdojë të lëvrojë gjerësisht poezinë qytetare politike me motivet e reja që vinte përpara koha. Poezia jonë e ka kërkuar rrugën e vet të forcimit të brendisë dhe të zhvillimit artistik me forma të ndryshme: herë duke iu afruar jetës përmes një tregimi poetik, herë duke gërshetuar faktet me mendimin, herë me vargun tribun dhe shprehës të drejtpërdrejtë të ideve, herë përmes meditimeve dhe një lirike më të kërkuar. Rruga e saj nuk ka qenë e lehtë: ndonjëherë ajo ka rënë në skematizëm, si edhe në përshkrime të thata, pa forcën e duhur të idesë. Ka pasur edhe deklaratizëm, vargje të sipërfaqshme dhe pompoze që nuk niseshin nga problemet e vërteta të jetës dhe nga mendimi i thellë, apo ka mbetur e përgjithshme dhe e abstraguar, pa atë «lëngun» e domosdoshëm të jetës, që duhet ta ketë gjithmonë poezia. Ka pasur gjithashtu edhe shfaqje subjektivizmi dhe shprehje individualiste, që shpinin në një sentimentalizëm apo erotikë dhe botë intime të ngushtë.

Janë vënë re shfaqje liberale dhe konservatore, që çonin në modernizëm ose në anakronizëm. Për t'i mënjeluar këto, Partia gjithmonë ka orientuar që lufta të bëhet në të dy krahët.



Lufta e Partisë, zhvillimi i vendit kanë lojtur rolin e tyre drejtues edhe në rrugën e poezisë. Frymëzimet e mëdha dhe përgjithësimet e Luftës e të aktualitetit në periudhën e viteve të para të çlirimit u shprehën në poema dhe vargje të Ll. Siliqit, A. Çaçit, K. Jakovës, L. Qafzezit. Krahas këtyre e poetëve të tjerë ne çmojmë dhe nderojmë kontributin që kanë dhënë D. Siliqi e M. Gurakuqi, të cilët zënë një vend të merituar në poezinë tonë.

Siç dihet, fundi i viteve '50, fillimi i viteve '60, shënon një zhvillim të dukshëm të poezisë sonë, e cila arriti të japë përgjithësime më të shumta dhe më të mëdha në vepra të autorëve të njohur deri atëherë si Ll. Siliqi etj. dhe në vepra poetike të autorëve, që u bënë të njohur në këtë periudhë si I. Kadare, D. Agolli, F. Arapi etj. Krijimet poetike të kësaj kohe shquhen për një lidhje më organike të botës materiale me botën shpirtërore të njeriut, për një shkrimje më të harmonishme të anëve tipike dhe individuale, gjë që e bën poezinë edhe më të përhapur e më të dashur për masat e lexuesve dhe e pasuron në mendime e në ndjenja. Në këtë rrugë vazhduan e zhvillohen edhe sot këta poetë si edhe më të rinjtë që erdhën pas tyre. Lidhja organike e epizmit me lirizmin, me epërsinë e epizmit, është karakteristikë e viteve të mëvonshme.

Një thellim në psikologjinë e njeriut të sotëm, lidhur me realitetin dhe me veprimtarinë e tij shoqërore, kanë bërë poetët tanë më të mirë; në shembullin e tyre kanë ecur edhe poetët më të rinj. Arritje dhe freski poetike janë vënë re në krijimet më të mira të poetëve të rinj apo me një stazh më të vjetër që janë dalluar krahas të tjerëve, në vitet '70 si K. Petriti, N. Pappleka, N. Gjetja, Ll. Ruci, Xh. Spahiu, e mjaft të tjerë.

Si pasojë e ndikimeve të huaja liberale në jetë e në ndërgjegje, sidomos tek disa poetë të rinj u vunë re shtrembërime të realitetit, kuptim i gabuar i kontradiktave dhe i luftës kundër burokratizmit dhe një

modernizëm i dukshëm, si në përmbajtje ashtu edhe në formë tek disa krijime të veçanta. Plenumi IV i KQ të PPSH kritikoi këto dukuri negative, që ishin të theksuara sidomos në poezi, duke treguar njëkohësisht se trangu i saj është i shëndoshë. Në kritikën që u bë në prag dhe pas Plenumit IV u theksua lufta kundër hermetizmit, shprehjeve simboliste apo surealiste, figura-ve të tepëruara dhe alogjike, me lidhje dhe shoqërime idesh arbitrare. Këto dhe shfaqje të tjera të modernizmit në brendi dhe formë nuk ishin të rastit dhe shprehnin qëndrime subjektive, liberale, një lëshim me ndërjegje tek disa autorë dhe disa krijime, ndaj pozitës borgjeze dhe revizioniste, si edhe ndikime nga poezia moderniste apo revizioniste. Këto çuan, në ato raste të gabuara, edhe në çoroditje të formës, në figurën dhe vargun amorf e të errët, që nuk është tjetër veçse pasqyrë e një çoroditjeje dhe turbullimi të brendshëm. Këto dukuri u kritikuan ashpër e me argumenta teorike dhe tani mund të themi me bindje se, megjithëqë kemi ende shfaqje të tilla, në përgjithësi ajo gjendje është kapërcyer dhe poezia ecën më me siguri në rrugën e realizmit socialist, duke qenë përpara një hopi të ri cilësor.

Orientimi që dha shoku Enver në Plenumin IV për të luftuar ndikimet e huaja, si liberale ashtu edhe konservatore, dhe për të forcuar më tej përmbajtjen e poezisë si edhe të gjithë artit tonë ka qenë dhe është një ndihmë e madhe dhe frymëzim për poetët tanë. Lufta që iu bë, pas Plenumit IV, ndikimeve të huaja në poezi, tendencave të tjetërsimit e të formalizmit, si edhe të shtrembërimit e të nxirrjes së realitetit, të nxitura nga armiqtë e Partisë, të popullit, të kulturës kombëtare dhe të realizmit socialist, Fadil Paçrami e Todi Lubonja si edhe nga pasuesit e tyre, që modernizmin e quanin «novatorizëm» dhe donin me çdo kusht t'i hapnin udhën kësaj poezie, — ishte dhe mbetet një



luftë e domosdoshme për të forcuar pozitën e realizmit socialist në poezi, për të flakur prej saj çdo gjë të huaj e të dëmshme. Poezia jonë, nën këta vjet, ka ecur më përpara, ka njohur suksese të reja dhe ka forcuar përmbajtjen e saj.

Poetët tanë në këtë periudhë kanë forcuar frymën revolucionare, kanë pasuruar poezinë me ide e motive të rëndësishme nga e sotmja dhe historia e popullit dhe kanë bërë përpjekje për të zgjeruar sferën e temave dhe të subjekteve. Si pasojë e këtyre arritjeve, poezia është larguar nga ajo frymë e sëmurë që mundi të depëronte në disa krijime, në kushtet e ashpërsimit të luftës ideologjike dhe estetike, të presionit imperia-  
listo-revizionist ndaj nesh; tani mund të themi se nuk përbën më një problem të mpërehtë hermetizmi apo shfaqje të tjera formaliste. Poezia është bërë më e qartë: jeta ka hyrë më me siguri dhe më gjerësisht në rrjedhën poetike dhe fjala e frymëzimi popullor tani ndihen më tepër. Natyrisht, do të ishte e gabuar dhe jorealiste, po të pohonim se tani u çliroam nga të gjitha gabimet dhe s'kemi përse të luftojmë. Kanë dalë dhe dalin probleme të tjera ideestetike që kërkojnë interpretim dhe zgjidhje, po, veç kësaj, ende hasim shtrembërime të natyrës ideologjike, ndonjë largim nga parimi i partishmërisë proletare dhe nga tradita e poezisë sonë, probleme të formës që ndikon mbi përmbajtjen etj. Detyra jonë është të zbulojmë anët pozitive dhe të mos mbyllim sytë para gabimeve. Por sukseset janë të dukshme dhe kjo doli e qartë sidomos në krijimtarinë poetike kushtuar 30-vjetorit të Çlirimit. «Artistët dhe shkrimtarët, — thotë shoku Enver në fjalën e tij të 20 Dhjetorit 1974, — të frymëzuar nga vendimet e Plenumit IV të KQ të PPSH, erdhën në këtë jubile të madh me tërë ato krijime të bukura. Këto realizime, në vargun e të tjerave, dëshmojnë, përveç të tjerave, për mundësitë që krijohen kur populli është në fuqi e udhëhiqet nga një Parti revolucionare, marksiste-leniniste, siç është Partia jonë e Punës».

Krijimtaria poetike e kësaj periudhe, në këta tre vjetët e fundit, ecën në vazhden e realizimeve më të mira të poezisë sonë, sidomos të poemës së lëvruar tek ne gjerësisht. Poezia ka ecur përpara me poemat dhe me vjershat e krijuara, por, na duket, se arritet më të mëdha, më të ndieshme i kemi pasur në poemë, gjini që jep mundësi më të shumta përgjithësimi, pasqyrimi dhe meditimi rreth pamjeve dhe problemeve të jetës. Gjinia e poemës ka ecur e është zhvilluar më tej në rrugën e poemave të tilla madhore si «Prishtina» apo «Ringjallja», «Shënime për brezin tim», apo «Përse mendohen këto male», «Devoll, Devoll», apo «Baballarët», «Alarme të përgjakura» etj. Në kushtet e ashpërsimit të luftës klasore, të luftës në frontin ideologjik e estetik kundër rrethimit imperialisto-revizionist, në kushtet ndërkombëtare kur popujt luftojnë kundër të dy superfuqive, të cilat duan të vendosin hegjemoninë e tyre në botë, poezia jonë e, në radhë të parë poema, është bërë edhe më militante dhe më polemiste, ka mprehur tehun e saj revolucionar. E lindur në këto kushte të luftës së drejtpërdrejtë me armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm, e udhëhequr nga mësimet e Partisë dhe të shokut Enver, poezia ka pohuar me forcë realitetin tonë socialist, ka treguar lidhjet e thella morale dhe shpirtërore të popullit me Partinë, i ka kënduar punës dhe heroizmit dhe është munduar të zbulojë më mirë botën shpirtërore të njeriut të sotëm, përmes së vërtetës realiste. Duke mbrojtur poezinë revolucionare kundër ndikimeve moderniste, në disa raste edhe përmes vetë vargjeve, ajo ka afirmuar parimet estetike të realizmit socialist, duke hyrë kështu në një polemikë estetike, e cila ka tradita në poezinë shqiptare dhe botërore.

Karakteristike, sidomos për poemën, është rruga e përgjithësimeve të mëdha, e lidhjes organike të së sotmes, e cila ngrihet në qendër të strukturës poetike, me të kaluarën, natyrisht, edhe me dritën që hidhet në të ardhmen. Kështu, në mjaft poema, pavarësisht nga tema dhe subjekti, shtrohet problemi i kohës sonë dhe i revolucionit, i njeriut të ri që edukon Partia, pro-



blemi i vazhdimësisë në rrugën luftarake, i forcës së pashtershme të popullit dhe i humanizmit revolucionar. Gërshetimi i harmonishëm i shoqërisë dhe i njeriut, i poetit me tokën, popullin dhe Partinë e tij, shkrirja organike e elementeve tipikë dhe individualë, me fjalë të tjera, ajo sintezë e së përgjithshmes dhe së veçantës, që u duk më qartë me fillimin e viteve '60, po kristalizohet edhe më tej duke na dhënë shembuj të një poezie të ndier dhe me përmbajtje të thellë. Poetët tanë në këtë periudhë problemin kryesor të forcimit të përmbajtjes e kanë marrë të lidhur ngushtë dhe me punën e cilësisë, të unitetit midis përmbajtjes dhe formës, duke shpурë edhe më përpara, në disa krijime, nivelin e arritur deri tani. Dialektika e jetës ka depërtuar në vargjet e poezisë dhe shpesh idetë më të rëndësishme kanë dalë përmes tablove konkrete, monologjeve poetikë, vrulleve të drejtpërdrejta e të frymëzuara, parantezave lirike dhe një zhdërvjelltësie të formës, tipar ky që po përftohet më shumë tek poetët tanë më të mirë.

Në këtë periudhë janë shquar me krijimet e tyre poetë brezash dhe individualitetesh të ndryshme.

Arritjet, që vumë re në fushën e poemës, spikasin te poema e njohur tani e D. Agollit Nënë Shqipëri». Autori ecën në gjurmët e krijimeve të veta dhe të poezisë sonë më të mirë, duke bërë edhe një kapërcim në udhën e tij krijuese, sidomos në përmasat e gjera të poemës, në trajtimin e shumë pamjeve dhe periudhave të jetës shqiptare dhe në forcimin e militantizmit, që e shpie poetin në shprëthime lirike qytetare me një forcë të rrallë, duke u bërë kështu shembull i poezisë së partishme, të mbështetur te shpirti dhe gjuha e popullit. Frymëzimi, dashuria për atdheun dhe Partinë, dashuria për tokën dhe njeriun e punës, theksi polemist dhe qytetar, epizmi i gërshetuar natyrshëm me lirizmin janë tipare të vëna re që në krijimet e përparshme të poetit si «Devoll, Devoll», «Baballarët» apo «Komunistët». Ai ka shprehur ndjenjat e çdo shqiptari dhe

revolucionari të vërtetë duke e trajtuar temën e atdheut, me gjerësinë e Naimit të «Bagëti e bujqësi», po në kushtet e sotme, me një vështrim realist prej njeriut të kohës sonë dhe prej komunisti. Vargjet e kësaj poeme kanë gjetur jehonë në zemrat e lexuesve. Autori i drejtohet Shqipërisë me një thjeshtësi dhe frymëzim të vetvetëshëm dhe figurat e natyrshme, krahasimet, epitetet, detajet, vijnë njëra pas tjetrës me një ngjyrë kombëtare të dukshme:

Më ler të bie në prehrin tënd të ngrohtë,  
O hallemdhja ime shekulllore!  
Të puth duart e tua, më të mirat në botë,  
I ngazëllyer të hesht me heshtje foshnjore;  
Duart e tua që u regjën nga puna  
Dhe gishtërinjtë që zunë kallo nga këmbëzat e  
dyfekteve.  
Dhe supet që u varën nga xhokja e nga guna,  
Dhe mesin që u hollua nga gjerdanët e fishekëve...

Poema e D. Agollit, sikundër edhe krijime të tjera të arrira të kësaj periudhe, vlejnë si shembull për poetët e rinj, dëshmojnë për partishmërinë e thellë, për vargjet që nuk bien në deklaratat e poza dhe për gjuhën e kulluar shqipe.

Duke ecur në gjurmët e krijimeve të tij më të mira, Ll. Siliqi shkroi poemën «Mesazhi», që është një përgjithësim i rrugës heroike të popullit tonë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe në ndërtimin e socializmit. Autori ka ditur të përdorë me mjeshtëri figurën legjendare të maratonmakut, që buron nga antikiteti dhe është trajtuar shpesh në letërsi si edhe në poezinë tonë, në vargjet aq të njohura të Fan Nolit. Figura simbolike e bartësit të mesazhit, që shpie fjalën e zjarrit të Partisë nga koha në kohë, nga brezi në brez, është konceptuar bukur dhe me gjerësi. Ai nuk na jepet si një figurë apo si një personazh i konkretizuar vetëm në një drejtim, siç mund të bëhet në prozë apo në një tre-



gim të mirëfilltë poetik. Autori ka përdorur mjetet e poezisë, montimin e përfytyrimeve për të na dhënë një figurë poliedrike: njeri i popullit që do'i nga vuajtjet, nga mjerimi; mund të ketë qenë tipograf, malësor, bujk, nga jugu, nga veriu, nga Kruja, nga Gjirokastra e që është personifikim i popullit. Një mishërim i tillë i shumanshëm i figurës njerëzore vërehet edhe në poemën e D. Agollit që përmendëm, ku uni lirik përfshin jo vetëm poetin (siç kuptohet zakonisht) po përfaqësuesin e shtresave të ndryshme. Te Ll. Siliqi figura ka një tingëllim simbolik që, në këtë rast, i ndihmon autorit për të shfaqur më mirë idenë e heroizmit masiv dhe të rendjes revolucionare të masave. Poema është e fuqishme dhe me një frymë të theksuar militante.

Vargjet e saj janë të gdhendura dhe me gjuhë të zgjedhur, gjë që e ka shquar gjithmonë këtë autor:

Përherë ndër vite — ballë i barrikadave

Ai — maskëçjerri i superfuqive

E shpartalluesi i bllokadave,

I lajkave

Demagogjive,

Shantazheve e komploteve,

Pabesive.

Theksi politik i kësaj poeme ka gjetur shprehje poetike dhe intonacionet oratorike janë një cilësi e poezisë qytetare, që po zhvillohet e duhet të zhvillohet edhe më shumë ndër ne.

Si këto dy poema, ashtu edhe të tjera, që u shkruan në 30-vjetorin e Çlirimit, hyjnë thellë në karakterin popullor dhe në humanizmin revolucionar. Ky humanizëm socialist, që niset nga pasioni për t'i kënduar njeriut të popullit në luftë kundër armikut, spikat në vargje të frymëzuara të poemës të D. Agollit, në lirika të Sh. Peçit e të F. Gjatës, në poemën «Drejt qindra shekujsh shkojmë», të F. Arapit e në krijime të tjera.

Poema e F. Arapit «Drejt qindra shekujsh shkojmë», nisët nga një ngjarje e kohës së luftës (partizanët gjejnë një fëmijë të përkulur në gjirin e nënës së vrarë nga fashistët) dhe, përmes kësaj ngjarjeje tronditëse, arrin në përgjithësime me nota patetike dhe me simbole që burojnë nga jeta dhe nga mendimi sintetizues. Edhe në temën që kap, edhe në trajtimin e saj poetik, autori vazhdon fillin e krijimeve më të mira të tij e të shokëve të tjerë dhe largohet nga ajo mënyrë dhe nga ato vargje hermetike që patën depërtuar në ndonjë krijim të tij të mëparshëm. Kjo priret e shëndoshë u duk qartë në një cikël të botuar në «Nëntori» pas Ple-numit IV, me vargje të ndiera për dëshmorët e të mbështetura në motive popullore. Horizonti dhe prega-titja ideore e kanë lejuar poetin të japë një tablo të ngjeshur për dashurinë e botës së re ndaj njeriut, për partizanët që ngrenë lart fëmijën, që e shkëputën nga vdekja dhe shkojnë pa u trembur në luftë kundër botës së vjetër. Revolucionet, popujt i kanë me vete në marshimin e tyre. Duke ruajtur mënyrën e vet të krijimit, autori, na jep figura me frymëmarrje të gjerë, përgjithësisht të goditura. Në shtratin e saj kryesor, poema përshkohet nga një tension dramatik dhe zgjon ndenjë të fortë:

Në këto male të mia,  
Ku nëpër qiej të shekujve,  
Porsi dy degë vetëtime  
Fekste edhe mjerimi,  
Shpërthente dhe trimëria,  
As do t'u shkonte ndër mendtë  
Në gji të vdekur të nënës  
Një kalama të shikonim  
Gjithë universin të mëndë.

Vinim prej qindra shekujsh,  
Drejt qindra shekujsh shkonim.



Lidhjen e heroit me popullin, me njerëzit e thjeshtë, përmes pasionit poetik dhe aftësisë përshkruese, trajton edhe P. Jorgoni në poemën e tij «Baladë për Zaho Kokën», që është një krijim i frymëzuar dhe i thellë.

Në atmosferën pas Plenumit IV janë aktivizuar mjaft poetë si L. Qafzezi, A. Çaçi, ashtu si edhe të tjerë më të rinj.

Poema e L. Qafzezit «Pa malet nuk ka majë», me material konkret, ndonëse pak të ngarkuar, trajton problemin e kapërcimit të kontradiktave joantagoniste në ndërgjegjen e fshatarit nën ndikimin e ideve të Partisë dhe të traditës luftarake. Uniteti i brezave shtrohet drejt në këtë poemë, ku gjejmë mjaft vargje të frymëzuara. Një poemë të frymëzuar për luftën, për një hero të saj ka shkruar A. Istrefi «Poemë për Karadakun». Do të përmendim edhe poemën e poetit të ri Skënder Buçpapaj «Monolog partizan», që ka debutuar vitet e fundit dhe ka dhënë krijime të mira. Është interesant te kjo poemë depërtimi në shpirtin e partizanit, shkrirja e botës së tij me natyrën, me nënën shqiptare që i rri mbi kokë. Natyrisht, poeti është ende i ri dhe nuk ka arritur ta japë luftën me forcën e idealit dhe gjerësinë e mendimit, por poema është e rrjedhshme, me një ndërtim të qartë dhe me ndjenjë. Frymëzimi i vetvetishëm ndihet në vargjet e saj:

Unë nuk e dija nga vinte ky ujë i freskët  
që ra mbi plagët e mia,  
As rrëshira e pishës, as copa e prerë e këmishës.  
Po nëna partizane më tregoi se ky ujë  
Dilte hershëm nga prehri i një mali  
ku hedhin shtat  
Pisha dhe ahe, ku buron buzëqëshja e  
larme e luleve...

Ndonëse poema ka nota të theksuara romantike dhe diçka hera-herës libreske, ndihet në të freskia dhe pas-

tërtia e ndjenjës, largimi nga mënyra të ngurtësuarra dhe deklarative.

Një gjallërim ka pasur kohët e fundit në poezinë e tij edhe K. Petriti, sidomos me dy poema «Firma e popullit tim» dhe «Ura e Bushtricës», ku bën një pasqyrim poetik të rrugës së popullit, tregon kontrastin e së sotmes së lumtur me të kaluarën e mjeruar, përgjithësisht me figura konkrete dhe gjuhë e varg të qartë.

Ka qenë një fakt i gëzueshëm që në këtë situatë revolucionare, të mobilizimit të gjithë forcave krijuese, botoi poemën e tij «Muharrem Çollaku» (Baladë e Kalasë së Pogradecit) klasiku i gjallë i poezisë sonë, Lasgush Poradeci. Stili popullor, vrulli shqiptar dhe gdhendja e fjalës janë tipike për këtë poemë që gjeti pëlqimin e lexuesve.

Si një varg sa tradicional aq edhe i ri tingëllon tërrokëshi në këtë poemë:

Ç'thotë zëri i tamburasë?  
Mos më shko, gjerman, Kalasë,  
Se të kap shqipua në rrasë,  
Të mbyll në qivur me drrasë,  
Të dërgon pa shpirt në ferr,  
Me gjith' shtab, me gjith' Hitler.

Poema jonë në këtë periudhë është zhvilluar më tej. Në të ka hyrë më mirë jeta dhe njeriu që ndërton socializmin. Si ngjini e madhe dhe e vështirë, ajo është pasuruar edhe në strukturën e saj, në zgjedhjen e subjekteve, në lidhjen organike të episodeve me mendimin. Poetët më të mirë kanë fituar më shumë mjeshtëri në thurjen e poemës. Po, natyrisht, probleme të mjeshtërisë e të stilit dalin edhe për këta, sikundër dalin edhe probleme të thellimit të brendisë dhe pasqyrimit të shumanshëm të njeriut tonë, po t'i drejtohem një numri më të madh poetësh.

Kështu, p.sh., në poemën e D. Agollit ndonëse është gjetur një arkitekturë e shkathët, brenda saj mund të



kishte ndonjëherë një lidhje më organike midis kapitujve dhe mund të bëhej një trajtim më i gjerë i disa motiveve që janë kaluar shkurt. Gjetja dhe konceptimi i figurës simbolike të «Mesazhi» i Ll. Siliqit është në bazë të ndërtimit të poemës që ka një linjë të vetme subjekti, por mendojmë se brenda kësaj mënyre trajtimi, mund të përthyhej më pak vizioni i së tërës dhe e përgjithshmja të lidhej më tepër me të veçantën. Kapërcime të papregatitura dhe jo gjithmonë të përligjura artistikisht ka në poemën që përmendëm të F. Arapit, ku nganjëherë duket sikur mendimi nuk shprehet deri në fund, po mbetet disi i cunguar.

Gjinia e poemës ecën tani në një rrugë më të mirë. Ajo ka forcuar shtratin e saj epik dhe gërsheton mendimin me ato ngjarje, me atë fabul që kërkon edhe vjersha e sidomos poema, si gjini më e gjatë. Stilet janë të ndryshme, por në krijimet më të mira, ka më shumë se përpara realizëm në koncept më tepër u janë drejtuar poetët fakteve, ngjarjeve, heronjve dhe i kanë përfshirë në pëlhurën e poezisë duke iu shmangur si deskripcionit pa shpirt, ashtu edhe abstragimeve të thata. Ndihet nevoja për gjallërimin e mëtejshëm të poemës, për shumëllojshmërinë e saj. Është e nevojshme, siç ka qenë pohuar disa herë, që poetët e rinj, pasi të kenë krijuar një përvojë të domosdoshme, t'i provojnë forcat më shumë në këtë gjini, e cila kërkon një bosht të përcaktuar, përshtypje më të mëdha nga jeta dhe mjeshtëri të kompozicionit.

\*

\* \*

Vëllimet me vjersha, lirikat e botuara në organe të ndryshme kanë qenë të shumta në këtë periudhë, sidomos nga të rinjtë. Motivet e vjershëve me ton lirik apo epik, kanë qenë të afërme me ato të poemave, po natyrisht, ato kanë pasur edhe veçoritë e tyre. Motive nga

jeta e sotme, nga lufta, çaste nga historia e popullit tonë janë trajtuar në vëllimet apo në poezitë e veçanta të autorëve të ndryshëm. Në më të mirat prej tyre dalin përpara syve tanë figura, çaste nga jeta e gjallë e popullit, tablo të bukura të natyrës, detaje dhe figura të gjetura mirë që na zgjojnë fantazinë. Poezia e të rinjve, me gjithë të metat që ka, është bërë më e qartë dhe më e kuptueshme. Ka përpjekje për të hyrë, me mjetet e poezisë, në psikologjinë e njeriut dhe për ta marrë atë në lidhje me shoqërinë dhe natyrën shqiptare. Në disa krijime vështrimi poetik gjen reflekse të bukura në përshkrime të natyrës, të pyllit e të fushës, të lumenjve të kulluar dhe të qiellit të pastër. Numri i poetëve është shtuar e shtohet. Ata ecin në një unitet brezash, larmi stilesh e mënyrash poetike. Disa nga poetët, që janë kritikuar për qëndrime liberale apo paqartësi vargjesh në krijime të mëparshme si V. Qurku, M. Zeqo etj., kanë dhënë në këtë periudhë lirika me brendi të shëndoshë.

Tema e Luftës Nacionalçlirimtare, krahas temës së sotme, që duhet të zërë më shumë akoma vendin që i takon në lirikën dhe poezinë tonë, është trajtuar dhe trajtohet vazhdimisht. Çdo periudhë sjell motivet e veta nga Lufta, zbulon anë të reja dhe gjen pika të përbashkëta me realitetin e sotëm. Përveç poetëve që e kanë jetuar luftën, edhe më të rinjtë shprehin adhurimin e tyre për atë kohë dhe atje gjejnë frymëzim.

Njëri nga poetët e parë të realizmit socialist, F. Gjata, i cili u hodh pastaj kryesisht në prozë, pikërisht në periudhën e kësaj atmosfere revolucionare, shkroi një varg lirikash kushtuar luftës, sa të thjeshta e konkrete, aq edhe të frymëzuara, në shumicën e rasteve. Poezia e tij e larmishme vjen si një vazhdim i këngëve që ai krijoi gjatë luftës, me atë romantikë dhe lirizëm të lehtë, por, natyrisht, me një vështrim më të gjerë e më realist. Vjershat e tij me tema nga lufta partizane duken si një tregim i lidhur me episode të shumta, të thjeshta në dukje, po kuptimplote, me detaje emocionuese, si një evokim i atyre ditëve të paharruara nga të cilat nxirren



mësimë edhe për sot. Njohja e asaj kohe, zbulimi emocional i saj nga lexuesit e sotëm janë të dobishme dhe të këndshme, sepse zhvillojnë ndjenjën e pastërtisë morale dhe të heroizmit. Në vëllimin «Kënga e maliherit» ka edhe monotoni e vargje tepër të thjeshta që mbeten në kufijtë e një narracioni po në përgjithësi, duke e lexuar, ndjen një kënaqësi estetike, dhe kjo lloj poezie ka plotësuar disa boshllëqe në fushën e lirikës, e cila ka vendin e saj krahas epikës që ka marrë epërsi në këtë periudhë. Fjalët e bukura, evokimi realist i një çasti lirik të luftës dhe, natyrisht, muzika shumë e ndier e A. Mulës bënë që «Tregimi i korrierit» të përhapet aq shumë e të këndohet nga të gjithë me një kënaqësi të veçantë. Konkretësia e detajeve dhe ideja e vjershave më të mira të F. Gjatës, emocioni i fshehur brenda faktit na zgjojnë dashuri për atë kohë dhe për idealin partizan, për komunizmin. Te rrëfimi i partizanit që ka rënë në luftë («Kënga e maliherit») ka diçka romantike, diçka nga baladat tona popullore që sjell me vete një ndjenjë dhemshurie dhe të nxjerr përpara botën e gjerë të partizanit:

Po një natë një plumb seç më mori,  
 S'u gjunjëzova, s'bëra zë.  
 Në maliher, si në shkëmbin prej stralli,  
 Me yll mbet' bota përgjithnjë!

Ka tërhequr vëmendjen e lexuesve një cikël vjershesh, botuar kohët e fundit, të poetit tonë të njohur I. Kadare, i cili prej kohe nuk ishte marrë me poezi, meqë i është kushtuar më shumë romanit. Ai ecën në gjurmët e poezisë së tij të qartë, dramatike, me figura krejt të perceptueshme dhe të papritura, duke e parë ashtu si edhe në poemat që përmendëm, të sotmen dhe historinë së bashku në një vazhdë heroike, duke dhënë një kontribut të ri në poezinë tonë. Midis vjershave të realizuara, ai trajton edhe motive nga politika ndërkomëtare, me një qëndrim të qartë dhe revolucionar. Në

vjershën «Pushtimi i Çekoslovakisë», pasi stigmatizon disfatistët dhe flet për tradhtinë revizioniste, thotë:

Atë natë s'punuan radarët,  
S'qenë radarët.  
Difekt kish ndërgjegja e kombit.  
Praga në pranga, Praga në pranga.  
Antihimni i ri në kllapi gjëmonte.

Jo të gjitha vjershat e ciklit të I. Kadaresë kanë të njëjtën vlerë, por në përgjithësi ato janë shkruar me një varg të ngjeshur, që priret, hera-herës, nga mënyra popullore dhe nga një ritmikë krejt e përcaktuar, pa u larguar nga muzikaliteti i vargut dhe i fjalës.

Më shumë trajtoheshin përpara në poezi motivet ndërkombëtare, megjithëse edhe tani janë shkruar vjersha me këtë temë, ku poetët shprehin qëndrimin e Partisë sonë ndaj këtyre problemeve, urrejtjen ndaj super-ïuqive dhe simpatinë për luftën e popujve. Kështu, kohët e fundit, u shkruan një varg vjershash për çlirimin e Vietnamit dhe të Kamboxhies e janë shkruar edhe më përpara për ngjarje të tjera ndërkombëtare nga Ll. Siliqi etj. K. Kodra, midis vjershave të punuara e të shkruara me një kulturë të vargut, ka shkruar edhe një vjershë «Letër shoqes çeke» ku flet për realitetin e sotëm, për fatin tragjik të këtij populli dhe drejtohet në fund me këto fjalë:

Po zemra jote  
Si i ruan vallë ëndrrat e bukura,  
Me të cilat i ndizje letrat?  
Në se i ke ruajtur,  
Motër e dashur,  
Motër e largët,  
Ktheji në plumba.



Në poema janë rrahur motive ndërkombëtare, lufta kundër imperializmit dhe revizionizmit, të përfshira në problematikën e përgjithshme si të «Nënë Shqipëri» etj., po tradita e formuar e lirikës sonë qytetare me këtë temë është mirë të ruhet dhe të zhvillohet.

Lirikën qytetare, poezinë politike, duke u nisur nga ngjarje dhe problemet e ditës si edhe poezinë me temë shoqërore e kanë trajtuar edhe poetë si A. Gjakova, S. Mato, N. Gjetja, J. Nelaj, R. Marku, Q. Sheme, etj.

Poetët më të rinj kanë ndihmuar për zhvillimin e lirikës, duke trajtuar disa herë tema të rëndësishme dhe duke folur për lidhjen shpirtërore me luftën, me jetën e sotme. Ata kanë treguar si formohet dhe rritet personaliteti i tyre në mes të jetës dhe natyrës shqiptare. Në vjershën e tij «Bjeshkët» poeti i ri A. Mulaj, i cili ka shkruar vjersha të frymëzuara, thotë:

Dhe kam ndier se diçka është formuar tek unë  
Prej fëshfërimës së barit, gjethit e halës së pishës,  
Prej gurgullimës së ujërave, motit të qetë e stuhisë...  
Prej tingullit të lahutës, zërit të rapsodit...

Me një figurë të thjeshtë metaforike, të perceptueshme (ndonëse për organizimin e vargut mund të bëhen vërejtje) S. Buçpapaj na tregon dashurinë për fshatarin në poezinë «U përkundën misrat në kraharorin e mixhës». Dhe këtë njeri e merr të lidhur me kohën, me përparimet e jetës tek ne dhe jo në mënyrë abstrakte:

U përkundën misrat në kraharorin e mixhës  
ditën e inaugurimit të rezervuarit,  
U përkundën misrat kur mixha hapi  
portën e misrat u njomën me ujëra...

Poetët e rinj kanë shtuar përpjekjet për të forcuar përmbajtjen ideore të poezisë së tyre, po duhet ta njohin më mirë e të thellohen më tepër në jetë (kjo detyrë

del para tërë poezisë sonë) që të lidhen më ngushtë me të dhe të zbulojnë anët më të qenësishme të saj. Poeti Xh. Spahiu ka bërë përparime në poezinë e tij, por, si edhe te poetë të tjerë, më tepër duhet të ndihet jeta, materiali i qartë jetësor në krijimet e tij. Ai ka shkruar poezi të ndiera, me brendi të shëndoshë, po herë-herës vuan edhe nga organizimi i vargut dhe konkretizimi i idesë. Të bën përshtypje të mirë, p.sh., poezia e tij «V.F.L:P», ku ai shpreh adhurimin për ditët e luftës dhe njeriun e thjeshtë të popullit:

V.F.L.P.

Katër vetëtima

Sa shkrepnin, ato, ne shtinim

mbi armiqtë nëpër natë...

Në krye të letrës që shkruan fqinji për  
të birin

Nëna s'harroi të shtonte me dorën e saj

V.F.L.P.

P. Kita ka shkruar vjersha prekëse dhe konkrete si, p.sh. «Shitësi i luleve» ku tregon se si në 5 Maj të rinjtë nuk e gjejnë shitësin në dyqan, se ka shkruar të hedhë lule te lapidari dhe të qëndrojnë pastaj i heshtur. Ne kemi nevojë për lloje të ndryshme poezish, edhe për fabula të thjeshta e emocionuese, prapa të cilave fshihet një mendim i rëndësishëm.

Poeti Ll. Ruci, i cili e kërkon frymëzimin dhe është i kujdesshëm në gjetjen e temave, midis të tjerave, i këndon fshatit të tij, që e quan «Zambak i bardhë mbi shkëmb të rreptë» si edhe njerëzve në gjirin e natyrës dhe të pjellorisë së saj:

Fshatari kasketën kthen mënjanë

E diellin e vështron në sy,

Kap një degë portokalli,

Tund një varg limonash,

Dashuria rrjedh si lëng i rubintë,

Begatia skuqet në lëkurë kokrrash.



Disa autorë kapin edhe tema moralo-psikologjike, që vijnë si pasojë e përjetimeve vetiake dhe e vrojtimeve që kanë bërë. Në vjershën «Shqetësim i vonë» K. Petriti bën fjalë për një mësues që e vret ndërgegjija se nuk u kujdes në kohën e duhur për nxënësin që vinte nga larg, me sakrifica, për të ndjekur shkollën:

E kam përpara këtë fytyrë të zgjuar,  
Kam përpara prindërit e tij që s'i njoh.  
Kush nga ne që e mësoi gjer në kullë i pat shkuar,  
Ndërsa firma s'na ka munguar asnjëherë në  
bordero?

Edhe motivet e dashurisë e të natyrës trajtohen nga të rinjtë tani më mirë, në lidhje me kohën dhe me psikologjinë e njeriut të sotëm. Kështu, p.sh., N. Pappleka, midis vjershave të mira, ku ndihet frymëzimi i vetvetishëm, ka shkruar edhe vjershën «Të mendosh» ku bën fjalë për gëzimin e dashurisë:

.. Pasi ke zgjatur tunelin gjigand në  
palcën e malit,  
Për të shkurtuar largësinë mes njerëzve  
dhe së nesërme...  
Të mendosh  
Prapa të gjitha mbrëmjeve  
Fytyrën e dashur...

Kështu mund të silleshin shumë shembuj dhe të kapeshin edhe aspekte të tjera për të treguar se si ka ecur poezia jonë, ç'tema e probleme ka trajtuar. E rëndësishme është që, e frymëzuar dhe e orientuar nga Parita, me pasqyrimin e aspekteve të rëndësishme nga jeta dhe me mendim më të pjekur, ajo ka forcuar dhe pasuruar përmbajtjen e saj. Po, natyrisht, ka ende mungesa si në brendi, në trajtimin e problemeve, ashtu edhe në formë, në konceptimin artistik të poezisë.

Problemi i partishmërisë në letërsi dhe arte u ngrit me forcë të madhe në Plenumin IV, në fjalën e shokut Enver të 20 dhjetorit e është shtruar gjithmonë nga Partia, nga opinioni ynë shoqëror dhe letraro-kritik. Në këtë periudhë poezia shqiptare e realizmit socialist është bërë edhe më e partishme në të gjitha ato drejtime që zumë ngoje dhe me veprat konkret, një pjesë të të cilave i përmendëm. Poezia jonë, në drejtimin e saj kryesor, nuk është pajtuar asnjëherë me teoritë dhe praktikën që nisen nga bota e ngushtë subjektiviste, nga irracionalizmi, të cilat shpien në hermetizëm e, përgjithësisht, në formalizëm. Ato shfaqje të veçanta, që janë kritikuar, natyrisht, nuk kanë qenë të rastit, por nuk preknin tringun e poezisë sonë, që ka milituar gjithmonë për idealet e Partisë. Të jesh i partishëm edhe në poezi, si në tërë gjinitë, do të thotë të jesh i pajisur me botëkuptimin marksist-leninist, me mësimet e Partisë sonë, të kuptosh tendencën e zhvillimit të shoqërisë dhe ta shohësh atë në prizmin e luftës klasore. Kjo të shtyn drejt njohjes së jetës, drejt të kuptuarit të thellë të saj dhe të njeriut; partishmëria të jep frymëzimin prej militanti dhe e bën poezinë të gjallë dhe me gjuhë të kuptueshme e popullore.

Poezia ka bërë një thellim të ndieshëm në zbatimin e këtij parimi, po, ndonëse më rrallë, vihen re ende shfaqje të huaja.

Recidive të shfaqjeve që janë kritikuar vërehen ende edhe në vjersha apo poema që vijnë për botim në redaksitë e organeve të shtypit apo të Shtëpisë Botuese si edhe në vjersha të botuara.

Në vjershat që vijnë për botim, krahas krijimeve të mira e, në shumicën e rasteve me mendime apo synime të shëndosha ka edhe të atilla, që vuajnë nga shfaqje të modernizmit si në përmbajtje ashtu edhe në formë. Shtrembërime të hapura të realitetit ndeshen rrallë, po modernizmi shfaqet më shumë në poezi që nisen nga ndjenja të kufizuara, që vërtiten rreth një bote të ngushtë intime. Ka edhe ndonjë rast kur depër-



tojnë koncepte idealiste. Duke imituar autorë të huaj, ndodh që sillen edhe ide të huaja, të cilat shprehin një botëkuptim individualist apo borgjez. Kjo tregon se ka të rinj ose edhe të moshuar që lexojnë libra të huaja të dëmshme, formaliste, me vargje të shthurura dhe figuracion të çoroditur. Këto, ndonjëherë, merren akoma si modele të artit poetik bashkëkohor dhe harrohet që poezia realiste dhe përparimtare në botë mbështetet te tradita, te mendimi dhe ndjenja e arsyeshme, kundër irracionalizmit, se ajo bën përpjekje të lidhet me realitetin. Është detyra jonë që të luftohen këto ndikime dhe të rinjtë, edhe në këto raste të rralla, të edukohen me frymë revolucionare dhe me letërsi të vërtetë realiste e përparimtare.

Dihet se kur poezia mbytet nga figurat e paqarta apo formaliste, pavarësisht nga qëllimi i mirë fillestar i autorit, forma e shthurur kthehet në përmbajtje dhe, cilido qoftë titulli, poezia mbetet moderniste.

Në këtë periudhë, përveç disa rasteve të veçanta me gabime ideore, dobësitë janë dukur më tepër, së pari, në mungesën e realizmit, në boshllëkun ideor të disa krijimeve poetike, në mendimin e cekët të tyre, në kufizimin tematik dhe në natyrën soditëse e subjektive të disa krijimeve, ku nuk mban erë jetë dhe nuk ndihet sa duhet njeriu i sotëm.

Këto dobësi janë dukur, së dyti, në një prirje drejt vargut pa formë poetike, në një zhdukje të kufirit midis poezisë dhe prozës, që është edhe çështje koncepti, po edhe mungesë aftësie e përgatitjeje. Kjo lidhet gjithashtu dhe me vargjet hermetike apo formaliste të pabotuara që, në shumicën e rasteve shprehin koncepte të caktuara apo recidive të tyre.

Dobësitë janë dukur, së treti, në të kuptuarit e sipërfaqshëm disa herë të parimit të partishmërisë, duke parë më shumë anën e jashtme e deklarative dhe jo rrahjen e vërtetë të pulsit të jetës, pasurinë e temave, të konflikteve, veprimet e panumërta njerëzore, ngjarjet më të rëndësishme të jetës së njeriut, botëkuptimin e tij

të thellë revolucionar. Me kuptimin e thellë të gjithë këtyre anëve lidhet parimi i partishmërisë.

Qëndrime subjektiviste dhe të huaja vihen re në theksimin e tepëruar të unit poetik, në disa raste, jashtë funksionit të tij estetik, ku kalohet në një lloj narcisizmi apo në disa poza, pikërisht kur ndonjë poet e quan të nevojshme të deklarojë se si ai nuk do të mbajë pozë. Vihet re, ndonjëherë, edhe mbeturinë e një erotizmi të sëmurë ose ndonjë bashkëbisedim, vend e pa vend, me të dashurën, që është më tepër një imitim i mënyrave të huaja të rrëfimit poetik. Dihet se poezia ka nevojë për lirikën e shëndoshë të dashurisë, po për ndjenja të vërteta e të thella dhe jo për disa fjalë të sheqerosura dhe për poza dashurore. Në disa raste vihet re një lloj romantizmi i temave historike dhe vëmendje e pamjaftueshme ndaj aktualitetit, që duhet të ketë vendin kryesor në letërsi.

Kuptohet se ka disa arsye që vazhdojnë të shfaqen këto të meta e dobësi. Rrethimi borgjezo-revizionist vazhdon presionin e tij në fushën e ideologjisë dhe të artit dhe lufta jonë me këtë presion vjen duke u ashpërsuar. Tek disa autorë ka ende konfuzion ideoestetik, nuk janë krijuar sa duhet bindje të thella për një poezi të vërtetë realiste dhe me tendencë politike të qartë. Ka raste kur nuk tregohet vëmendje e duhur për lirikën me temë politike, duke i bërë kështu lëshime, dashur pa dashur, pikëpamjeve të rafinuara të apoliticizmit në art. Edhe për punë të formës, të vargut ka raste kur nuk çmohet tradita popullore, sepse kjo duket anakronike, gjë që është luftuar ashpër nga mendimi ynë i partishëm. Ndodh që identifikohet novatorizmi në poezi, me anarshizmin e formës, duke kaluar në një poezi amorfe. Një shkak i rëndësishëm i dobësive është, padyshim, njohja e pamjaftueshme e jetës, përgatitja e cekët ideologjike si edhe niveli i ulët profesional, mungesa e kulturës së vërtetë që shpie në gabime e dobësi.

Një problem i rëndësishëm si për nga koncepti, ashtu edhe për nga mjeshtëria e shkalla e zotërimit të saj,



është, siç thamë, edhe ai i qartësisë së mendimit e të vargut, i ritmikës poetike dhe i organizimit të mendimit poetik. Problemi i qartësisë figurative, i largimit nga alogjizmi dhe nga lidhja arbitrare e shoqërimeve të ideve apo përqasjeve të dukurive, është me rëndësi të madhe ideoestetike e lidhet si me formën ashtu edhe me brendinë. Figura stilistike në poezi është njëkohësisht mishërim i idesë dhe mjet i shprehjes, prandaj ka të bëjë me mënyrën se si e shikon poeti botën, sendet dhe fenomenet. Tek ne ky aspekt është trajtuar gjerësisht dhe nuk do të ishte nevoja të zgjatëshim teorikisht për të sqaruar dëmin e figurave të rënduara dhe të errëta dhe nevojën e dobisë (sipas stileve dhe individualiteteve poetike) të përdorimit me vend, bukuri e qartësi të figurës stilistike. Në krijimtarinë e kësaj periudhe kemi shembuj të goditur figurash të gjetura bukur brenda logjikës poetike, që vijnë si shoqërime të natyrshme idesh.

Por, sidomos te disa poetë të rinj, ndeshim ende në shembuj të një konceptimi figurativ me recidive formaliste. Kjo nuk do të thotë se tërë poezia e këtyre autorëve është e tillë; ata kanë edhe vjersha të mira e, përgjithësisht, zotëron tek ata qëllimi i mirë dhe fryma e shëndoshë ideore. Ndonjëri është vetëm debutant dhe duhet ta shohë veten me sy kritik që në fillim, që të ecë më mirë këtej e tutje.

Lufta që bën Partia dhe gjithë populli kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, ashpërsimi i konflikteve klasore në rrethanat e krizës së botës kapitaliste dhe revizioniste, të degjenerimit të saj më të thellë shtron përpara poezisë sonë detyrën e forcimit të partisshmërisë proletare. Lufta e klasave, mbrojtja e idealit të Partisë, fshikullimi i çdo shfaqjeje që pengon socializmin, shfaqjet liberale dhe konservatore, burokratizmi, si një shëmtim social, që sjell shumë të këqia, përgjithësisht tema politike dhe shoqërore duhet të zënë një vend më të madh në poezinë tonë.

Problemi i realizmit, i së vërtetës jetësore është i

lidhur me partishmërinë. Jeta njihet me kritere dhe botëkuptim të caktuar, se ndryshe mund të humbasësh midis fakteve e ngjarjeve dhe të mos orientohesh drejt. Po, natyrisht, edhe vetëm idetë e mira dhe të shëndosha nuk mjaftojnë, sikundër nuk mjafton vetëm fantazia për një art realist.

Prandaj shoku Enver thotë për disa poetë të rinj «se kanë shumë ide, por mënyra se si i shprehin ato nuk është gjithmonë reale, jetësore».

Kuptohet se mënyrat e të shkruarit janë të ndryshme: dikush është më i përgjithshëm, dikush priret nga detaji; njeri mund të bëjë një rrëfim të bukur poetik, tjetri të pohojë me forcë të figurshme mendimin e të tjera forma të njohura. Por realizmi si koncept është i domosdoshëm për të gjithë, doemos, i shprehur me gjuhën e poezisë. Shkruhet, p.sh., për fshatin, për bjeshkët, për poezinë, për minierën, kantierin, luftën etj. dhe shpesh vështrimi mbetet i përgjithshëm, poeti zbulon më shumë veten e tij, gjë që mund ta bënte dhe në tema të tjera. Zbulimi i vetvetes në lirikë është një veçori e kësaj gjinie, po lirika jonë i zgjeron kufijtë e pasqyrimin; në ndërgjegjen e poetit lirik hyn e duhet të hyjë më shumë bota jonë socialiste. Kuptohet se edhe një numërim detajesh apo soditje e ftohtë e fakteve nuk do të kënaqte njeri.

Realizmi në poezi do të kërkonte të depërtohej më thellë në jetë, në botën e njeriut, në gëzimet dhe dramën e jetës në konfliktet e saj, gjë që do ta bënte poezinë edhe më revolucionare dhe më militante.

Temat e mëdha sociale, si tema e klasës punëtore, e luftës kundër burokratizmit, jeta dhe puna e fshatit, e përshkruar me realizëm e problemet moralo-filozofike duhet të kenë një vend më të madh në poezinë tonë për t'iu përgjigjur hap pas hapi realitetit. Trajtimi i këtyre temave do të luftojë uniformitetin dhe do të sjellë më shumë freski në poezi.

Është e nevojshme që poezia jonë të shtrijë edhe më shumë e më mirë prirjen e saj jetësore, të zgjerojë



sferën tematike e të futet edhe më thellë në temat e mëdha, duke hyrë në shfaqjet konkrete të tyre, që janë të panumërta dhe jo të mbetet në pohime të përgjithshme. Duke folur për njohjen e thellë të jetës dhe paqyrimin e shumanshëm të saj, shoku Enver, në fjalën e 20 Dhjetorit thotë: «Nëse gjejmë që poezitë e Dritëro Agollit janë të mira, arsyeja është se ato shprehin ndjenjat e pastra të popullit, janë të lidhura me realitetin, me njerëzit e punës, me baltën, me prodhimet e lulet e kësaj toke, me oxhaqet e mëdha të kombinateve dhe me hallet e gëzimet e njerëzve në vatrat e tyre familjare». Poezisë, pra, i duhen problemet e mëdha, njerëzit e punës, gëzimet dhe vështirësitë e jetës, fryma optimiste, po jo të shikuarit e sipërfaqshëm, i duhen lulet dhe jeta familjare, i duhet epika, lirika dhe dramati e realitetit.

Në parashtrimin e disa problemeve ideore dhe artistike të poezisë në këtë periudhë vetvetiu dolën edhe probleme të mjeshtërisë. Këtu do të donim të vinim theksin në ndonjë problem të mprehtë që duhet rrahur e zgjidhur.

Kohët e fundit, nëpër plenumet e në shtyp është folur veçanërisht për çështje të mjeshtërisë, lidhur me përmbajtjen. D. Agolli, p.sh., ka shtruar problemin se mjaft poetë, sidomos të rinj, kanë pak mendim, në disa krijime të tyre vërehet informacion me figura dhe mungon sinteza, se është i domosdoshëm ai pak tregim apo ajo fabulë që i jep gjallëri poezisë. Ai ka folur gjithashtu edhe për një lloj «mekanizmi poetik» iku disa poetë mundohen të fusin jetën si dhe për mungesën e disiplinës së vargut. F. Arapi, duke diskutuar për tre poetë të rinj, ka folur për domosdoshmërinë e trajtimit të temës së klasës punëtore. Duke vlerësuar krijimtarinë realiste dhe demokratike të poetëve si Uitman, Lorca, etj, ai me të drejtë ka tërhequr vëmendjen se nuk duhen imituar mekanikisht këta poetë me vargun e tyre, të lindur në ambiente të tjera dhe me një fantazi origjinale për ta,

se ndryshe lind inflacioni i fjalës. Kështu kanë shkruar e folur edhe poetë e shkrimtarë të tjerë si Ll. Siliqi, I. Kadare, M. Xhaxhiu për një seriozitet më të madh në trajtimin e vargut, të strofës, për një pasurim ritmik të poezisë. Në disa raste është theksuar, me të drejtë, se kritika e poezisë është e dobët, se ajo nuk ka zbuluar si duhet veçorinë e kësaj gjinie dhe është shumë prapa trajtimit të problemeve të mëdha që shtron sot krijimtaria poetike. Studimet e artikujt që kanë bërë R. Brahim, A. Kallulli etj., për poezinë janë me vlerë, po kanë mbetur të pakta. Është e nevojshme të zgjerohet numri i kritikëve, të nxiten edhe të rinj dhe të ndiqet më mirë procesi i poezisë.

Problemi i parë që deshëm të trajtojmë është ai i vargut dhe i ritmikës poetike, i cili ka shqetësuar, krahas të tjerave, edhe opinionin tonë letrar kohët e fundit.

Në këtë periudhë vargu i poezisë sonë, në përgjithësi, është pasuruar. Përdoret më shumë edhe vargu klasik i shumëllojshëm, vargu popullor me ndryshimet dhe thekset origjinale që sjell koha dhe zhvillimi i mendimit. Përveç vargut klasik të evoluar e të shumëngjyrshëm, që përdoret nga mjaft poetë, kanë lindur edhe vargje të reja, një kombinim i harmonishëm i vargut klasik me diçka më të lirë, të çliruar nga disa rregulla, gjë që lejon, sipas temës dhe natyrës së frymëzimit, një elasticitet në përdorimin e vargut. Edhe ky varg i përdorur, p.sh., në disa raste nga D. Agolli, Ll. Siliqi, I. Kadare, K. Petriti, A. Gjakova etj. ka një traditë të qartë dhe mbështetet shpesh tek thekset tonike, të cilat lindin nga logjika e fjalës dhe e ndjenjës dhe përsëriten herë pas here, duke krijuar kështu një muzikalitet të qartë. Këto lloj vargjesh, si rregull, kanë edhe rimë, disa herë të papritur, që krijon emocione të veçanta. Me sukset është përdorur edhe vargu i matur si nga disa prej këtyre që përmendëm, ashtu edhe tek të tjerë. Ka autorë që përdorin një varg edhe më të lirë, por kanë gjithashtu brenda poezisë së tyre një rregullsi



sado individuale, një lloj sintaksi poetik. Disa preferojnë rimën dhe kjo e shton energjinë e vargut. Të tjerë nuk e përdorin rimën. Por, poezia mbetet si e tillë dhe nuk mund ta ngatërrosh me prozën. Kurse ka mjaft poetë të tjerë që nuk i përmbahen gjithnjë ndonjë rregullsie sado të lirë. Këta janë më shumë poetë të rinj që imitojnë ose njëri-tjetrin, ose poetë të huaj dhe shpesh shkruajnë pa ndonjë kriter të caktuar të vargëzimit. Disa, si duket, nisen nga bindje të tilla, sepse janë në gjendje ta përdorin edhe vargun e rregullt (kanë ndonjë shembull të tillë), kurse disa e quajnë më të lehtë ose nuk e zotërojnë artin poetik. Ka, natyrisht, edhe nga ata që përdorin varg krejt të rregullt dhe bien në monotoni, në një poezi pa shpirt.

Qëndrimi ynë ndaj vargut dhe ritmikës është shprehur disa herë. Ne jemi për vargje të shumëllojshme, natyrisht, edhe për vargun e lirë, po nuk mund të pajtohemi me zhdukjen e kufirit midis prozës e poezisë, me largimin nga ritmika dhe muzikaliteti i fjalës. Dihet se poezia është një shprehje më e ngjeshur e mendimit dhe e emocionit, në krahasim me prozën dhe se, në unitetin e mendimit dhe të ndjenjës, në poezi ndjenja duhet të jetë e dukshme dhe më e drejtpërdrejtë. Prandaj ndjenja, qëndrimi emocional sjell edhe ritmin, muzikën. Mundësitë e shprehjes së tyre zgjerohen, bëhen më të mëdha, po kurrsesi nuk shuhen. Vetëm estetika formaliste predikon në disa raste edhe në rryma të caktuara një shuarje të tillë, sepse niset nga arti pa qëllim, për një pakicë të privilegjuar, nga pështjellimi dhe shturja e brendshme e njeriut që sjell edhe pështjellimin dhe shturjen e vargut. Ne nuk kemi të bëjmë me raste të tilla, po mendojmë se sidoqoftë, mungesa e organizimit dhe natyra amorfe e shumë vjershave të të rinjve kanë në bazë koncepte të caktuara, krijojnë një uniformitet që e varfëron poezinë dhe shpjen drejt formalizmit, drejt largimit nga tradita.

Është e kuptueshme se nuk mund të vihen kufij të prerë dhe të jepen receta vargjesh. Ne nuk jemi për një

estetikë *ala Bualo* me rregulla të rrepta e të dhëna njëherë e përgjithnjë. Bukuria e poezisë qëndron edhe në pasurinë dhe larinë e vargut, në zgjidhjet e papritura dhe origjinale të shprehjes poetike. Po këtu e kemi fjalën për një prirje të gabuar, për një uniformitet të dukshëm që vihet re tek mjaft poetë të rinj. Kur lexon vargje të tilla, të ikën kënaqësia e poezisë, mund t'i kthesh fare lehtë në një prozë të rëndomtë. Mënyrat poetike tek ne janë pasuruar e do të pasurohen, po çdo komb, duke marrë edhe nga përvoja botërore, ruan fizionominë e vet të formës, që lidhet edhe me veçoritë e gjuhës, të tingullit të fjalës, të muzikalitetit të saj të papërsëritshëm. Uitmeni tingëllon mirë, i vendosur në atë terren ku lindi, në atë kohë dhe me atë frymëzim të vetin. Ndonjë poet, me simbolikën e vendit të tij, nuk mund të përsëritet gjatë. Poetët e Amerikës Latine kanë gjithashtu një romantikë të tyre, që lidhet edhe me folklorin e atyre vendeve. Sistemi figurativ i tyre nuk mund të vendoset mekanikisht në një truall tjetër. Ne marrim shembuj nga folklori ynë dhe nga tradita e poezisë shqiptare, nga vargu dhe figuracioni i saj, natyrisht, duke i shpurë edhe më përpara.

Shumë pak, ose aspak ndihet në vargje të mjaft poetëve të rinj tradita e vargut të Naimit, De Radës, (i cili mund të kuptohet e kapet mirë tani në përshtatjet me vlera poetike të A. Varfit). Fan Nolit, Çajupit, Mjedës (mjeshtër dhe skalitës i njohur i vargut), Migjenit etj. Më shumë duhet të ndihet edhe tradita e re e realizmit socialist dhe vargu popullor. Sa mirë tingëllojnë disa vjersha të rinjsh si A. Isaku, Q. Shemaj, Z. Puci etj., ku ndihet ndikimi pozitiv i vargut popullor, i përdorur në mënyrë krijuese! Dihet se poezia e një vendi mund të bëjë të vetin edhe një varg të përdorur gjerësisht gjatë. Kjo është e kuptueshme. P.sh., përveç 8-rrokëshit, 10-rrokëshit, e 6-rrokëshit etj., tek ne është përdorur shpesh edhe 11-rrokëshi, që nuk ka pasur traditë, po ai ka hyrë organikisht, ka marrë ngjyrën kombëtare. Kështu ka ndodhur e mund të ndodhë edhe me vargje të llojeve të



tjera. Tradita kombëtare duhet kuptuar drejt e thellë, por jo në mënyrë arkaike. Sot ka disa poetë që përdorin me sukses 8-rrokëshin në variantet e tij të shumta. Në zgjedhjen e fjalëve, të theksit, të rimave poetët futin diçka të vetën. Në disa raste 8-rrokëshi duket i përtëritur dhe merr një ngjyrim të ri.

Por e keqja është kur nuk njihet mirë e nuk studihet tradita e keqkuptohet edhe tradita botërore përparimtare.

\*  
\*   \*  
\*

Në këtë periudhë poezia ka ecur në rrugën e përparimit të mëtejshëm, ka forcuar përmbajtjen e saj revolucionare, është bërë më militante dhe ka përçarur te masat ide të rëndësishme dhe frymëzuese.

Duke luftuar kundër ndikimeve të huaja që kanë mundur të depërtojnë, poezia jonë, në këtë periudhë, në vijat e saj kryesore, ka shmangur ato shfaqje të hermetizmit e formalizmit që u kritikuan në Plenumin e IV. Por edhe krijimtaria e kësaj periudhe tregon se, krahas përparimeve të dukshme, ka recidive të ndikimeve të huaja si edhe koncepte që nuk pajtohen me frymën e përgjithshme të poezisë sonë. Kjo duket si në përmbajtje, ashtu edhe në formë. Partia na mëson të mprehim kurdoherë vigjilencën, sepse lufta e klasave ashpërsohet dhe s'mund të jemi të imunizuar nga gabimet.

Partia shtron para poetëve si para gjithë shkrimtarëve dhe artistëve, domosdoshmërinë e njohjes së thellë të jetës të njeriut të sotëm. Kjo do ta pasurojë poezinë, do të bëjë që të trajtohen më mirë e më gjerë temat e mëdha të realitetit tonë, të pasqyrohet puna dhe socializmi, duke vënë në qendër njeriun punonjës në lidhje të ngushtë me ambientin, por pa mbetur në përshkrimet e jashtme të objekteve dhe në një numërim detajesh. Jeta duhet njohur me tendencë, me një qëllim të cak-

tuar. Pasqyrimi më i gjerë i fakteve jetësore, të interpretuara nga mendimi i thellë filozofik, përmes poezisë së vërtetë, do ta forcojë edhe më tepër përmbajtjen e poezisë dhe do të sjellë larmi motivesh dhe formash. Duke folur për njohjen e jetës nga gjithë shkrimtarët e artistët dhe sidomos nga të rinjtë, shoku Enver, në fjalën e 20 Dhjetorit 1974, thotë «T'i mësojmë letrarët dhe artistët e rinj si ta lexojnë librin e hapur të jetës socialiste të vendit tonë, si ta studiojnë dhe si ta kuptojnë brendinë e këtij libri të mrekullueshëm».

Plenumi IV, orientimet që ka dhënë Partia në këtë periudhë, fjala e shokut Enver në Sekretariat më 20 Dhjetor 1974, jeta që ecën çdo ditë i kanë hapur horizonte të reja poezisë sonë, këtij arti të shkathët dhe dinamik, arti të zjarrtë dhe të dashur për lexuesit. Qartësia e detyrës dhe vetëdija për këto probleme i bëjnë poetët tanë dhe mendimin letraro-kritik edhe më vigjilentë e më kërkues. Janë mijëra lexues që ndjekin me vëmendje e dashuri krijimet e poetëve tanë. Në kundërshtim me poezinë dekadente e revizioniste, me poezinë e sëmurë, mikroborgjeze e të zhytur në vetvete, me poezinë e përçartjeve dhe të ethes së individit të deziluzionuar dhe të çoroditur, arti ynë poetik ngrihet si një flamur i revolucionit, duke i kënduar me gjithë zemër popullit, Partisë dhe ideve të komunizmit.

1975



## MBI PASQYRIMIN E MASAVE DHE TË INDIVIDIT NË ROMANIN TONË

Pasqyrimi i popullit në letërsi dhe, veçanërisht në romanin tonë të realizmit socialist, përbën një problem themelor që lidhet me botëkuptimin marksist-leninist, i cili qëndron në bazë të metodës sonë krijuese si edhe me ndryshimin e madh shoqëror, qëkurse masat punonjëse, me Partinë e tyre në krye, bënë revolucionin dhe fituan të drejtat shekullore që u takonin.

Problemi i vendit që duhet të zërë populli dhe njeriu i thjeshtë në letërsi është shtruar shpeshherë në historinë e zhvillimit të letërsisë botërore. Demokratizimi i romanit është një proces që ka ardhur duke u theksuar. Revolucionet demokratiko-borgjeze idetë e iluminizmit dhe të progresit shoqëror kanë luajtur rol që edhe në letërsi të dalë më qartë dhe më konkretisht se në periudha të mëparshme historike problemi i rolit që luan populli dhe individi në histori. Por lëvizja popullore edhe në veprat më demokratike të realizmit kritik apo të romantizmit përparimtar nuk është parë sipas një filozofie materialiste konsekuente. Edhe në vepra ku jepen tablo të gjera, me vlerë të madhe historike dhe artistike, romani realist zbulonte të vërtetën shoqërore, po shkaqet e lëvizjes së masave i shihte shpesh nga një kënd idealist dhe nuk i qëndronte gjer në fund

pikëpamjes se janë ato që e bëjnë historinë. Për të kuptuar se raporti i masave dhe i individit nuk shihej në thellësinë e duhur materialiste mjafton të vërejmë tipat pozitivë që ishin në qendër të shumë romaneve të shkruara sipas metodës së realizmit kritik, të cilët rrallë mund të jenë nga gjiri i masave. Kjo lidhet me etapat historike dhe me konceptin e shkrimtarëve, i cili ka gjithashtu kushtëzimin e vet historiko-shoqëror. Letërsia e realizmit socialist, romani që nisi të krijohet sipas parimeve të kësaj metode e që vazhdon të thellohet në ditët tona, atje ku ka besnikëri ndaj tyre, për herë të parë në historinë e letërsisë e trajton problemin e popullit me një thellësi materialiste, sipas botëkuptimit marksist-leninist. Me artin proletar filloi një etapë e re e letërsisë dhe e artit revolucionar botëror. Populli është krijuesi i vërtetë i historisë, heronjtë pozitivë merren nga gjiri i tij dhe janë bartës të idealeve revolucionare. Kjo kthesë historike në art u ndie me lëvizjet revolucionare të proletariatit dhe ka përfaqësuesit e vet të shquar si Gorki, Rolani etj.

Ideja e popullit dhe e tipave pozitivë të dalë nga masat punonjëse sot, në realitet, është përdhosur nga individualizmi borgjez i revizionistëve sovjetikë etj, të cilët, pavarësisht nga demagogjia, përputhen plotësisht me modernistët në këtë pikëpamje. Ideja e përbuzjes së masës, e tjetërsimit të individit, që shpesh paraqitet me jetën e tij të mbyllur, të izoluar nga populli, vendoset në qendër të veprave të sotme borgjeze dhe revizioniste.

Romani i sotëm shqiptar mbështetet në traditat më të mira demokratike dhe humaniste botërore, në traditat revolucionare të romanit të realizmit socialist, duke sjellë një përparim të dukshëm dhe një kthesë cilësore në trajtimin e jetës së popullit dhe të individit, të raporteve të tyre në shoqëri. Romancierët tanë japin kontributin e tyre edhe në kulturën përparimtare revolucionare botërore, kontribut që do të zërë historikisht vendin e tij të merituar.

Realiteti i transformuar, mësimet e Partisë dhe të



shokut Enver mbi vendin e masave në histori, pra jeta dhe udhëheqja marksiste-leniniste e letërsisë sonë përcaktuan edhe zgjidhjen e drejtë të këtij problemi në romanin tonë, i cili eci dhe po ecën në etapa të zhvillimit dhe të pjekurisë.

Duke ndjekur parimin realist dhe të perspektivës historike, romani shqiptar i pasqyrimin u largua nga qëndrimet idealiste ndaj masave, nga konceptimi i përgjithshëm dhe amorf i tyre, nga konceptimi utopik, lidhur me rolin e individit në histori dhe nga zgjidhjet sentimentale në pasqyrimin e raporteve të njeriut me shoqërinë. Kjo, natyrisht, nuk u bë menjëherë me thellësinë e duhur dhe me pjekurinë artistike, po në koncept u duk një kthesë rrënjësore që vjen e thellohet. Që nga romanet e para si «Çlirimtarët» i Dh. Shuteriqit e «Ata nuk ishin vetëm» i S. Spasses, të «Kënetat» i F. Gjatës, «Një vjeshtë me stuhi» i A. Abdihoxhës, më vonë me «Para agimit» të Sh. Musarajt, «Lumi i vdekur» i J. Xoxes, «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» i I. Kadaresë, «Komisari Memo» i D. Agollit, «Përsëri në këmbë» i Dh. Xhuvanit etj si edhe në romanet e ditëve tona, mendimi revolucionar popullor spikat qartë: në qendër të veprave vihet populli, i ngritur në luftë apo në ndërtimin e vendit, me zigzaget e tij historike, me thellësinë e ndjenjës popullore dhe filozofinë e tij që buron nga jeta.

Edhe në veprat e viteve të fundit si «Zgjimi» i S. Spasses, «Skënderbeu» i S. Godos, «Përballimi» i T. Laços, «Njeriu me top» i D. Agollit, «Duel i madh» i A. Abdihoxhës, «Shembja e idhujve» e S. Drinit, «Mars» i V. Koreshit etj., shtrohet problemi i heroit, pjellë e kohës, dhe e raportit të tij me masën.

Duke ngritur, shkurtimisht, disa nga problemet kryesore që dalin nga kjo temë, është e nevojshme të ritheksohet një e vërtetë e njohur teorike që ka të bëjë me veçoritë e artit dhe të romanit realist. Kur themi se masat punonjëse janë vënë dhe duhet të vihen edhe më shumë në qendër të veprës letrare, natyrisht, kuptoj-

më gjuhën e artit, domosdoshmërinë e figurës artistike përmes së cilës realizohet ideja. Romani ngrihet mbi një subjekt të caktuar, me disa karaktere dhe me marrëdhëniet e tyre. Kur kemi në një roman një hero ose disa tipa të dalë nga populli ne mund të themi me bindje (kur vepra është e realizuar) se pasqyrohet jeta e popullit në një periudhë të caktuar historike. Pasqyrimi i popullit, i masave është interpretuar ndonjëherë edhe në mënyrë moderniste apo edhe vulgare, duke mbrojtur në fakt pikëpamjen e largimit të njeriut nga sfera e romanit me zgjidhjen pllakateske të problemit, me rendjen pas ngjarjes dhe ilustrimeve të thjeshta të historisë. Symbolistët, konstruktivistët dhe futuristët e quanin të vjetëruar paraqitjen e njeriut në art dhe niseshin nga koncepte subjektiviste, në emër gjoja të novatorizmit. Pikëpamje të dëmshme dhe vulgare kritikuan edhe ne lidhur me diskutimin mbi heroin pozitiv të 1971-shit ku dolën lloj-lloj termash, kur heroi identifikohet me gjithçka dhe kur thuhej se masa sapo kishte filluar të dilte në romanin tonë etj.

Romani i realizmit socialist, në koncept, në botëkuptim ka një vështrim novator ndaj shoqërisë dhe një nga aspektet kryesore të kësaj është pasqyrimi i drejtë i raporteve të individit me shoqërinë. Tani në qendër vihet njeriu si genie shoqërore, transformuese, që nuk vepron i izoluar, po përkundrazi në lidhje të ngushta me shoqërinë. Qëndrimi i drejtë ndaj problemit të masave shpie dhe në pasqyrimin e skenave masive, të harmonizuara me fatet e heronjve. Lenini, i cili theksonte veçoritë e artit dhe thoshte se këtu gjithë puna është tek e veçanta, tek individualja, i jepte rëndësi të madhe pasqyrimin të drejtpërdrejtë të masave në veprat artistike. Lenini thoshte se skenat masive duhet të shtohen në artin e ri, të ndihet prania e popullit edhe në kuptimin e mirëfilltë të kësaj fjale: populli të dalë si masë e vërtetë, i vrullshëm dhe i thellë. Me sa më shumë ngjyra të jetë përshkrimi i këtyre skenave aq më e gjallë dhe më e vërtetë do të dalë vepra me synim



të tillë dhe e ndërtuar në këtë mënyrë. Por kuptohet vetiu se jo çdo roman duhet të ketë një zgjidhje të tillë, se interpretimi i drejtë i popullit, i heroit, varet nga qëndrimi i shkrimtarit dhe nga zgjidhja konkrete e problemit dhe e idesë që shtrohet në vepër. Ne kemi vepra me prirje drejt epopesë, apo me elemente të saj dhe atëherë fati i popullit, me përfaqësuesit e vet konkretë, vihet në qendër të veprës, skenat masive zënë në të një vend të dukshëm.

Por kemi ndeshur edhe raste, sidomos në ndonjë dramë, kur masa, si të thuash, çindividualizohet, del vetëm si shprehje e një mendimi abstrakt, si altoparant e një ideje, e cila për fat të keq shpesh, edhe si ide, është mjaft e cekët.

Këtu pra, problemi duhet parë në veçoritë e artit; kryesorja qëndron te vështrimi filozofik i shoqërisë, i popullit dhe i individit, kurse temat, problemet, aspektet janë të shumëllojta dhe kërkojnë shprehjet e tyre artistike.

Romani ynë ka shënuar arritje të ndjeshme në pasqyrimin e masave të popullit, të shpirtit të tyre kryengritës, ka trajtuar drejt forcën krijuese të punës, qëndrimet klasore dhe perspektivën historike të zhvillimit shoqëror. Jeta e popullit ka qenë dhe është burimi kryesor i frymëzimit për shkrimtarët tanë. Partia dhe shoku Enver, i kanë orientuar gjithmonë ata drejt jetës, drejt popullit. Edhe në fjalën e 20 Dhjetorit 1974 shoku Enver i dha një rëndësi shumë të madhe këtij problemi. Ai theksoi në mënyrë të veçantë njohjen reale dhe jo fantastike të jetës së popullit, «kthesat e zigzaget që bën populli për të arritur ato qëllime që i vë Partia...». Për ta zbërthyer këtë jetë në zhvillimin e saj dialektik, shoku Enver orienton drejt vështrimit realist, revolucionar, sipas botëkuptimit materialist të ngjarjeve dhe të historisë, «plot me ndjenja optimiste për një ndryshim dhe zhvillim të mëtejshëm pozitiv të historisë e të zhvillimit të shoqërisë, të një shoqërie pa klasa».

Vështrimi realist, revolucionar i jetës së popullit ka ardhur duke u mprehur në romanin tonë në luftë me subjektivizmin dhe skematizmin, me përshkrimin që nuk ngjeshet sa duhet me mendimin filozofik apo me mungesën e materialit të ndjeshëm jetësor, me mungesën e fakteve të gjalla, që mund të qëmtohen vetëm pas një soditjeje aktive të jetës.

Në disa nga romanet tona më të mira fati i popullit del në shesh me baticat e zbaticat e veta, me rrjedhën e përgjithshme të ngjarjeve duke pasqyruar me realizëm raportet e klasave dhe të shtresave të ndryshme shoqërore. Diku marrëdhëniet ekonomike vihen në qendër dhe bëhen përcaktuese për lëvizjen e karaktereve dhe të ngjarjeve («Lumi i vdekur»), diku tjetër qëndrimi ndaj luftës, problemi politik dhe moral, patosi patriotik është guri i provës për të njohur dhe përcaktuar karakteret («Para agimit», «Komisari Memo») ose kjo arrihet me qëndrimin ndaj punës, ndaj armikut të klasës («Kënetë»), me pasqyrimin e luftës së popullit kundër revizionizmit («Zbulimi»).

Vepra e mirë letrare, pra edhe romani i mirë, i kushton vëmendje si heroit apo heronjve kryesorë, ashtu edhe pikturimeve masive si edhe figurave episodike, atyre që, në tërësinë e tyre, përbëjnë masën e njerëzve. Këta mund të jepen edhe me «biografite» e tyre të shkurtëra, edhe përmes çasteve kulmore të jetës së tyre, apo ngjarjesh që lënë gjurmë të lexuesi. Në gjirin e këtyre njerëzve të gjallë, me jetën e tyre reale, edhe personazhi qëndror merr gjallëri dhe gdhendet më mirë. Kështu p.sh. në romanin «Para agimit» të Sh. Musarajt, që është si një histori artistike e periudhës së luftës, me pamje të shumta të pjesëmarrjes së masave në luftë dhe me debate politike, në të cilat ndeshet mendimi revolucionar e popullor me mendimin reaksionar, intelektualist borgjez, ka një gërshetim të harmonishëm të fatit të heroit Qemal Orhanaj, me fatin e njerëzve të popullit dhe të militantëve të Partisë. Kështu jepen lidhjet organike të tij me përfaqësues të ve-



gjëlisë si me Nekije Talon, Demkën, «Filozofin», si edhe me Albertin, Hysejnin, Artën, shokë komunistë që veprojnë bashkë me të. Një pjesë e mirë e personazheve të mbeten në mend se janë të gjallë dhe jetësorë.

Duke përshkruar Nekije Talon, autori tipizon figurën e gruas shqiptare të vuajtur, të shfrytëzuar dhe të rilindur shpirtërisht nën ndikimin e ideve të revolucionit. Në qoftë se kjo vepër, me përmasa të gjera do të kishte një pasqyrim dhe depërtim më të thellë në aspektet shoqërore të jetës, krahas atyre politike dhe do të shquhej për një përqëndrim më të madh e më dramatik (sidomos në pjesën e dytë, siç është pohuar në studimet tona), vlera e saj do të qe edhe më e dukshme. Për romanet tona shtrohet problemi i një pasqyrimi të shumanshëm të jetës së popullit në etapa të ndryshme historike, duke iu përmbajtur gjithmonë temës qëndrore, por duke e marrë njeriun si «një tërësi shoqërore». Kjo arrihet me një thurje organike të aspektit historik me jetën konkrete, të gjallë të njeriut, me hallet dhe përpjekjet e tij të përditshme, krahas ngjarjeve të rëndësishme, me dramën dhe tragjeditë në të kaluarën, por, kur vepra trajton temën e sotme, edhe me pasqyrimin realist të kontradiktave aktuale dhe të rrugëve të zgjidhjes së tyre. Siç dihet një vepër, zakonisht, nuk mund të ngrejë më shumë se një problem të rëndësishëm. Por cilido qoftë aspekti apo problemi i një vepre — historik, politik, social apo moral, — e rëndësishme është që tipat të jenë konkretë e jetësorë, që autorët t'u largohen skemave dhe të ruajnë kurdoherë ngjyrat kombëtare brenda realizmit dhe motivimit historik-social të veprimit të masës dhe të individit. Një harmonizim i vërtetë dhe i thellë i përshkrimit të ngjarjeve të rëndësishme në historinë e kombit, me pikturimin e karaktereve e të fateve të tyre shoqërore dhe vetiake do të na shpinte në realizimin e veprave me përmasa të gjera në formën e epopesë, që do të përgjithësonin periudha dhe epoka të historisë sonë. Letërsia

ka nevojë si për romane me një veprim të përqëndruar dhe me zbulimin e një aspekti kryesor të jetës, ashtu edhe për romane me paraqitje më të plota dhe të shumanshme të realitetit. Praktika letrare e deritanishme tregon se suksesin nuk e përcakton lloji i romanit, por vërtetësia, forca e mendimit dhe mjeshtëria artistike që është përdorur në të.

Romancierët tanë, duke ecur në traditat më të mira të veprave të krijuara, bëjnë përpjekje për t'u thelluar në pasqyrimin e masës, për ta dhënë atë përmes tablosh realiste, pa idealizime subjektive. Kështu, ndër veprat e viteve të fundit, spikat në këtë vështrim romani «Përballimi» i T. Laços. Në këtë vepër krijohen figura komunistësh, si e Martin Krekës dhe e Miti Vozarit dhe këto figura vihen në kushte reale, në marrëdhënie me njerëz të popullit dhe me përfaqësues klasash reaksionare. Për problemin që u shtrua edhe më lart, është e rëndësishme të thuhet se edhe këtu figurat episodike, në përgjithësi, përshkruhen mirë, kanë botën e tyre dhe qëndrimet nuk jepen në mënyrë statike, të pandryshueshme. Janë të gjalla figura pozitive si e Tares, që priste partizanët gjatë luftës, figura e Atmirit, e një të riu energjik dhe gjer në fund të ndërgjegjshëm në punën e tij, ajo e Nezirit që vetëm kur çleu detyrimet plotësisht, thirri në shtëpi shokun e tij të luftës, Miti Vozarin. Në botën e sinqertë dhe të thjeshtë të njerëzve të popullit ka diçka të bukur dhe prekëse. Edhe gabimet ku bien disa përkohësisht jepen përmes një dramatizmi real që zgjon interes të lexuesi. Por ky mund të ishte më i përqëndruar dhe më i thellë, duke i parë njerëzit jo vetëm në marrëdhëniet e tyre ndaj grumbullimit, por më tepër me jetën shoqërore të tyre; lufta e klasave, që jepet mirë në këtë vepër, mund të kishte shprehje më dramatike, me një ngarkesë më të madhe të mendimit politik.

Raporti i individit me masën, jo vetëm në planin e udhëheqësit që drejton dhe mobilizon njerëzit, por të përfaqësuesit të shtresave të popullit që ndikohet nga



kolektivi, nga shokë komunistë, nga rrjedha e ngjarjeve, jepet në disa nga romanet tona me tema dhe problematikë të ndryshme. Kështu, kjo vërehet te romani «Përsëri në këmbë» i Dh. Xhuvanit, ku heroi ndikohet nga kolektivi për të mos mbetur në ndjenjën e zymtë që i zgjon fatkeqësia e rëndë fizike dhe në anë tjetër, me qëndrimin e tij, duke mohuar fatkeqësinë, vështirësitë, ai bëhet edhe shembull për të tjerët. Ky ndikim reciprok midis masës dhe individit është një interpretim dialektik dhe mund të zhvillohet edhe më tej në romanin tonë.

Lidhur me këtë problem, në një pamje tjetër, do të vlen të shembull romani «Njeriu me top» i D. Agollit, i cili merr një njeri nga populli, tregon lidhjet e tij politike me luftën dhe Partinë, por edhe se si bart në vetvete tragjizmin e disa shtresave që nuk delnin dot lehtë nga pështjellimet shpirtërore, të cilat vinin si rrjedhim i pasioneve të sëmura, shprehje e zakoneve patriarkale. Në ndërgjegjen e Mato Grudës, personazhit kryesor të romanit, veprojnë forcat e reja revolucionare dhe forcat e traditës konservatore që duan ta mbajnë në vend. Kjo nuk është një luftë e lehtë, por e vështirë e me dhimbje, plot ndjenja për të afërmit e humbur si pasojë e zakonit të egër të hakmarrjes. Ndikimi i tërthortë i ideve të reja dhe sidomos zhvillimi i ngjarjeve e bëjnë Mato Grudën që ta kapërcejë më në fund tragjizmin e vet dhe të gjejë vendin e tij në ato rrethana historike të një përlëshjeje kombëtare: ai e kthen grykën e topit jo më kundër hasmëve, por kundër pushtuesve nazistë dhe plasja e predhës bashkohet me breshërinë partizane. Ai u përfshi në lëvizje ndonëse, me sa kuptohet, nga plaga e rëndë do të vdesë dhe do të lërë të birin si trashëgimtar në radhët e luftëtarëve. Vdekja e tij, ndonëse e rastit në shtjellimin e subjektit, emocionalisht lidhet, ndofta, me luftën e vetmuar të heroit dhe është fundi i tragjizmit të tij, një tragjizëm shpirtëror, i kapërcyer, por që lë pasojat e veta në jetë.

Shkrimtarët tanë kanë ardhur duke u formuar më mirë nga pikëpamja filozofike dhe kanë shpjeguar me një shikim materialist ngjarjet dhe njerëzit. Kështu, të pajisur me botëkuptimin marksist-leninist dhe me të dhëna konkrete nga jeta, ata kanë pasur të qartë ndër subjektet e trajtuara, problemin e forcave progresive në një moment të caktuar historik; nuk e kanë marrë popullin si diçka abstrakte, të shpjeguar me ngjyra idilike apo sentimentale, po në një konceptim klasor. Dhe në romane kanë dalë forcat kryesore lëvizëse, aleatët e tyre, zigzagët e pronarit të vogël, gjendja e tij në shoqëri në mvartësi nga qëndrimi klasor që mban etj. Shikimi dialektik i lëvizjes së masave përpara, sidomos në periudhën e ndërtimit të socializmit, është thelluar, por ende nuk mund të themi se ka arritje të dukshme në këtë kuptim, se përshkruhet me ngjyrat dhe thellësinë e duhur dinamika e psikologjisë së masës, lufta e vazhdueshme që bën Partia për rrënjosjen e botëkuptimit proletar dhe flakjen e moralit borgjez e mikroborgjez. Realizimi i këtyre ideve, natyrisht, kërkon një mishërim artistik dhe nuk është fjala për të manovruar në mënyrë të përgjithshme racionale. Por problemi i pasqyrimin më të thellë në romanin tonë i lëvizjes shpirtërore të masave të fshatarëve, po edhe të punëtorëve, mbetet në qendër të vëmendjes dhe kërkon një trajtim më të gjerë.

Një aspekt i rëndësishëm i këtij problemi është edhe gdhendja artistike e figurave të komunistëve, e figurave të njerëzve përparimtarë e revolucionarë, e figurës së udhëheqësit shpirtëror të masave, duke e kuptuar këtë udhëheqje morale dhe shpirtërore që nga niveli më i thjeshtë gjer te ai më i larti, në pasqyrimin e personaliteteve historike. Zgjidhja e drejtë e këtyre marrëdhënieve është themelore për një roman, sidomos epik, dhe përcakton vlerën ideore dhe patosin e tij. Ne kemi përparime të ndjeshme në këtë vështrim. Ndonëse ende luftojmë me skematizmin, tani haset më pak heroi moralizues, idilik, figura pa jetë. Përçimi i ideve



të përparuara te masa, për zgjimin apo formimin e mëtejshëm të ndërgjegjes së saj në disa romane si «Juga e bardhë», «Përballimi», «Shembja e idhujve» (përmes mësuesit me ide përparimtare), «Zgjimi i Nebi Surelit» etj. lot një rol të ndjeshëm në subjektet e këtyre veprave dhe në ecurinë e ngjarjeve. Elemente skematizmi, zgjidhje të papërligjura, marrëdhënie ndonjëherë edhe «zyrtare» të heroit me masën ndeshen në këto edhe në vepra të tjera.

Problemi i udhëheqësit të masave, i paraqitjes së kuadrove revolucionare me ndikimin e tyre të qartë ka preokupuar gjithmonë artin proletar dhe kritikën marksiste. Kështu, duke pasur parasysh vendin që duhet të zënë në një vepër letrare revolucionarët udhëheqës, Marksi thoshte: «Do të ishte shumë e dëshirueshme që njerëzit, të cilët kanë qenë në krye të lëvizjes, qoftë para revolucionit, në shoqëritë e fshehta ose në shtyp, qoftë në periudhën e revolucionit, të pikturoheshin, më në fund, me ngjyra të ashpra si ato të Rembrandit, në tërë vështirësinë e vet reale. Në të gjitha përshkrimet e deritanishme këta njerëz nuk paraqiten kurrë me pamjen e tyre reale, por vetëm në atë zyrtare, me brerore në kokë... Në këto portrete të transformuara në mënyrë të ekzaltuar si ato të Rafaelit humbet e gjithë vërtetësia e paraqitjes».

Letërsia revolucionare që atëherë e deri sot ka ndryshuar shumë dhe e ka zgjidhur më mirë këtë problem, po fjalët e Marksit, vlejné edhe sot për një thellim realist të heroit, për depërtimin në shpirtin e tij dhe për përshkrimin e veprimtarisë shoqërore me ngjyra të gjalla dhe jetësore.

Figura e komunistit, e një heroit që duhet të prijë si bartës i idealit pozitiv, mbetet për t'u thelluar e kristalizuar më mirë në romanin tonë, duke treguar lidhjet e tij të shumanshme me popullin që e ka nxjerrë, me tiparet njerëzore dhe bindjet e thella revolucionare. Ne kemi shembuj të mirë të figurës së komu-

nistit, të aftësisë së tij për të vepruar ndër situata të ndërlikuara.

Përveç veprave që u përmendën, te «Nëntori i një kryeqyteti», i I. Kadaresë duket afrimi shpirtëror i heroit me masën dhe përpjekja për të dhënë personazhet pozitivë. Por në këtë roman përshkrimi i masës, si figurë e gjallë plastike, që i jep ngjyrën revolucionit, mund të bëhej më gjërë e më mirë, meqë këtë e kërkon logjika e veprës, synimet dhe ndërtimi i saj.

Një shembull të qartë se si heroi, figurë e njohur historike, ngrihet nga njeri i thjeshtë në një njeri të shquar të lëvizjes patriotike, ndeshim te romani «Zgji-mi» i S. Spasses, ku ka një gërshetim të përshkrimit të masës dhe të individëve, disa figura të arrira dhe skena që shprehin vrullin dhe pasionet patriotike të popullit.

Problemi i paraqitjes dhe i interpretimit të drejtë të figurave historike, të personaliteteve të shquara, është me rëndësi në një roman historik, sidomos me shtrirje të gjerë. Romani historik realist, dhe, veçanërisht i realizmit socialist, nisët nga ngjarjet historike që kanë luajtur rol në jetën e një populli, i qëndron besnik së vërtetës historike. Romancierit, në këtë rast, është edhe artist, edhe historian, sepse arti gjithmonë e paraqet jetën, materialin jetësor përmes një mendimi të caktuar, duke hedhur dritë në ato ngjarje, në ato pamje dhe kënde të realitetit historik, të njeriut, të veprimtarisë dhe të botës së tij të brendshme, që do të zbulonin thelbin e, pse jo, edhe detajet e epokës, por që do t'i flisnin së sotmes, do të zgjonin mendime dhe ndjenja te njeriu i shoqërisë së sotme. Sekretit i suksesit të një romani historik qëndron pikërisht në harmonizimin e drejtë të këtyre dy momenteve.

Romani ynë historik ka njohur përparime në këtë periudhë. «Skënderbeu» i S. Godos dëshmon për këtë. Pikërisht momentet për të cilat folëm — vërtetësia historike dhe analogjia me të sotmen — kanë gjetur zgjidhje të drejta te kjo vepër. A shtrohet drejt në këtë roman problemi i marrëdhënieve të prijësit ushtarak me



masat e popullit? Mendoj se ky problem shtrohet dhe zgjidhet drejt. Vepra përshkohet edhe nga skena masive, të cilat zenë një vend të rëndësishëm në roman. Skenat e betejave pas humbjes së Beratit, kur Skënderbeu hyn në një shtëpi fshatare dhe bisedon me luftëtarët e thjeshtë, dëgjon mençurinë e tyre dhe shumë episode të tjera tregojnë për lidhjet me njerëzit dhe flasin për karakterin popullor të kësaj lufte. Skënderbeu në roman del i vetëdijshëm se pa popullin s'mund të bënte asgjë.

Mënyrat dhe stilet janë të ndryshme. Veprat letrare historike plotësojnë njëra-tjetrën. Dikush priret nga faktet, doemos me elemente të imagjinatës, ose e kundërta, po gjithmonë këto duhet të mbeten në sferën e krijimit. Romani i S. Godos sjell shumë ngjarje dhe fakte përmes përshkrimeve konkrete dhe detajeve të gjetura. Krijohet një atmosferë që i flet së sotmes. Por, edhe në këtë strukturë dhe prirje që ka, a do ta ndihmonte romanin krijimi i ndonjë figure të rëndësishme imagjinare nga masat e popullit? Mendoj që po dhe kjo do të mishëronte më mirë idenë se Skënderbeu u mbështet tek ato dhe se lëvizjet historike pa masat nuk mund të kuptohen. Kjo do të kërkonte një shkathtësi më të madhe për ndërtimin e subjektit dhe do të zgjeronte aspektin social të veprës.

Së fundi, po prek shkurtimisht problemin se si shprehen në romanin tonë, në mjetet dhe në ndërtimin e tyre, këto elemente të reja të përmbajtjes. Natyrisht ky problem do të kërkonte një analizë më vete; këtu vetëm do të cekem disa ide.

Koncepti i ri shoqëror dhe i njeriut shpie drejt një shtrirjeje epike më të gjerë, duke nënkuptuar edhe çastet lirike dhe dramatike. Me gjithë llojet e ndryshme të romaneve të realizmit socialist, kemi të bëjmë më shumë, se sa në romanin realist tradicional, me gërshetimin e skenave të marrëdhënieve të individëve me skenat masive. Subjektet bëhen më dinamike, në kuptimin më të thellë të kësaj fjale dhe jo në sipër-

faqe; veprimi hyn në themel të veprave që trajtojnë probleme të lëvizjes së masave në histori.

Ndonëse ka mjaft romane me një hero në qendër, lidhjet e tij me ambientin dhe njerëzit bëhen të shumanshme. Romanet shpesh zhvillohen në disa plane. Veç kësaj njohim edhe vepra që vënë në qendër jo një, po disa heronj po aq të rëndësishëm e kjo nuk është e rastit, por ka të bëjë me zotërimin e tipave pozitivë në jetë dhe të heroizmit masiv. Ka edhe raste kur forca e popullit del përmes portreteve të veçanta që formojnë një tërësi ose jepen me ngjyime poetike nën dritën e mendimit filozofik. Prania e popullit, e heroit të dalë nga gjiri i tij, i jep gjallëri stilit, shton poezinë, humorin, ngjyrat emocionale popullore, përcakton tingëllimin romantik të disa veprave brenda konceptimit realist.

Të gjitha këto demokratizojnë formën, e bëjnë romanin tonë komunikues me lloje dhe mënyra të shumta, por të qartë dhe të dashur për mijëra lexues.

1975



## MBI DRAMATICITETIN E VEPRAVE TONA LETRARE

Problemi i luftës së klasave, që u shtrua me thellësi marksiste-leniniste në Kongresin VII, kërkon një analizë të veçantë e studime të mëtejshme edhe në fushën e letërsisë e të artit. Ky problem është i lidhur ngushtë me zhvillimin e artit dhe ka të bëjë me dy aspekte kryesore, së pari, me qëndrimin klasor që përshkon e duhet të përshkojë çdo vepër arti dhe, së dyti, me pasqyrimin drejtpërdrejt të proceseve të luftës klasore, pra me ndeshjet dhe konfliktet jetësore që gjejnë shprehje edhe përmes konflikteve artistike. Pasqyrimi i drejtë i kontradiktave antagonistë dhe joantagonistë buron pikërisht nga të kuptuarit e saktë të luftës së klasave, si forcë kryesore lëvizëse në shoqërinë tonë. Konfliktet e fuqishme në formë më të hapur e më të dukshme, pasqyrohen kryesisht në vepra të gjinive epike e dramatike, por edhe llojet lirike nuk janë të privuara nga pasqyrimi i luftës së të kundërtave, në përshtatje me specifikën e vet.

Kur mungon kjo luftë midis pohimit të një ideali dhe mohimit të diçkaje negative, kur vepra nuk të ve në mendime, pa dyshim, kemi të bëjmë me cektësi dhe kundër kësaj duhet luftuar si duke njohur më thellë proceset e jetës, ashtu edhe duke përvetësuar më mirë filozofinë marksiste-leniniste.

Duke folur në Kongres për detyrat e shkrimtarëve dhe artistëve, shoku Enver, në raportin që mbajti tha: «Nga ata kërkohet të pasqyrojnë drejt në veprat e tyre proceset dhe prirjet themelore të revolucionit tonë, kontradiktat e jetës dhe të luftojnë çdo shfaqje të formalizmit e të skematizmit në trajtimin e tyre...».

Kontradiktat e jetës, në gjinitë e ndryshme letrare, gjatë viteve të fundit janë trajtuar më mirë. U bë një luftë e ashpër kundër ndikimeve të huaja në këtë fushë, u kapën më drejt kontradiktat antagoniste, të një rëndësie të madhe në situatën që kalojmë, dhe u pasqyruan ato në një raport më të saktë me kontradiktat jo-antagoniste. Sigurisht mbetet ende për të bërë dhe lufta është e vazhdueshme. Sidomos në krijime të pabotuara, ka raste të veçanta kur kontradiktat e jetës zëvendësohen nga përfytyrime subjektive të artistit, nuk tregohet lidhja me realitetin dhe nuk arrihet në zgjidhje të drejta. Përveç këtyre që thamë, ka mjaft raste të kapjes së cekët të kontradiktave, të zgjidhjeve të shpejtuara e jo gjer në fund bindëse si edhe të kapjes me çikërrima e jo me probleme të rëndësishme, siç është thënë për estradat e komeditë, ku ka mungesa të ndieshme.

Periodha pas Plenumit IV të KQ të Partisë karakterizohet nga një zhvillim i dukshëm në të gjitha llojet e gjinitë, gjë që vërehet edhe në zbulimin dhe zgjidhjen më të drejtë të kontradiktave.

Po të shohim shkurtimisht arritjet dhe disa probleme që dalin, nga kjo pikëpamje, në gjinitë e ndryshme letrare, do të vemë re p.sh. se në kuptimin që folëm poezia jonë ka ecur në gjurmët e saj më të mira dhe ka njohur suksese. Në forma të përgjithësuara dhe sintetike, si edhe përmes episodesh e faktesh konkrete, poetët tanë më me përvojë e më të rinj, të nisur nga parimi i partishmërisë proletare, kanë pasqyruar drejt kontradiktat e kohës, duke e vënë më tepër theksin tek ato antagoniste. Kjo ndodh sepse poezia jonë është militante e polemizuese, ajo ngrihet kundër botës bor-



gjezo-revizioniste dhe pohon me forcë realitetin tonë. Është karakteristike se në poemat tona të kohëve të fundit lidhet në një lufta e popullit dhe e Partisë kundër armiqve të djeshëm e të sotëm dhe theksohet, përmes fjalës poetike, gatishmëria revolucionare e popullit.

Për poezinë është e nevojshme të thuhet se tani ka koncepte më të qarta që janë në kundërshtim me shikimin tepër të përgjithshëm të realitetit. Natyrisht, poezia jonë është në radhë të parë, afirmative, por ideja e unitetit tregohet më mirë përmes rrugës së kontradiktave, sepse edhe në jetë uniteti është shprehje e luftës së të kundërtave, tregohet përmes vështirësive dhe kapërcimit të tyre; kjo forcon shtratin filozofik dhe militantizmin e saj. Pasqyrimi i kontradiktave antagoniste dhe joantagoniste është bërë e mund të bëhet edhe më mirë në poezi. Por kuptohet se si lustrimi i realitetit, nëpërmjet zbutjes subjektive të luftës së të kundërtave, ashtu edhe sajimi artificial i kontradiktave janë të dëmshme.

Nga diskutimet që janë bërë e nga ç'është shkruar në shtyp, ka dalë më qartë problemi i zhvillimit të romanit tonë në këtë periudhë. Kontradiktat e jetës në sferën politike, ekonomike, ideologjike dhe morale kanë gjetur një pasqyrim të drejtë në veprat tona si për të sotmen ashtu edhe për të kaluarën.

Për romanin dhe dramën është e nevojshme të trajtohet problemi i kapjes së një kontradikte kryesore të një periudhe të caktuar historike. Kjo gjë kërkon njohje të jetës e të historisë dhe interpretim shkencor brenda kërkesave dhe fantazisë që lejon arti, duke afruar të shkruarën me të sotmen. Ka mjaft raste të pleksjes së kontradiktave politike e sociale, antagoniste dhe joantagoniste, sidomos në vepra kushtuar luftës, si p.sh. «Para agimit» e Sh. Musarajt, «Komisari Memo» i D. Agollit në tregime të Dh. Shuteriqit, N. Priftit, A. Kondos, N. Lerës etj. Por midis kontradiktave, njëra mbetet kryesore: ajo me pushtuesit, sepse ka qenë kryesore në atë kohë dhe po të spositohej vëmendja do të bëhej

gabim historik. Kështu ndodh edhe për periudhat e tjera historike, kur problemi themelor ka qenë ai i çlirimit kombëtar. Konfondimi i kontradiktës kryesore të kohës të shpie në gabime, në largim nga e vërteta historike.

Këtu duhet sqaruar se merita e shkrimtarëve tanë të realizmit socialist, sidomos në dekadat e fundit, është depërtimi në çdo epokë me një analizë social-klasore. Letërsia jonë ka ecur përpara nga kjo pikëpamje dhe patriotizmi nuk merret si diçka sentimentale dhe e shkëputur nga shoqëria e nga lufta e klasave. Le të kujtojmë disa nga veprat tona në dramë e në prozë, më të hershme, në të cilat rastiste që fenomene të ndryshme nuk pasqyroheshin nën prizmin e filozofisë sonë, ndaj edhe bihej në trajtime abstrakte e idealizuese. Ne kemi kritikuar edhe poezi në forma baladash e legjendash anakronike, që nuk e shihnin historinë me një sy aktual, po me një lloj nostalgjie romantizuese. Vërtetësia historike nuk shkon ndesh, po në unitet me vështrimin aktual, kërkon të zbulosh çfarë është më esenciale në një periudhë dhe të interpretosh raportin e klasave në një dritë realiste, duke i qëndruar besnik thelbit dhe ngjyrave të kohës.

Është trajtuar tek ne problemi i raportit midis temës historike dhe aktuale. Çdo art përparimtar, në çdo kohë, sidomos arti realist, i ka dhënë rëndësi më të madhe temave bashkëkohore e kjo aq më tepër del e qartë për krijuesit e realizmit socialist. Raporti midis tyre tek ne është i drejtë, megjithëse edhe më shumë duhet t'i kushtohet kujdes temës aktuale. Por dihet se fryma aktuale mund të dalë në të gjitha temat. Shkrimtarët dhe artistët tanë e trajtojnë temën e së kaluarës për të treguar vazhdimësinë e një rruge, të historisë së popullit. Në qoftë se disa shkrimtarë e artistë kanë kapur epokën e Skënderbeut si I. Kadare me romanin «Kështjella», S. Godo me «Skënderbeu» apo Mirosh Markaj me «Gjergj Kastrioti» etj., duke i qëndruar besnikë së vërtetës historike, kanë gjetur një analogji me të sotmen, në luftën kundër fuqive të mëdha, kjo



është një gjë shumë e mirë dhe vlen për të njohur ç'rrugë heroike kemi bërë si komb dhe për të treguar lidhjet e kohëve. Por ne kemi pasur edhe vepra të rëndësishme që e trajtojnë problemin e qëndresës drejtpërdrejt nga e sotmja, prirje që do të vijë duke u shtuar e thelluar.

Drama është gjinia ku spikat, ndofta, më tepër se kudo konflikti, drama e jetës. Dhe, siç është pohuar, pas Plenumit IV e këtij ajo ka ecur përpara edhe në aspektin për të cilin flasim, në trajtimin dhe zgjidhjen e drejtë të kontradiktave. Drama të kohëve të fundit si «Gjëmimi i atij dimri» e T.Laços, «Lulet e Shegës» e K.Jakovës, «Shënomëni dhe mua» e H.Minarollit, «Djem të mbarë» e F.Krajës etj., kanë sjellë në skenë pamje të jetës dhe konflikte të periudhave të ndryshme të ndërtimit socialist.

Me gjithë arritjet, është e nevojshme të thuhet se prej kësaj gjinie pritet shumë më tepër, sepse drama dhe teatri janë mjete të fuqishme të mbrojtjes së ideve të Partisë, komunikojnë drejtpërdrejt me spektatorin dhe ndihmojnë në edukimin e masave. Lidhur me interpretimin më të thellë të jetës, sidomos në dramë, me tipet e konflikteve që shquhen sot, me konceptimin ideologjik të tyre, dalin probleme që meritojnë vëmendje të veçantë.

Së pari, është e domosdoshme që zbërthimi i problemeve të realitetit, i ndeshjes së të kundërtave, sidomos në gjinitë epike, po edhe në gjithë krijimtarinë, të kuptohet më në thellësi, me një tendencë të qartë, e cila duhet të gërshetohet më mirë me faktet reale. Një qëndrim dhe trajtim i tillë i fenomeneve do të ndihmojë që të luftohen shfaqjet e formalizmit dhe të skematizmit.

Po të marrim dramën, përveç rasteve kur debati dhe ndeshja përmes situatave e dialogut dalin mirë, ka edhe mjaft raste të tjera kur këto mbeten në sipërfaqe dhe lufta që zhvillohet në skenë nuk ka argumente të forta, nuk është bindëse dhe, prandaj, mbresat janë të zbeta. Kapja e konflikteve antagonistë në kushtet e

sotme të rrethimit dhe të luftës së ashpër të komunizmit dhe antikomunizmit, me reaksionin, është gjë pozitive për dramën dhe këto konflikte duhet të jenë të thella e tronditëse. Megjithë qëllimet e mira dhe disa rezultate, në drama e shfaqje si «Rrënjë të hekurta» e Shkodrës (e cila kishte dobësi të theksuara), «Buka e duarve tona» e Vlorës, drama si «Flamur në dallgë» e Korçës, «Dështimi i një kryqëzate» e Durrësit, këto dhe të tjera nuk arrijnë sa duhet t'i thellojnë konfliktet, të nisen nga një platformë filozofike dhe ta mishërojnë idenë nëpër situata e karaktere më të plotë. Ndonjë dramë si «Flamur në dallgë» e M.Stefës pati një pritje më të ngrohtë dhe krijoi emocione. Por, në përgjithësi, ndodh që ose mbetemi në ide të përgjithshme dhe nuk arrijmë të krijojmë ngjarje, tipa e debate me një ngarkesë më të madhe emocionale, ose rendim pas ngjarjes, situatat kalohen shkarazi dhe nuk pleksen me mendimin. Nuk duhet harruar se teatri është një tribunë e fuqishme ku del jeta dhe mendimi, të cilat duhet të lënë gjurmë te spektatori.

Shpërthimi dhe zgjidhja e kontradiktës bëhen bindëse dhe prekëse vetëm kur vijnë të përgatitura, kur fakti, episodi ngjishen me mendimin dhe atëherë ne rijetojmë intensivisht ato çaste që kanë ngjarë vërtet. Ndodh që lufta kundër armikut, qëndrimit dhe pikëpamjeve të tij thjeshtëzohen; lufta ideologjike del e zbetë; nuk kuptohet në thellësi çfarë e mban këtë armik, ç'lloj interesash e bëjnë të lidhet ose e venë në një front me reaksionin e huaj, me borgjezinë dhe revizionizmin. Po të tregohet mirë kjo ndeshje, edhe personazhet pozitive do të forcohen, fjala e tyre do të zejë vend më mirë dhe do të kuptohet më thellë rreziku i qëndrimeve dhe i ideologjisë së huaj. Edhe kur kemi të bëjmë me njerëzit tanë, me mbeturina të botës së vjetër apo ndikime borgjezo-revizioniste, siç thekson Kongresi VII, lufta me pikëpamjet duhet të jetë e ashpër, sepse edhe këto janë pikëpamje armiqësore.

Është gjë pozitive kur në dramë gjejmë një lidhje



logjike veprimet e armiqve të ndërgjegjshëm me psikologjinë apo mentalitetin e vjetëruar të njerëzve të veçantë nga gjiri i popullit dhe kështu tregohet se si shoqëria, heronjtë pozitivë luftojnë të keqen, trajtojnë armiqtë si të tillë dhe bëjnë për vete njerëzit e popullit. Kjo gjë vihet re p.sh. në dramën e fundit të K.Jakovës «Përmbytje e madhe», sipas motiveve të poemës së tij «Qiriu i fundit», e në ndonjë tjetër, ku ndihen edhe çaste të vërteta dramatike e emocionuese.

Përveç thellimit në kontradiktat e jetës, zgjidhjes së drejtë të tyre, del edhe problemi i kapjes së llojeve të ndryshme të tyre, i shtrirjes në sferat e realitetit për ta pasqyruar sa më gjerësisht. Nga kjo pikëpamje vërehet ndonjëherë kthimi te konflikte të rrahura e tema të konsumuara në letërsi si problemi i gjaqeve, i fëjesave që në djep etj. Është e kuptueshme se të gjitha konfliktet kanë të drejtën e paraqitjes, qofshin edhe të trajtuara, por ndihet nevoja e zbulimit të aspekteve të reja të jetës apo e trajtimit më të thelluar, përmes shikimesh të reja shoqërore-morale të temave të njohura, duke ndriçuar aspekte të reja të problemit.

Së dyti, drama e realizmit socialist, duke ruajtur traditën e shëndoshë të dramës realiste, e shpie atë më tej si në pasqyrimin e rolit të masave në histori, ashtu edhe të heroit dhe të detyrës së transformimit revolucionar të shoqërisë. Këtej burojnë edhe tipet e konflikteve, të subjekteve që merren në dramat shoqërore të shikuara përmes ndeshjesh klasore, kur njeriu vepron si përfaqësues i klasave dhe grupeve shoqërore të caktuara, duke qenë njeri me botën dhe psikologjinë e tij. Përmbajtja pasurohet e thellohet, ndërsa llojet e dramave mund të jenë, ashtu siç tregon edhe praktika, të ndryshme.

Kjo larmi konfliktesh e temash, ky zgjerim i sferës së tyre në praktikë ka edhe shpjegimin teorik që duhet njohur e përvetësuar. Nganjëherë në biseda apo edhe në ndonjë artikull ndodh që të gjitha llojet e dramave maten, si të thuash, me një kut, dhe bëhet shpesh

pyetja tradicionale: «E cilit personazh është drama?» Sipas kësaj pikëpamjeje dramë quhet vetëm ajo kur da dilema të brendshme një njeri dhe po u zgjidh kjo dilemë vetëvetiu duhet të mbarojë edhe drama. Edhe vepra të tilla kanë të drejtën e vet, kur nuk kalohet në drama të heroit të lëkundur, sepse është fjala për të formuar njeriun, për ta spastruar shpirtërisht. Po problemi nuk mund të shtrohet gjithmonë kështu. Dramat personale duhet të gjejnë një zgjidhje në gjirin e shoqërisë dhe të jenë në harmoni me problemet e përgjithshme. Një dramë, siç dihet, mund të ketë një problem të madh që përbën konfliktin kryesor dhe konflikte të dorës së dytë që lidhen me të natyrshëm e jo artificialisht. Kështu te drama «Gjëmimi i atij dimri» që u përmend nuk mund të thuhet se drama mbaron me zhdukjen e luhatjeve shpirtërore të Hodos (një nga personazhet qëndrore), sepse konflikti është më i gjerë: fshati, masa e fshatarëve ngrihen kundër gjermanëve e ballistëve, mbrojnë partizanen e plagosur. Po kjo gjë ndodh edhe me dramën «Shënomëni dhe mua» ku nuk mbaron konflikti në çastin kur Rustemi pranon të hyjë në kooperativë, sepse problemi shtrohet më gjerë. Në të dy dramat skenat masive me ato të veçanta janë të pranishme dhe konflikti merr përpjesëtime më të gjera. Natyrisht edhe për këto drama, si për të tjerat, mund të bëhen vërejtje për mjeshtërinë etj. Të gjitha këto nuk duan të thonë se konfliktet duhet të mbeten amorfe dhe të pakonkretizuara në vepra e situata; përkundrazi. Puna është për një kuptim më të drejtë të tipeve të konflikteve që na ofron jeta dhe krijimtaria e realizmit socialist dhe për të kuptuar më thellë prirjen e dramës drejt evoluimit.



## MBI DISA TENDENCA KRYESORE NË LETËRSINË E HUAJ TË SHEKULLIT XX

### 1.

Shekulli XX, i mbarsur me luftëra dhe me revolucione, është shekulli i kontradiktave të mëdha klasore, i shpërthimit të proletariatit si klasë që lot rolin kryesor në histori, shekulli i luftërave për liri kundër kolonializmit dhe i vazhimit të betejave kundër imperializmit, revizionizmit, kundër agresioneve, dredhive dhe diversionit ideologjik të armiqvet të popujve. Degjenerimi i borgjezisë, thellimi i kontradiktave shoqërore dhe lindja e heroit të ri që mbart mbi vete peshën e revolucionit kanë qenë shkaqet kryesore që kanë përcaktuar në gjirin e letërsisë përparimtare, revolucionare të botës, krijimin e veprave me një realizëm të thellë social si edhe i elementeve socialistë që i përshkojnë, apo i afirmimit të një metode krijuese, me drejtimin e vet letrar dhe artistik, të përhapur në të gjithë botën, të metodës së realizmit socialist.

Veprat realiste të këtij shekulli, që vijnë e zhvillohen sipas rrethanave historiko-shoqërore dhe botë-kuptimit të autorëve gjer në ditët tona, karakterizohen nga vazhdimi dhe thellimi i traditës realiste të shekullit XIX, nga zbulimi i gjendjes reale të shoqërisë dhe të

raportit të klasave. Notat e protestës, elementet socialë, temat e mëdha të shfrytëzimit kapitalist dhe të rezistencës, figurat e punëtorëve apo intelektualëve të dalë nga gjiri i popullit, që luftojnë për interesat e tij vijnë e shtohen dhe zënë vend më shumë në subjektet e romaneve e dramave. Përmes këtyre veprave mund të njohësh gjendjen e vërtetë të shoqërisë borgjeze në shumë vende të Evropës dhe të botës, cinizmin, degjenerimin shpirtëror dhe moral të pronarëve, bankierëve si edhe tendencat demokratike të njeriut të thjeshtë të popullit. Lufta klasore është në qendër të pasqyrimit të shumë veprave, ndonëse interpretimi i saj nuk bëhet kurdoherë nga pozita të drejta dhe shpesh mungon perspektiva heroike. Duke përmendur romanin e vet të njohur social «Një tragjedi amerikane» Drajzeri, realist dhe armik i dekadentizmit, fliste për një lloj «eposi klasor» që kishte filluar të përhapej në periudhën kur «antagonizmi i klasave», siç pohonte ai, merrte përpjesëtime të mëdha.

Realizmi i shekullit tonë eci në gjurmën e analizës social-historike të tipave, të familjeve, të brezave; u thellua në pasqyrimin e botës intelektuale duke pasuruar veprat me prirje filozofike dhe poetike, përftoi një stil më bashkëkohor, më afër psikologjisë së njeriut të sotëm. Me gjithë larminë e formave dhe evoluimin, parimet kryesore të letërsisë realiste përparimtare mbetën dhe u ngulitën edhe më fort: kështu, në shumë vepra me vlerë realiste, jeta pasqyrohet me besnikëri, duke tipizuar fenomenet; në qendër të tyre është njeriu si genie shoqërore, natyrisht, me botën e vet individuale-psikologjike, po, në radhë të parë, me raportet e tij ndaj shoqërisë. Në letërsinë realiste ruhet parimi i karakterit kombëtar dhe, përmes veçorive kombëtare historiko-shoqërore, të psikikës së popullit, të mënyrës së konceptimit poetik figurativ të botës, spikasin vlerat e veprave realiste të autorëve nga Afrika, Azia, Amerika Latine apo Evropa. Ka mjaft krijues realistë që i drejtohen edhe historisë për të gjetur analogji me të sotmen.



Këta ruajnë me besnikëri frymën e epokave që përshkruajnë, por theksojnë aspekte, ngjarje, tipa që ndihmojnë në luftën e sotme, që ngrenë lart qëndresën e popujve të vegjël. Mishërimin e ideve dhe prirjeve që u përmendën e gjejmë në vepra autorësh të shekullit XX si Londoni, Gollsuorthi, Kronini, Drajzeri, Tomas Mani, Fojhtvangeri, Kazanzaqis, Hashek, në vepra të veçanta autorësh edhe me kontradikta të ndijshme në krijimtarinë e tyre si Kollduell, Miler e mjaft të tjerë.

Është i njohur patosi kritik i realizmit edhe në shekullin tonë. Ndër veprat e këtij drejtimi letrar ka raste kur dilet nga caqet e kritikës dhe shprehet simpatia për forcat pozitive të konceptuara ende turbullt. Po ato mbeten, përgjithësisht, në kufijtë e realizmit kritik që nuk kap dhe nuk pasqyron heroin e ri të shoqërisë. Me gjithë këtë kufizim, siç dihet, ato kanë vlera të mëdha dhe hyjnë në thesarin e kulturës përparimtare botërore. Por është e nevojshme të thuhet se ky realizëm, veç kufizimit që përmendëm, hera-herës dhe tek disa autorë, gjendet i përzier me ndikime rrymash moderniste, ndikime të psikanalizës, të vështrimit të njeriut më tepër si qenie biologjike se sa shoqërore, ndikime pra të frojdizmit, i pleksur me çaste pesimizmi apo me një ndjenjë fataliteti. Këtu duhet dalluar e mira, e dobishmja dhe vërtet e bukura në art nga e dëmshmja, subjektivja, nga ajo që estetikisht zgjon një ndjenjë të shëmtuar neverije.

Një drejtim shumë i fuqishëm, që i ka prirë letërsisë përparimtare, është realizmi socialist, i cili gjeti mishërim të qartë dhe të plotë në Rusi, në kushtet e lindjes dhe të fitores më 1917 të revolucionit proletar me themelues Maksim Gorkin, nën drejtimin ideologjik të Partisë së Bolshevikëve, por i pati premisat e veta edhe më parë, në lëvizjen punëtore të vendeve të ndryshme të botës, që me këngët e Komunës së Parisit, me romanet e Zhyl Valesit apo të Leon Kladelit, me poezi të Hajnës e me shfaqje të tjera të një patosi komunist.

Përveç veprave që ne njohim e çmojmë të Gorkit,

Majakovskit, Fadejevit, Ostrovskit, Furmanovit e autorëve të tjerë revolucionarë rusë, realizmi socialist gjeti shprehjen e vet në vepra të veçanta apo në tërësi, te autorë si Barbysi, Neksoja, Rolani, Pol Vajan Kutyrje, Fuçiku, Vapracovi, Brehti, Xhon Ridi, Ralf Foksi, Lorka dhe te shumë autorë të tjerë, një pjesë e të cilëve e mbrojtën çështjen e komunizmit dhe të luftës antifashiste jo vetëm me veprën e tyre, po edhe duke dhënë jetën e u bënë shembull i qëndresës dhe i heroizmit. Nga realizmi kaloi në pozita revolucionare shkrimtari kinez Lu Sin, i cili arriti të japë tablo të vërteta dhe të thella të mjerimit të njerëzve të varfër dhe të qëndresës së tyre. Poezia e popujve të Afrikës, Azisë, vepra të autorëve vietnamezë, të frymëzuara nga lufta e gjatë dhe heroike për liri, krijime autorësh të Amerikës Latine, si të poetit të shquar kilian Pablo Neruda, që vdiq disa ditë pas grushtit të shtetit fashist që u bë në Kili dhe shumë të tjera, të njohura edhe tek ne, — e tërë kjo krijimtari dëshmon për një patos antiimperialist, për synime demokratike, popullore apo edhe socialiste, shpreh indinjatën e popujve ndaj agresorëve imperialistë, ndaj planeve të tyre dhe hyn në tendencën e shëndoshë, pozitive të zhvillimit të sotëm letrar në botë.

Shkrimtarë dhe estetë borgjezë dhe revizionistë janë munduar dhe mundohen të godasin realizmin socialist, ta quajnë atë të vjetëruar, dogmatik. Luftë e madhe i bëhet edhe realizmit, besnikërisë në pasqyrimin e realitetit, domosdoshmërisë së tipave apo të ideve të qarta e themelore në një vepër letrare. Por koha po tregon të kundërtën. Me gjithë vështirësitë dhe përpjekjet, realizmi socialist zhvillohet. Degjenerimi i letërsisë sovjetike dhe i disa letërsive të vendeve të tjera në revizionizëm është një shmangie e dukshme dhe e rëndësishme nga rruga e zhvillimit të artit proletar. Kjo gjë ka sjellë dëm të madh, çorientim dhe hutim në radhët e disa intelektualëve të vendeve borgjeze. Por, po ta marrin në përpjesëtime të gjëra dhe perspektivë, devijimi, tradhtia,



hipokrizia e predikatorëve revizionistë nuk kanë fuqi të frenojnë zhvillimin e artit që thotë të vërtetën, që fton drejt protestës e jo drejt nënshtrimit e kjo bëhet më mirë nga përfaqësuesit e atyre vendeve që mbajnë mbi shpinë peshën e luftës, të revolucionit, të përpjekjeve për liri dhe pavarësi. Realizmin socialist e mbrojnë poetët, shkrimtarët edhe duke rrezikuar jetën, p.sh. përpara gjyqeve frankiste, nëpër burgje e kudo.

Karakteristikë për shekullin XX është kalimi i disa autorëve të përmendur nga pozitat e turbullta surrealiste, kubofuturiste etj., në pozita revolucionare, antifashiste. Një shembull i tillë ka qenë Majakovski, i cili u bë një ndër poetët tribunë më të njohur të revolucionit. Të tillë ishin edhe Pol Eluari që doli nga mjegulla dadaiste dhe surrealiste për t'u bërë një poet i rezistencës dhe me ide socialiste; ashtu ka qenë edhe Garsia Lorca, që erdhi duke evoluar në poezinë dhe krijimtarinë e tij me një ngarkesë emocionale të fuqishme. Krijimtaria e këtyre autorëve dhe të tjerëve ka kontradikcionin e vet, figura të errëta dhe të pakapshme, subjektivizëm surrealit. Ne mund të marrim dhe të çmojmë prej saj atë që është pozitive. Fenomene të tilla kalimesh ka pasur dhe do të ketë për ata artistë që kanë diçka realiste në bërthamën e krijimtarisë së tyre dhe që tërhiqen nga forcat e shëndosha.

Baza teorike e letërsisë dhe artit të realizmit socialist kanë qenë mësimet e Marksit dhe Engelsit; në etapën e mëvonshme mësimet e Leninit. Pa dyshim, ky art është mbështetur edhe në mendimin teorik e kritik materialist, përparimtar të shekujve të kaluar dhe të kohës sonë. Por kritika marksiste është ajo që ka çarë më shumë përpara në këtë shekull dhe po çan, në kundërshtim me teoritë borgjeze revizioniste që mbrojnë dekadentizmin, formalizmin, rrymat antirealiste. Krijimtaria e kritikëve marksistë nuk ka qenë pa gabime, pa qëndrime subjektiviste. Po vija kryesore e mendimit kritik, që mbronte dhe shtjellonte tezat marksiste-leniniste në kushtet e reja të zhvillimit letrar ka qenë e drejtë, dhe

më e afta për t'i shpjeguar shkencërisht fenomenet. Kështu, duke bërë këtu vetëm një paraqitje shumë të shkurtër autorësh të njohur e pak të njohur (këtij problemi mund t'i kushtohet vëmendje e veçantë), do të shohim se mendimi kritik marksist, po të nisim që nga shekulli XIX, është përfaqësuar nga Pol Lafargu apo Eduard Evening, nga Franc Meringu apo nga Plehanovi e Llunaçarski, nga Gorki dhe Vorovski, nga Antonio Gramshi, Ralf Foksi, Julius Fuçiku e mjaft të tjerë. Të gjithë këta kanë mbrojtur karakterin social të artit, kanë përkrahur dhe nxitur pasqyrimin e figurës së punëtorit në letërsi, zbulimin e kontradiktave të shoqërisë borgjeze; kanë shpjeguar rrënjët e modernizmit e të dekadentizmit dhe shpesh kanë parashikuar me largpamësi të ardhmen socialiste të letërsisë. Mendimi i tyre për rrymat moderniste na ndihmon edhe sot për t'i kuptuar drejt dhe për t'i luftuar këto fenomene.

## 2.

Gjithmonë, në vende dhe në periudha të ndryshme historike kanë lindur rryma dhe shkolla letrare që kanë shënuar një zhvillim apo regres dhe që u janë përgjigjur interesave klasore, kushteve shoqërore dhe historike, gjendjes shpirtërore të shtresave të shoqërisë. Emërtimet kanë qenë të shumëllojta dhe shkalla e njohjes, e pasqyrimin të realitetit e ndryshme edhe për rrymat progresive, po ato historikisht dhe nga pikëpamja e metodës i bashkon diçka e rëndësishme, thelbësore. Realizmi i epokave të ndryshme, romantizmi përparimtar, verizmi italian, shkolla natyrale ruse e Gogolit dhe të tjera lidhen në një vazhdimësi, në afrimin me realitetin dhe në përpjekjen për të thënë të vërtetën dhe për të ngritur probleme shoqërore. Edhe rrymat, shkollat e shkollëzat regresive që lindin e këmbëjnë njëra-tjetrën me një shpejtësi të habitshme kanë midis tyre një lidhje të brendshme; ato i bashkon largimi nga jeta, zhytja në labirintet e ndërëgjegjes së sëmurë, metoda formaliste, aprioristike, pseudonovatorizmi, një bazë fi-



lozofike: idealizmi subjektiv. Këto drejtime të mëdha dhe të kundërta — progresive dhe regresive — në shoqërinë borgjeze ndeshen sipas situatave dhe merr epërsi njëra apo tjetra tendencë në periudha të caktuara. Të vërtetën e dy kulturave në kombin borgjez e ka shprehur Lenini, i cili ka thënë se «...nga kultura kombëtare ne marrim vetëm elementet e saj demokratikë dhe socialistë, marrim vetëm dhe doemos këto elemente, në kundërshtim me kulturën borgjeze, me nacionalizmin borgjez të çdo kombi».

Elementët antidemokratikë dhe antisocialistë, të veçshur me një filozofi të stërholluar idealiste, të cilat ne, siç thotë shoku Enver, duhet t'i flakim tej, duke vazhduar kështu qëndrimin leninist, janë shprehur dhe shprehen në shekullin tonë dhe më përpara përmes rrymave letrare dhe artistike të impresionizmit, ekspresionizmit, futurizmit, simbolizmit, imazhinizmit dhe hermetizmit (i cili më tepër se sa rrymë është një tendencë për të kamufluar në mënyrë subjektivistike idetë), surealizmit, abstraksionizmit, kubizmit ekzistencializmit etj. Po t'i shohim historikisht dhe përmes disa përfaqësuesish si Verlen, Apoliner, Pikaso, Salvator Dali, Sartër, Kamy, Kafka, Cvetajeva, Pasternak e shumë të tjerë do të formojmë një ide sado të përgjithshme mbi thelbin dekadent, pesimist dhe mbi formalizmin që zotëron në këto «izma». Prirja e tyre kryesore artistike, në një shkallë apo në një tjetër, është reflektimi fantastik i botës së hijeve, në vend të fenomeneve reale, ankthi i njeriut të izoluar dhe të shtypur, ndjenja e tjetërsimit, paaftësia për të zgjidhur problemet e koklavitura që ngre shoqëria; deformimi i realitetit, krijimi i figurave arbitrare pa lidhje të brendshme logjike dhe të mbështetura në shoqërime idesh që shprehin një gjendje kaotike dhe përçarë. Karakteristike për këto «izma», sipas shkollave dhe autorëve, është gjithashtu shtrembërimi i formave dhe përmasave reale të jetës, zëvendësimi i tyre me lidhje të përçudnuara subjektivistike, konvencionalizmi dhe simbolizmi që kalon çdo masë dhe e bën artin të zhytet

në agnosticizëm dhe të vërtitet brenda ndërgjegjes, subkoshiençës pa kërkuar asgjëkund në shoqëri, edhe jashtë individit, shkaqet e turbullirave të brendshme, të dëshpërimit, deziluzionit, vetëvrasjeve, prostitucionit, lahtarës përpara vdekjes.

Rruga historike e rrymave të ndryshme, natyrisht nuk është e njëlojtë. Ka rryma që kanë lindur si reagim estetik ndaj një rryme tjetër, janë nisur me një protestë sado anarkiste, individualiste dhe të sipërfaqshme. Ka rryma, pa iluzionet më të vogla të protestës sociale, të cilat e kanë nisur që në krye rrugën e degjenerimit dhe e kanë thelluar më vonë. Po ashtu siç thotë shoku Enver në Plenumin IV, cilado qoftë pikënisja dhe parullat gjoja të majta, baza filozofike e tyre është idealizmi dhe qëndrimi i tyre, në thelb, është individualist. Me veprën e tyre, me çoroditjen që sjellin në shoqëri, me largimin e vëmendjes nga problemet themelore të kohës, ata i shërbejnë borgjezisë, përhapin ide reaksionare, nxitin ndjenjën e depresionit dhe të nënshtrimit.

Që në shekullin XIX kritika marksiste zbuloi rrymat antirealiste, shpjegoi shkaqet e lindjes së natyralizmit dhe kalimin nga objektivizmi natyralist në subjektivizmin dekadent. Natyralizmi, thuhej në këto kritika, nuk ka konceptin e luftës klasore dhe mbetet në caqet e pesimizmit, sepse veç «varfërisë nuk sheh gjë tjetër dhe mohon optimizmin e jetës».

Kritika marksiste, e përfaqësuar prej Gorkit, Vorovskit, Barbysit, Llunaçarskit ka shpjeguar rrënjët sociale të dekadentëve modernistë, duke lënë mënjanë predikimet e iluzionet e tyre dhe duke treguar natyrën e vërtetë të kësaj inteligjence. Artistët e kësaj kategorie, shpeshherë të talentuar dhe me emër, përfaqësojnë shtresa mikroborgjeze, të lëkundshme, konformiste, që nisin me një protestë të dëshpëruar dhe mbarojnë me depresion të plotë moral. Shumë shpesh qëndrimet e tyre janë haptazi antikomuniste, kundër diktaturës së proletariatit. Ata janë të zhytur në pacifizëm, në ndjenjën e kotësisë



dhe nuk kanë asnjë besim te harmonia, te e bukura, te lumturia njerëzore. Kritiku marksist rus Vorovski, duke bërë fjalë për modernistët rusë të fillimit të shekullit, thoshte në artikullin e tij «Mbi natyrën borgjeze të modernistëve»: «Ideja e saj (e kësaj lloji inteligjencie artistike — D.Sh.) nuk është të shkatërrojë borgjezinë, por ta bëjë atë për vete, të zëjë një qoshe të ngrohtë në gjirin e saj. Sepse kjo inteligjencie është pjellë e rendit borgjez dhe do të vdesë së bashku me të».

Ndërsa shkrimtari revolucionar Hanri Barbys, që nuk pajtohej kurrsesi me modernizmin dhe shprehte ndaj tij një urrejtje të hapur, thoshte se kultura e tyre, e borgjezëve, « ishte kultura e stërhollimeve dhe e rënies». Duke folur për vepra formaliste të Prustit, Koktosë, ai e quante mjeshtërinë e tyre një «virtuozizëm xhonglerësh» dhe, përgjithësisht, për këtë lloj letërsie, që ishte në pozitë kundërta të revolucionit proletar, thoshte në librin e tij «Rusia»: «Ata përfaqësojnë një shoqëri të katandisur në gradë të fundit. Çdo vepër e tyre është... një epitaf varresh për këtë shoqëri».

Që nga koha e Barbysit e këtej arti modernist u rrokullis në një tatëpjetë të thepisur duke treguar vërtetësinë e fjalëve të këtij revolucionari. Ekzistencializmi, si një nga rrymat më të përhapura filozofike dhe letrare në botën perëndimore, përfaqëson një individualizëm ekstrem. Gjersa bota është kaos, thonë ekzistencialistët, asgjë nuk mund të njohësh dhe të parashikosh. «Ne nuk besojmë në progres» deklaroi Sartri. Në shoqërinë tonë, thonë ata, «cilido ndjen nevojë për tjetrin dhe njëkohësisht e urren atë». Sipas tyre, vetëm përballë vdekjes jeta merr një kuptim të thellë dhe kjo shpjegon situatat e llahtarshme të dramave dhe romaneve të tyre, ndjenjën e mosbesimit, të neveritjes dhe të urrejtjes për njeriun. Filozofi ekzistencialist gjerman Hajdeger i heq artit aftësinë e zbulimit të shkakut dhe të pasojës, të qëllimit ideor të një vepre dhe i zëvendëson këto me «lirinë e lojës». Singëriteti i njeriut të vetmuar, «i njeriut larg njerëzimit» ngrihet prej ekzistencialistëve

në shkallën e një kriteri të rëndësishëm të vlerësimit të artit dhe ofrohet si objekti kryesor i përmbajtjes së tij. Me pikëpamjet idealiste, me agnosticizmin dhe të shikuarit së nprathi të problemeve të koklavitura që shqetësojnë njerinë në shoqërinë borgjeze shpjegohen edhe deklaratat e Sartrit kur thotë se «njeriu e vendos fatin e vet në vetmi të plotë» ose kur shpreh simpatinë e tij të madhe për kubizmin, sepse «vepra e artit nuk duhet të riprodhojë realitetin». Veprat ekzistencialiste përshkohen nga një tragjizëm i pashpresë, nga një mistikë fantastike; heronjtë e tyre janë shpesh frikacakët, sepse i poshtri dhe i miri nuk kanë dallim për shkrimtarin ekzistencialist. Art që predikon hapur filozofinë e rënies, të poshtërimit, të frikës duke mbrojtur kështu borgjezinë dhe duke dashur t'i mbyllë rrugët e zhvillimit të shoqërisë. Prandaj ne s'mund të pajtohemi në asnjë mënyrë me këtë art dhe jemi të vetëdijshëm për rrezikun dhe dëmin e madh të ndikimit të tij në një atmosferë dhe shoqëri si jona, që qëndron në polin tjetër të asaj që ka pjellë ekzistencializmin, antiromanin, teatrin absurd dhe shënitime të tjera artistike.

Letërsia bulevardeske, pornografike, një letërsi komerciale, që prodhon për konsumin e gjërë, përpiqet ta «ëmbëlsojë» jetën borgjeze, mënyrën e jetesës amerikane, të kultivojë ndjenjën e euforisë erotike, të racizmit, të jetës së shturur, pa halle, duke krijuar romane, filma kartolineskë, me konflikte bajate, me mbarime të lumtura në gjirin e familjes borgjeze, me pajtime pronarësh «zemërgjerë» me punëtorë hallexhinj, me dashuri të sajua apo me aventura fantastike që trullosin mendjen e të rinjve në vendet borgjeze dhe revizioniste. Heroi fals, në këto lloj veprash, është shprehje e një progmatizmi të pështirë.

Prej kohësh kritika marksiste, përmes mendimeve të Lafargut, Meringut etj., që ndiqnin gjurmët e Marksit dhe të Engelsit, pa përmendur idetë shumë të njohura dhe të përhapura në botë të Gorkit për këtë problem, ka folur për domosdoshmërinë e heroit të vërtetë në letërsi,



për pasqyrimin e klasës punëtore, të figurës së punëtorit, kundër konceptimit denigrues apo filantropik të tij. Edhe shkrimtari dhe kritikë marksist anglez Ralf Foks, që ka dhënë jetën në brigadat internacionale në luftën e Spanjës më 1937, në veprën e tij me shumë vlera «Romani dhe populli», midis shumë çështjeve të rëndësishme të zhvillimit të romanit dhe të letërsisë, të parë historikisht si edhe në kohën e tij, shtronte edhe çështjen e heroit në letërsi dhe të deheroizimit në romanin borgjez. Psikanaliza, thoshte ai, është shprehje ekstreme e individualizmit dhe romanet e Xhoisit, të Prustit etj., nuk përshkruajnë njerëz po hije njerëzore. Nëse romani përparimtar borgjez, pohonte ai, mbështetej në disekuilibrin midis shoqërisë dhe individit, në zbulimin realist të kontradiktës, borgjezia vetë, me degjenerimin e saj, krijoi kushtet për shkatërrimin e realizmit, solli me vete vdekjen e heroit nga letërsia. Xhoisi dhe Prusti, vijonte Foksi, arritën në përfundimin se detyra e artit nuk është rikrijimi i njeriut, po copëzimi, depersonifikimi i tij. Prandaj, si në vështrimin e tipizimit, ashtu edhe të individualizimit, arti borgjez nisi rrugën e rënies, largimin nga realizmi. Ralf Foksi parashikonte zhvillimin epik të romanit që do të vinte në qendër popullin, të ardhmen e romanit të realizmit socialist.

Një problem tjetër i lidhur me thelbin ideologjik, me artin dekadent e formalist është edhe arsenal i mjeteve artistike, i formës që i shkon për shtat brendisë dhe që arrin në ekzagjerim dhe përcudnime të mëdha. Të kuptuarit e këtij problemi, e rrezikut të ndikimeve përmes përmbajtjes dhe formës është shumë i rëndësishëm edhe për ne në luftën që kemi bërë e duhet t'u bëjmë shfaqjeve të modernizmit, me variantet e veta të ndryshme, sidomos në poezi, po edhe në gjini të tjera. Ndikimi vjen, në radhë të parë, me brendinë, por brendia e huaj depërton edhe në formën, që shpreh një botë tjetër shpirtërore të mishëruar në atë veshje artistike, dhe prandaj hedh hije dhe shtrembëron edhe vetë përmbajtjen.

Kundër deformimit të artit modernist, kundër shkëputjes së plotë nga masat, për natyrën shpeshherë të pakomunikueshme të formave të tij është folur vazhdimisht. Mbi këtë problem, duke dërrmuar haptazi futurizmin, hermetizmin, kanë shkruar, në periudha të ndryshme, kritikë e teoricienë marksistë. Antonio Gramshi, në veprën e vet «Fletoret e burgut», krahas problemeve filozofike, prek edhe probleme të artit, duke parashtruar kërkesa për një art nacional-popullor, që t'i shërbejë popullit dhe të mbështetet në premisat realiste. Ky art i ri, për Gramshin nuk kishte asgjë të përbashkët dhe s'mund të ngatërrohej me shkolla artistike me prejardhje intelektuale si futurizmi. Ai vinte në lojë poezinë e tipit të D'Anuncios e të tjerëve, që në rrethe të ngushta lexonin me njëri-tjetrin poezi më të kuptueshme dhe më të moderuara për nga forma, kurse në qarqe të gjera e zyrtare nuk e kursenin pompozitetin, retorikën, stilin deklamativ, pozat stilistike. Gramshi fliste me përbuzje për «futuristët — antiakademistët». Në shkrimin e tij «Përmbajtja dhe forma» botuar në «Fletoret e burgut» Gramshi thoshte: «Dihet se ata që dërdëllisin për formën, duke ia kundërvënë përmbajtjes, thonë fjalë krejt boshe, të grumbulluara pa kriter dhe bile nuk u përmbahen gjithmonë rregullave gramatikore (p.sh. Ungareti), ndërsa me teknikë, formë etj. nënkuptojnë zhargonin e zbrazët, fjalët boshe».

Ky interpretim marksist i formalizmit ka shumë rëndësi në luftën e sotme kundër ndikimeve të huaja për të kuptuar se lufta kundër hermetizmit, kundër errësirës stilistike dhe ideore ka vazhdimësi në mendimin estetik marksist dhe është një luftë e drejtë me pikëpamje të qarta dhe të kristalizuara, që burojnë nga e vërteta dhe nga bindje të thella.

### 3.

Lidhur ngushtë me modernizmin është zhvilluar, si domos në dekada të fundit, edhe tendenca revizioniste



në letërsi e arte e shndërruar tashmë në një drejtim sundues në Bashkimin Sovjetik e gjetkë. Në kushtet e ashpërsimit të luftës klasore, me gjallërimin e revizionizmit në politikë, si një tradhti ndaj marksizëm-leninizmit dhe lëvizjes punëtore, u gjallërua edhe revizionizmi në art e estetikë në vendet ku klikat revizioniste erdhën në fuqi.

Siç dihet, premisa revizioniste në letërsinë sovjetike kishte edhe përpara se të vinte në fuqi klika hrushoviane, ishin krijuar disa kushte, disa rrethana me burokratizimin e disa intelektualëve, me shkëputjen e tyre prej masave popullore, që të gjente pastaj udhë të hapët revizionizmi për ta shpurë letërsinë sovjetike drejt modernizmit dhe degjenerimit. Por letërsia e periudhës së Leninit dhe të Stalinit, sidomos ajo që lindi në kushtet e revolucionit me temën e madhe të tij, më vonë me temën e luftës patriotike, etj. ishte, në vijat kryesore dhe në shfaqjet e veta më të rëndësishme, një letërsi e realizmit socialist, me tingull revolucionar që ruan vlerat e saj edukative e artistike edhe sot.

Është karakteristikë për disa autorë sovjetikë, francezë etj., të cilët kanë shkruar përpara vepra të mira (ndonëse disa herë në krijimtarinë e tyre plekseshin tendencat revolucionare me ato revizionistë apo modernistë që do të ngrinin krye më vonë) dhe kaluan pastaj në pozita krejt revizioniste apo dekadente.

E kanë shprehur dhe e shprehin plotësisht vijën revizioniste në letërsi, si në vepra ashtu edhe në deklarata politike, në artikuj teorikë etj., autorë tashmë të njohur për qëndrimet e tyre antirevolucionare, antisocialiste si Ehrenburgu, Shollohovi, Jevtushenko, Sollzhenjicini, Aragoni, Rozhe Garodi e shumë të tjerë.

Shfaqjet kryesore të revizionizmit në letërsinë sovjetike shprehen në falsifikimin e historisë, në mohimin e plotë të periudhës revolucionare, në prirjen e deheroizmit, të kultit të botës intime plot deziluzione dhe gjymtime shpirtërore. Pacifizmi dhe objektivizmi borgjez vihen në shumë vepra revizioniste; është e gjallë gjithashtu edhe prirja pragmatiste për të lavdëruar dhe për ligjur

çdo gjë që ka të bëjë me politikën revizioniste, me shovinizmin rusomadh. Edhe kohët e fundit, në një numër të revistës «Novi mir» ishte botuar një vjershë e vogël me tendenca të hapura shoviniste, ku thuhet me një emfazë të dukshme: «vendi im i madh që nga Japonia gjer te Polonia... vendi im, që përfshin lindjen dhe perëndimin». Zbatimi i hapur i politikës revizioniste në letërsi, duke ia hedhur të gjitha fajet së kaluarës, Stalinit, dhe duke lavdëruar pa masë të sotmen, krijimi i heronjve falsë dhe i skemave të reja liberale, në njërën anë, dhe rënia e plotë në modernizëm me gjithë pasojat e tij të mosbesimit të njeriut, të kërkimeve në labirintin e ndërgegjes të «shkurorëzimit» të heroit, të pasqyrit të kontradiktave pa rrugëdalje, të humbjes së idealeve — këto tendenca vihen re sot në letërsinë sovjetike. Disa autorë ruajnë edhe një stil të kuptueshëm tradicional, po përmes tij, komunikojnë idetë revizioniste.

Rruga e falsifikimit të historisë dhe e denigrimit të realitetit revolucionar, u vazhdua nga Sollzhenjicini dhe të tjerë. Në veprat e Sollzhenjicinit, si «Një ditë e Ivan Denisoviçit», «Pavioni i kancerozëve» etj., dhe tani së fundi «Arqipelagu Gulak» hidhet baltë e pluhur mbi realitetin revolucionar, mohohet haptazi socializmi, figurat e mëdha të Stalinit e Leninit, shprehet urrejtja për çdo gjë socialiste dhe simpatia për fenë, për kishat ruse, për një lloj misticizmi ku kërkon të gjejë prehje shpirti i këtij autori. Sollzhenjicini, si një fenomen letrar, është produkt i një situatë të caktuar revizioniste që u krijua në Bashkimin Sovjetik. Vepra e tij shpreh atë rrugë revizioniste që zotëron në letërsinë e sotme sovjetike, vetëm se ky autor e kapërcen kufirin demagogjik, karakteristik për politikën dhe për artin revizionist në përgjithësi, shkon më tej disa caqeve që diktojnë dhe kërkojnë udhëheqësit revizionistë të sotëm, të cilët duan të mbulojnë fytyrën e vërtetë dhe të ruajnë vetveten. Por është e qartë se si udhëheqësit revizionistë sovjetikë, ashtu edhe Sollzhenjicini, në thelb janë së bashku në pozitat e tradhtisë dhe të borgjezimit të plotë.



Në veprat letrare sovjetike ta kohëve të fundit, kushtuar Luftës së Dytë Botërore, zotëron fryma e disfatizmit, e deheroizimit. Në vend të ngjarjeve epike të luftës dhe të trimërisë popullore, tregohen njerëz me shpresa të thyera. Ka një dyzim të njeriut: ndryshe paraqitet ky në një skenë lufte, ndryshe në jetën personale dhe në mendimet e tij në vetmi; pleksen ngjarje dhe situata që duan doemos të krijojnë bindje se ata që bënë luftën kishin njolla në ndërgjegje, ishin frikacakë, kishin shumë anë të shëmtuara në marrëdhëniet me familjen, në dashuri etj. Kështu, në këto dhe në shumë shfaqje të tjera, sidomos në veprat kushtuar problemeve të familjes, të marrëdhënieve morale duket haptazi rënia në dekadentizëm.

Edhe në Francë është e dukshme tendenca revizioniste në letërsi të autorë si Aragoni etj. dhe mbrojtja e hapur e «realizmit pa cak» që bëri Garodija e që u përkrah, në të vërtetë, pavarësisht nga fjalët, edhe prej Aragonit. Krijimtaria e tanishme e këtij autori është zhytur në labirintin modernist; ai është kthyer në pozitë e tij të dikurshme surrealiste. Një ndër romanet e fundit të Aragonit «Mbarim i vërtetë» është shprehje tipike e modernizmit në prozë, e copëzimit të heroit, e mishërimin të një personazhi në fytyra të ndryshme artistike për të dhënë gjoja anët e kundërta të karakterit. Aragoni, në këtë roman dhe në romane të tjera të periudhës së fundit të krijimtarisë së tij, zhytet në një lirizëm subjektivist duke vazhduar kështu rrugën formaliste të Prustit etj., duke hequr dorë nga kërkesat e gjinisë së romanit, që nuk mund të zhvillohet jashtë epizmit, jashtë pasqyrimin objektiv të realitetit. Ka edhe kritikë francezë që pohojnë se veprat e fundit të Aragonit nuk i shpie dot gjer në fund, se janë të turbullta dhe kalojnë kufirin e çdo origjinaliteti.

Këtë rrugë të ndjekur në vepër, Aragoni e ka mbrojtur hapur edhe me deklaratat e tij, me bindjet estetike që ka shprehur herë pas here. Në artikullin «Po hap lojën» ai thotë: «Kuptimi i realizmit socialist mundet

dhe duhet të dalë përtej caqeve të veta. Unë do të shtoja... se është i domosdoshëm rishikimi i vazhdueshëm i realizmit socialist jo vetëm në dritën e parimeve të veprave të veta, po edhe në dritën e përvojës së grumbulluar jashtë tij, bile edhe në kundërshtim me të...» Ky mendim, siç kuptohet qartë, të çon haptazi në heqjen e çdo kufiri midis realizmit socialist dhe rrymave në kundërshtim me të, pra në shuarjen e parimeve të kësaj metode.

Në këtë rrugë pa krye të modernizmit dhe pragmatizmit e ka shpурë artin në këto vende politika revizioniste, restaurimi i kapitalizmit dhe borgjezimi i pikëpamjeve.

E tillë është, në vija të përgjithshme, tabloja e proceseve letrare të kohës sonë, e disa tendencave kryesore që përvijohen. Lufta midis letërsisë realiste, përparimtare, letërsisë së realizmit socialist, në njërën anë dhe letërsive dekadente, moderniste, revizioniste në anën tjetër, është një luftë klasore, ideologjike dhe estetike e gjatë dhe prandaj Partia na bën thirrje që të mos e quajmë veten të imunizuar dhe të mbrojmë traditën revolucionare. Ne jemi trashëgues të drejtpërdrejtë të traditës së përparuar kombëtare dhe ndërkombëtare. «Ne kemi vlerësuar, — thotë shoku Enver, — vetëm artin revolucionar, përparimtar e demokratik të huaj, qoftë ky i së kaluarës ose i shekullit tonë».

Arti i vërtetë është ai që, nëpër shekuj dhe sot, në kohën tonë, pasqyron luftën për liri e progres, ndjenjat, mendimet, shpirtin e popullit.

E ardhmja është e letërsisë që i takon popullit dhe revolucionit, e letërsisë me ideale dhe misione të mëdha për të dhënë të vërtetën dhe për të ngritur njerëzit në luftë kundër çdo gjëje që pengon zhvillimin e tyre, lumturinë dhe të drejtat. E ardhmja është e realizmit socialist.



## PASQYRA E LËNDËS

– Marksi dhe Engelsi mbi artin dhe shoqërinë .....	3
– Mësimet konsekuente revolucionare të Partisë dhe të shokut Enver Hoxha mbi letërsinë dhe artin .....	15
– Frymëzimi popullor, trashëgimia dhe e sotmja në artin tonë socialist .....	31
– Roli i madh i letërsisë për formimin e botëkuptimit revolucionar .....	40
– Partishmëria dhe karakteri kombëtar qëndrojnë në themel të letërsisë dhe të arteve tona .....	50
– Karakteri kombëtar i letërsisë dhe i arteve në interpretimin marksist-leninist. ....	67
– Gjallëri e pashtershme e metodës së realizmit socialist ....	95
– Poezia e viteve 1973-1975 .....	108
– Mbi pasqyrimin e masave dhe të individit në romanin tonë .....	138
– Mbi dramaticitetin e veprave tona letrare .....	152
– Mbi disa tendenca kryesore në letërsinë e huaj të shekullit XX .....	160



## FLETË KORREGJIMI

Faqe	Rreshti	Si është	Si duhet
21	5	dorejtohej pikëpamja me realizmin në artin përparimtar dhe	drejtohej pikëpamje me realizmin (në artin përparimtar) dhe
48	1	në	të
48	5	përshkruar	vërehen
82	17	vërshen	në
102	10	nën	ndjenjë
104	12	ndenjë	
112	3		
117	23		